

kombëtar
studim

diversifikimi
ekonomik
për gratë
që jetojnë
në zonat rurale
në Shqipëri

PASQYRA E LËNDËS

FALËNDERIME	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
1. HYRJE	19
2. METODA	24
2.1. KUADRI KONCEPTUAL	24
2.2. Instrumentet kërkimore	25
2.3. Projektimi i studimit dhe analiza e të dhënave	29
3. REZULTATET	32
3.1. Prirjet demografike	33
3.2. Situata shoqërore - ekonomike e grave në fshat	34
3.3. Të drejtat mbi tokën bujqësore	43
3.4. Kontributi në të ardhurat e familjes	55
3.5. Mundësia për të përdorur makineri dhe pajisje	58
3.6. Ndarje e detyrimeve dhe detyrave dhe dinamikat e pushtetit mes anëtarëve të familjes	59
3.7. Pengesat e grave në fshat për ndjekjen e mundësive ekonomike	71
5. BIBLIOGRAFIA	99
6. SHTOJCA	105
Shtojca 1: Projektimi i kampionit dhe karakteristikat e tij	105
Shtojca 2: Pyetësi	106
Shtojca 3: Burimet e informacionit	109
Shtojca 4: Lista e personave të përfshirë në intervistat gjysmë të strukturuar	114

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Pushteti dhe qëndrimet brenda familjes (meshkuj)	37
Figura 2: Pushteti dhe qëndrimet brenda familjes (femra)	38
Figura 3: Dhuna në familje, sipas vendbanimit të grave, në %	39
Figura 4: Pengesat kryesore ndaj rritjes së të ardhurave të familjes, sipas përkatësisë gjinore, rëndësia e parë	41
Figura 5: Kufizimet që duhet të marrin zgjidhje, në mënyrë që të përmirësohen mjetet e jetesës në fshat, rëndësia e parë	42
Figura 6: Veprimtaria kryesore për të zhvilluar një të ardhme më të mirë, rëndësia e parë	43
Figura 7: Kush luan rol në vendimet e tjera në familje (diagnostikues)	59
Figura 8: Kontributi në blegtori (diagnostikues)	63
Figura 9: Kontributi në bujqësi (diagnostikues)	64
Figura 10: Shkalla e pjesëmarrjes në krahun e punës, zona urbane - zona rurale	69
Figura 11: Frekuentimi i arsimit parashkollor, sipas përkatësisë gjinore (kryefamiljar)	72
Figura 12: Popullsia 10 vjeç e lart, zbërthyer sipas vendbanimit (qytet dhe fshat), përkatësisë gjinore dhe numrit të viteve të arsimit të kryer	73
Figura 13: Vuajtja nga sëmundjet kronike, sipas përkatësisë gjinore dhe zonës (individë)	79
Figura 14: A jeni regjistruar në një zyrë pune, sipas përkatësisë gjinore (individë)	85
Figura 15: Pensionet në fshat, sipas përkatësisë gjinore, 2012-2013	86
Figura 16: Kanë kompjuter, sipas përkatësisë gjinore dhe zonës (familje)	88
Figura 17: Kanë përdorur kompjuter në 3 muajt e fundit, sipas përkatësisë gjinore (individë)	89
Figura 18: Kanë përdorur internet në 3 muajt e fundit, sipas përkatësisë gjinore (individë)	90
Figura 19: Familje me linjë telefoni, sipas përkatësisë gjinore (familje)	91
Figura 20: Besimi te shoqatat, shoqëria civile dhe OJQ-të, si zgjidhëse të problemeve, sipas përkatësisë gjinore	92
Figura 21: Mundësia për të marrë informacion, sipas sektorëve, meshkuj	96
Figura 22: Mundësia për të marrë informacion, sipas sektorëve, femra	97

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Temat kryesore të studimit, treguesit përkatës SEAGA dhe pyetjet e studimit	26
Tabela 2: Rrethet dhe grupet e synuara të diskutimeve tematike	27
Tabela 3: Vetëvlerësimi i të ardhurave të familjes, sipas gjinive	34
Tabela 4: Shpenzimet mujore për familje, sipas zonës (fshat/qytet) dhe përkatësisë gjinore të kryefamiljarit, Shqipëri, 2012	35
Tabela 5: Informimi për ligjin e tokës	47
Tabela 6: Përcaktimi i të drejtave mbi tokën me ligj	48
Tabela 7: Të drejtat e fëmijëve mbi tokën, të zbërthyer sipas përkatësisë gjinore të pjesëmarrësit që i përgjigjet pyetjes (përpara vitit 1991 dhe pas vitit 1991)	48
Tabela 8: Institucionet të cilave u besohet vendimmarrja për shitblerjen dhe trashëgimin e tokës	49
Tabela 9: Anëtarët e regjistruar në titujt e tokës, sipas seksit	50
Tabela 10: Perceptimi për të drejtën e pronësisë mbi tokën	51
Tabela 11: Perceptimet për trashëgiminë në të ardhmen (familja ku ndodhen)	53
Tabela 12: Përqindja e kontributit në të ardhurat e familjes	55
Tabela 13: Pjesëmarrësit që shesin të vetëm në treg, në 3 vjetët e fundit	58
Tabela 14: Veprimtaria kryesore e angazhimit të anëtarëve të familjes mbi 14 vjeç, sipas përkatësisë gjinore	62
Tabela 15: Përqindja e bizneseve të drejtuar nga gra, në raport me numrin e bizneseve gjithsej, sipas qarqeve	66
Tabela 16: Arsye për moskryerjen e veprimtarive tregtare jobujqësore	68
Tabela 17: Niveli i arsimit të pjesëmarrësve në anketë, sipas përkatësisë gjinore	74
Tabela 18: Kërkesat për kredi në 5 vjetët e fundit	81
Tabela 19: Mundësia që u jepet grave për të përfituar nga skemat e financimit	83
Tabela 20: Institucionet të cilat kihet besim si zgjidhës të problemeve, sipas përkatësisë gjinore	92

LISTA E SHKURTIMEVE

CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Femrave
DSA	Development Solutions Associates
KE	Komisioni Europian
DKE	Delegacioni i Komisionit Europian
ETF	Fondacioni Europian për Trajnimin
FAO	Organizata për Ushqimin dhe Bujqësinë
QSH	Qeveria e Shqipërisë
GPI	Indeksi i Paritetit Gjinor
GTZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Teknik
VSHB	Vlera e Shtuar Bruto
ABF	Anketa e Buxhetit të Familjeve
HH	Kryefamiljari
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
INSTAT	Instituti i Statistikave
ILO	Zyra Ndërkombëtare e Punës
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
ISB	Instituti i Studimeve Bashkëkohore
AMNJ	Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës
AFP	Anketa e Forcës së Punës
AZHZM	Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

OZHM	Objektiv i Zhvillimit të Mijëvjeçarit
MZHETS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
OJQ	Organizatë Joqeveritare
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
RKSGBGJ	Raporti Kombëtar për Statusin e Grave dhe Barazinë Gjinore
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
APK	Anketa e Përdorimit të Kohës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve – Programi për Mbështetjen e Refugjatëve dhe Popullsisë Shqiptare
USAID	Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-ve
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
BB	Banka Botërore
WEAI	Indeksi i Fuqizimit të Grave në Bujqësi

FALËNDERIME

Këtë studim e hartuan Edvin Zhllima, Elvina Merkaj, Izela Tahsini dhe Drini Imami. Dëshirojmë të falënderojmë për informacionet e vyera të gjithë personat që i janë përgjigjur anketës dhe për palët e intervistuar të interesit.

Dëshirojmë të falënderojmë veçanërisht Susana Lastarria-Cornhiel nga Universiteti “UniversityofWisconsin”, Madison, dhe Blendi Gerdoci nga Universiteti i Tiranës, që kanë shqyrtuar disa versione të këtij studimi, për të cilat kanë dhënë mendime dhe vërejtje konstruktive.

Në veçanti falënderojmë Erisa Çelën, nga UN WomenAlbania, për të gjithë mbështetjen dhe kontributin në realizimin e këtij studimi.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë dy dekadave të fundit shndërrimet shoqërore-ekonomike dhe institucionale në Shqipëri kanë pasur një ndikim të konsiderueshëm në perceptimet dhe sjelljen e shqiptarëve kundrejt përkatësisë gjinore. Nivelet e larta të papunësisë, varfëria dhe niveli i ulët i mundësive ekonomike i kanë fuqizuar pabarazitë ndërmjet burrave dhe grave. Ky studim synon të japë një informacion të përgjithshëm mbi dallimet ndërmjet grave dhe burrave në fshatin shqiptar, sa u takon roleve, mundësisë për të marrë burime, sjelljes dhe statusit, me përqendrim te zhvillimi shoqëror-ekonomik i grave. Studimi siguron dëshmi mbi pabarazinë gjinore në zonat rurale dhe evidenton nevojën për mbështetjen e grave në këto zona, sidomos në fushat e mëposhtme:

1. PABARAZIA E TË DREJTAVE MBI TOKËN

Problemi kryesor lidhur me barazinë gjinore sa i takon mundësisë për të pasur mjete prodhimi në fshat janë të drejtat mbi tokën. Pavarësisht nga nevoja për rregullim të hollësishëm të ndarjes së tokës ndërmjet anëtarëve të familjes në rastin e martesës, kuadri ligjor nuk i diskriminon gratë. Megjithatë, zbatimi i normave ligjore në fshat shpesh është i pamjaftueshëm. Zbatimi i shtrembëruar i normave të kuadrit ligjor i ka rrënjët në procesin e organizuar dhe zbatuar dobët të shpërndarjes së tokës (në fillim të dekadës së fundit të shekullit XX), në epërsinë e të drejtave zakonore, si edhe ndërgjegjësimin e pakët të popullsisë rurale për të drejtat mbi tokën. Më shumë se 80% e titujve të tokës janë në emër të kryefamiljarit ose të ish-kryefamiljarit (vjehtërit, babait ose gjyshit). Analiza jonë ka konstatuar se, gratë nga zonat e thella dhe të largëta, të cilat jetojnë në familje

me pak tokë për frymë, me informim të pakët për tokën, pa mundësi për të marrë shërbime këshillimi bujqësor dhe që perceptojnë nivele të larta pabarazie sa i takon vendimmarrjes në familje, kanë më shumë gjasë të përjetojnë pabarazi lidhur me të drejtat mbi tokën, në krahasim me anëtarët meshkuj të familjes. Gjithashtu, aty ku të ardhurat nga bujqësia zënë një pjesë më të madhe të të ardhurave gjithsej dhe pjesëmarrësit në studim janë në moshë më të madhe, janë më të vogla gjasat për t'u ndier të barabartë lidhur me mundësinë për të pasur tokë.

REKOMANDIME:

- T'u jepen stimuj fermerëve për regjistrimin e titujve të tokës, në formën e uljes së tarifave dhe kostove të tjera procedurale.
- Rregullat për regjistrimin e titullit të tokës të marrin në konsideratë përfshirjen e të gjithë anëtarëve të familjes në certifikatën e pronësisë.
- Të regjistrohet dokumentacioni në ZRPP në mënyrë të zbërthyer sipas përkatësisë gjinore.
- Të bëhen fushata ndërgjegjësimi në fshat nga pushteti vendor dhe shoqëria civile, në mënyrë që të rritet informimi për legjislacionin mbi të drejtat e grave mbi tokën dhe të nxitet barazia gjinore.
- Pushteti vendor të krijojë zyra të posaçme për informimin mbi të drejtat mbi tokën.
- Të vendosen kritere shpërblyese për individët që paraqesin titull të përbashkët pronësie mbi tokën, kur bëjnë kërkesë për grante subvencioni bujqësor.

GRATE
ZONARU
EKONO
DIVER
SIFIKIM

2. PERCEPTOHET KONTRIBUT FINANCIAR I PABARABARTË

Kontributi që japin gratë dhe burrat në të ardhurat e familjes prek nivelin e pjesëmarrjes në vendimmarrje. Duket se roli i burrave, si ata që nxjerrin bukën e familjes, mbetet ende mbizotërues në fshatin shqiptar. Vetëm 7% e grave thonë se kontribuojnë më shumë se një të dytën e parave në familje. Gratë japin kontribut të konsiderueshëm në veprimtaritë bujqësore, por, meqë janë burrat ata që merren me tregtimin e prodhimeve, perceptohet se të ardhurat vijnë prej burrave. Analiza jonë tregon se mosha, përkatësia gjinore (të qenët mashkull, në rastin tonë), numri i viteve të shkollimit dhe statusi si i punësuar në veprimtari jobujqësore e rrit probabilitetin që një anëtar i familjes të kontribuojë në të ardhurat e familjes. Roli i dobët i grave në kontributin e të ardhurave të familjes e rrit mundësinë që ato të përfshihen në punë pa pagesë dhe të jenë përgjegjëse për punët e shtëpisë. Administrimi i parave është një tjetër e drejtë e burrave. Burrat kanë më shumë mundësi të përfitojnë shërbime dhe gëzojnë lirinë e lëvizjes dhe të udhëtimit, ndërsa gratë pengohen nga punët rutinë në bujqësi dhe nga punët e shtëpisë. Burrat janë disi më të informuar se gratë në lidhje me thuajse të gjitha sferat e jetës shoqërore-ekonomike në fshat dhe i kanë vizituar më shumë të gjitha agjencitë, me përjashtim të qendrave shëndetësore. Shumica e pjesëmarrësve në studim (si burra, ashtu edhe gra) nuk kanë informacion të mjaftueshëm lidhur me procedurat e çeljes, shërbimet vendore, shërbimet e punësimit dhe shërbimet shtetërore të mbështetjes financiare. Shërbime të tilla si skemat e pensioneve dhe të drejtat mbi tokën njihen në vija të trasha nga pjesëmarrësit në studim (thuajse 50% e të gjithë pjesëmarrësve kanë njëfarë informacioni për këto shërbime).

REKOMANDIME:

- Të përmirësohen njohuritë për kontributin ekonomik të grave, duke studiuar rolin e grave dhe të burrave në të gjitha llojet e veprimtarive bujqësore dhe veprimtarive të tjera prodhuese.
- Të zgjerohen aftësitë e grave për të ndjekur mundësitë ekonomike

nëpërmjet vënies në zbatim të programeve të arritshme dhe elastike, që synojnë nxitjen e sipërmarrjes dhe punësimit të grave.

- Të sigurohen module, programe dhe trajnime për sipërmarrjen, në mënyrë që të rriten shprehitë personale dhe sociale të grave, duke rritur kështu besimin te vetja dhe aftësitë e tyre. Të ofrohen paketa të përshtatura trajnimi për financat dhe shitjet për grupet prodhuese të grave, në mënyrë që të rritet mundësia e tyre për të qenë në tregjet lokale.
- Të fokusohen ndërhyrje të mirësnuara te krijimi i kushteve të favorshme për biznesin, dhënia e ndihmës për të arritur mbështetjen nga politikat, përmirësimi i ofrimit të produkteve financiare dhe mekanizmave të këshillimit të biznesit.
- Agjencitë e nxitjes së punësimit dhe të sipërmarrjes në nivel vendor dhe rajonal të hapin zyra pilot në zonat rurale. Shërbimet shtetërore të punësimit, drejtoritë bujqësore dhe agjencitë e deleguara nga MZHETS në bashkëpunim me bashkitë janë institucionet e mundshme për krijimin e shërbimeve të tilla, duke përdorur infrastrukturën ekzistuese.
- Të rregullohet pozicioni i grave në bujqësi. Meqë ka vështirësi në njohjen e rolit ekonomik të grave në familje, është e nevojshme të ketë legjislacion në fushën e ndihmësve familjarë në bujqësi, në përputhje me Direktivën 2010/41 të BE-së për gratë në vetëpunësim.

3. SIPËRMARRJA E GRAVE NË FSHAT

Sipërmarrja në fshat është ende shumë e dobët. Sipas anketës, më pak se 20% e pjesëmarrësve thonë se të ardhurat e familjes i nxjerrin nga vetëpunësimi jashtë fermës. Vetëm 22,4% e NVM-ve ndodhen në zonat rurale. Në përgjithësi, bizneset e drejtuara nga gra përbëjnë vetëm 28% të numrit të bizneseve gjithsej dhe ndodhen më së shumti (87%) në zonat urbane dhe janë të përqendruara në Tiranë (47,5%). Gratë sipërmarrëse drejtojnë firma të vogla (95% e ndërmarrjeve të drejtuara nga

GRATE
ZONARU
EKONO
DIVER
SIFIKIM

gra kanë më pak se 5 punonjës), përqendrohen në prodhim me pak vlerë të shtuar, në sektorë tejet joformalë, si shitja me pakicë, hoteleri dhe restorante, dhe sektorë të tjerë shërbimesh. Në zonat rurale, me përjashtim të sektorit bujqësor, të gjithë sektorët e tjerë janë nën përfaqësim (më pak se 25%). Kjo tregon edhe një herë diversifikimin e pakët ekonomik në fshat, si edhe mundësitë e pamjaftueshme për krijimin e bizneseve jashtë fermave, sidomos për gratë. Mbështetja e dobët financiare, mungesa e njohurive për biznese të reja me leverdi dhe mungesa e krahut të aftësuar të punës janë faktorët më të rëndësishëm që janë përmendur nga pjesëmarrësit për një mjedis të tillë të pafavorshëm biznesi.

REKOMANDIME:

- Të nxitet trajnimi fleksibël në bazë qendrave të lëvizshme të trajnimit, përdorimi i të cilave të zgjerohet.
- Të zgjerohen skemat e garancisë së kredisë, me objektiv të përcaktuar përfitueset gra në fshat.
- Të nxiten inkubatorët lokalë, për të stimuluar veprimtaritë e sipërmarrjes në fshat.
- Të krijohen rrjete të grave sipërmarrëse, si mënyra të reja të shkëmbimit të informacionit.
- Të nxiten veprimtari dhe modele biznesi që i kapërcejnë vështirësitë e lidhura me largësitë fizike dhe pengesat kulturore (për shembull, përpunimi dhe shitja në kuadër të organizatave të grupeve të prodhimit).
- Të mbështetet angazhimi i grave në shoqata dhe në vendimarrjen vendore.

4. Pjesëmarrja në tregun rural të punës

Tregjet rurale të punës nuk ofrojnë shumë mundësi për gratë. Për pasojë, në fshat gratë kanë shkallë punësimi më të ulët se burrat (60% në krahasim me 67,4% për burrat). Shkallët e papunësisë po rriten në tërësi, por shifrat janë të debatueshme kur i zbërthen sipas zonave. Por shkalla e papunësisë për burrat në fshat gjatë dekadës së fundit është rritur me 10%, ndërsa i njëjti tregues për gratë në fshat është dyfishuar. Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës për gratë, sidomos për të rejat, është shumë e ulët. Është e qartë që gratë dekurajohen nga kërkimi i punës jashtë fermës dhe punojnë në mënyrë mbizotëruese në bujqësi. Në fakt, një përqindje e lartë e grave kontribuon si punonjëse në familje, që do të thotë se e bëjnë ato punën e papaguar në ekonominë bujqësore të shtëpisë. Anketa që kemi bërë tregon një mungesë ndërgjegjësimi, si të grave, ashtu edhe të burrave, lidhur me pensionet dhe skemën e sigurimeve shoqërore.

REKOMANDIME:

- Administratat vendore të rrisin përpjekjet për krijimin e vendeve të punës në zonat rurale, duke dhënë më shumë mundësi për marrje informacioni, stimuj fiskalë etj.
- Nga NVM-të që ndodhen në zonat rurale, stimujt fiskalë t'u jepen atyre që punësojnë gra.
- Të rritet lëvizshmëria në nivel vendor dhe rajonal përmes investimit në transportin vendor.
- Shërbimet e trajnimit, shërbimet e punësimit dhe sistemet e informacionit mbi tregun të përqendrohen më shumë te nevojat e grave në fshat.
- Të vihen në zbatim programe trajnimi dhe punësimi që u dalin çështjeve përpara, sidomos me grup të synuar gratë dhe vajzat.

GRATE
ZONARUR
EKON
DIVER
SIFIKIM

5. ANGAZHIMI DHE KONTRIBUTI NË BUJQËSI

Më shumë se 70% e grave dhe burrave, si në studimin diagnostikues, ashtu edhe në atë krahasues, e konsiderojnë veten si të informuar për bujqësinë, duke e shënuar bujqësinë si sferën parësore të interesit. Megjithëse përqindja e fermave familjare në pronësi të grave është shumë e vogël (në përafërsi me përqindjen e familjeve me kryefamiljare femra) shumica e grave janë “drejtueset në hije” të ekonomisë bujqësore të familjes. Gratë angazhohen në të gjitha veprimtaritë e lidhura me bagëtinë, sepse i kryejnë thujtë të gjitha operacionet e punës. Ato janë të angazhuara edhe me punimin e tokës, mbjelljen, shërbimin e bimës, vjeljen dhe seleksionimin e produktit bujqësor. Burrat shpesh blejnë faktorët e prodhimit bujqësor, kryejnë ujitjen, përdorin pesticidet dhe transportojnë produktet për në treg dhe i shesin ato. Burrat janë përgjegjës për veprime ose vendimmarrje të caktuara, si marrëveshjet e qirasë së tokës dhe përfshihen disi në vendimmarrjen se cilat kultura bujqësore të kultivohen.

Duket se gratë më së shumti nuk dalin jashtë mjedisit të shtëpisë dhe fermës dhe kryejnë shumicën e punëve të dorës (më pak të vështira fizikisht, por një punë më intensive dhe rutinë), ndërsa burrat më së shumti administrojnë paratë dhe angazhohen në marrëdhëniet tregtare me shitësit e faktorëve bujqësorë, blerësit dhe të tretët (organet shtetërore, institucionet vendore, shërbimet këshillimore) dhe në shitjen e produkteve bujqësore. Burrat janë më të lirë të udhëtojnë dhe të zotërojnë ose të kenë automjete. Gjithashtu, gratë mund të mos ndihen mirë kur përfshihen të rrjete bujqësore ku mbizotërojnë burrat.

REKOMANDIME:

- Të zvogëlohen pengesat e grave për marrjen e disa shërbimeve, përmes ofrimit të paketave financiare për gratë, hapjes së zyrave të informimit të grave dhe përmirësimit të skemave të garancive që ndihmojnë në marrjen e kredive nga gratë.
- Të trajnohen përfaqësuesit e institucioneve financiare për barazinë gjinore.

- T'u sigurohet trajnim grave për mbrojtjen dhe cilësinë e kulturave bujqësore, magazinimin dhe përpunimin e të korrave, të vjelave dhe qumështit dhe kulturat bujqësore me leverdi financiare (frutat, hartat, kulturat e mbrojtura dhe bujqësia me vlerë të lartë), si edhe për marketingun dhe vënien e çmimeve, për të zvogëluar kështu ndarjen e roleve dhe për të rritur hyrjen e grave në tregje.

6. ARSIMI DHE FORMIMI

Arsimi në fshat është një faktor thelbësor për punësimin e grave. Në fshat ka më shumë meshkuj se femra me arsim të mesëm ose të lartë. Karakteristikat e rëndësishme të arsimit të vajzave në fshat janë: 1) mundësi e pakët arsimi parashkollor, 2) frekuentim i ulët i shkollës së mesme dhe 3) regjistrim më i ulët në shkolla profesionale. Vlerësimet e cilësisë (Censusi i Popullsisë dhe Banesave dhe studimi PISA) ngrenë shqetësime lidhur me përkeqësimin e sistemit arsimor në fshat. Investimet e pakta në infrastrukturë dhe burime njerëzore dhe largësia e shumë institucioneve të AFP-së janë disa prej shkaqeve të kësaj situatë të vështirë. Gjithashtu, shumë pak gra marrin pjesë në programe formuese, për shkak të kohës së pamjaftueshme, largësisë dhe mënyrës së organizimit të programeve të formimit (të mbizotëruara nga meshkuj dhe pa planifikim të duhur).

REKOMANDIME:

- Të nxitet arsimi parashkollor në fshat, për efektin e dyfishtë që ka: rrit cilësinë e arsimit për fëmijët dhe ul ngarkesën e kujdesit të fëmijëve për gratë në fshat.
- Të përmirësohen perceptimet e të mirave të arsimit profesional, përmes nxitjes së arsimit profesional në media kombëtare, me përqendrimin në fushën e bujqësisë.

GRATE
ZONARU
EKONO
DIVER
SIFIKIM

- Të përmirësohen programet shkollore dhe të fuqizohen marrëdhëniet biznes-arsim profesional.
- Të zvogëlohen pengesat për vajzat dhe gratë në fshat, përmes trajtimit të sfidave me të cilat përballen ato që jetojnë në zona të thella (për shembull, transporti, strehimi, bursa sidomos për AFP etj.).
- Të sigurohen programe formimi për mësuesit, me përqendrimin te metodat novatore të mësimdhënies, si edhe te metodat e dyfishta dhe të kombinuara të mëimit.
- Të zbatohet koncepti i rrjeteve të shkollave siç sugjerohet në raportet e Bankës Botërore (BB, 2014)¹.
- Ofruesit e trajnimit të përdorin masa të forta për përfshirjen e grave profesioniste në shërbimet këshillimore dhe në stafin ndihmës të trajnimit.

7. MUNDËSIA PËR TË MARRË MBËSHTETJE FINANCIARE:

Sipas të dhënave, gratë kanë shumë pak mundësi për të përfituar nga mbështetja financiare e shtetit ose e donatorëve. Mungesa e rrjeteve dhe e punës bindëse dhe ekzistenca e kanaleve informuese të zotëruara nga meshkuj e pakësojnë mundësinë e grave për të marrë mbështetje financiare. Ndërsa vetëm 3% e grave thonë se kanë bërë kërkesë për grante, përqindja e burrave është shumë më e lartë, 10%. Gjithashtu, sipas shifrave zyrtare, numri i përfituesve gra është 5 herë më i vogël se i përfituesve burra (në rastin më të mirë). Gratë shihen si “grua fermeri” dhe jo si fermer në vetvete, siç sugjeron një raport i FAO-s (FAO, 2015).

1 Në zonat rurale në Shqipëri 68% e shkollave kanë të paktën një shkollë tjetër në të njëjtën zonë. Prandaj shkollat në pozita të dobëta mund të përfitojnë nga homologët e tjerë, si personel mësues, ashtu edhe përvojë, nëse qeveria promovon një shpërndarje të re dhe e prish shtresëzimin e tanishëm. Për shembull, shkolla profesionale bujqësore e Cërrikut ka edhe tri shkolla të tjera në rrezen 1 km: shkollën profesionale ekonomike, shkollën private me fonde turke dhe shkollën e mesme të përgjithshme publike. Të tria shkollat kanë ecuri shumë më të mirë dhe nxënësit nga zonat rurale bëjnë përpjekje të regjistrohen në këto shkolla dhe jo në atë bujqësore (megjithëse te kjo e fundit sigurohet ushqim dhe fjetje).

REKOMANDIME:

- Të pakësohet padituria financiare e grave në fshat (për shembull, përmes programeve të posaçme të formimit).
- Të zhvillohet një fond garancie për programe kreditimi për gratë në fshat.
- Të mbështeten gratë dhe grupet e grave, për të paraqitur kërkesa për grante të financuara nga shteti ose nga donatorë, përmes zbatimit të kriterëve me bazë gjinore (për shembull, në vlerësim) në skemat e financimit.
- Të rritet pjesëmarrja e grave në shoqatat bujqësore, përmes rritjes së besimit dhe të nxitet puna e shoqatave në zonat rurale.

8. MUNDËSIA PËR TË MARRË SHËRBIME KËSHILLIMORE BUJQËSORE

Një tjetër faktor pabarazie është mundësia jo e barabartë e grave, krahasuar me burrat fermerë, për të marrë shërbime këshillimore në bujqësi. Studime të mëparshme tregojnë se grave në fshat, sidomos atyre që kanë lindur në tri dekadat e fundit dhe që nuk kanë pasur mundësi të marrin arsim profesional bujqësor, nuk u jepet mundësia për të marrë shërbime këshillimore në bujqësi. Mundësia e grave për të marrë shërbime kufizohet nga perceptimet patriarkale në lidhje me pjesëmarrjen dhe rolin e grave, vendet dhe oraret e papërshtatshme të mbledhjeve dhe mbizotërimit të burrave në personelin e shërbimeve këshillimore. Vihet re më shumë përfitim nga shërbimet veterinarë dhe shërbimet që ofrojnë shitësit e pikave të faktorëve të prodhimit bujqësor.

REKOMANDIME:

- Të reformohen shërbimet këshillimore bujqësore për ta shndërruar qasjen nga lart poshtë të trashëguar nga e shkuara dhe për të siguruar një

GRATE
ZONARU
EKONO
DIVER
SIFIKIM

shërbim të bazuar në kërkesë njësoj të arritshëm nga burrat dhe gratë. Të mbështetet një personel me drejtpeshim gjinor.

- Shërbime të tilla si pikat e shitjes së faktorëve të prodhimit bujqësor të orientohen drejt mbështetjes për fermeret gra, përmes angazhimit të udhëheqëseve të komunitetit dhe grupeve të prodhimit të grave.
- Të rritet informimi me TIK, për shembull informimi në internet dhe në celular.
- Për të kapërcyer pengesat e lidhura me largësitë fizike, të mendohet një përdorim më i mirë i mediave, përmes nxitjes së programeve të posaçme për stacionet radio-televizive vendore, me synimin të shqetësimet kryesore shoqërore-ekonomike të grave në fshat.

Në përgjithësi, nevojitet një qasje më tërësore për zgjerimin e shërbimeve sociale. Për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe efektivitetin e këtyre shërbimeve, lipset të lindë besimi midis komuniteteve dhe grave në nivel vendor, nga njëra anë, dhe institucioneve vendore, nga ana tjetër, përmes fuqizimit të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen vendore (në këshilla, pleqësi, shoqata dhe organeve vendimmarrëse). Njësitë e pushtetit vendor ta zgjerojnë rolin e tyre si palë ndërvepruese me shoqatat dhe rrjetet e promovuara nga shoqëria civile ose ofruesit privat të shërbimeve. Të ndiqen procese me pjesëmarrje, për ta rritur mundësinë e grave për informim dhe për t'i zgjeruar rrjetet e grave.

1. HYRJE

U bënë dekada që konventat ndërkombëtare e njohin kontributin jetik të grave në bujqësi dhe në zhvillimin rural. Raportet për rolin e grave në fshat arrijnë në përfundimin se ato janë përfaqësuese kryesore për arritjen e ndryshimeve ekonomike, shoqërore dhe mjedisore, që nevojiten për botën në zhvillim. Mirëpo, të drejtat dhe përparësitë e grave në fshat nuk trajtohen sa duhet në kuadrot ligjorë, në politikat kombëtare dhe vendore për zhvillim, në programet rurale dhe strategjitë për investimet në të gjitha nivelet në mbarë botën (UN Women, 2015). Gratë në fshat, në mbarë botën, vijojnë të përballen me vështirësi të mëdha gjatë kryerjes së roleve të tyre të shumëfishta produktive dhe riprodhuese si brenda familjeve, ashtu edhe në komunitet, pjesërisht për shkak të mungesës së infrastrukturës rurale dhe mallrave e shërbimeve shtesë.

Programet e politikave kanë ecur përpara sa i takon trajtimit të problemeve të grave në fshat. Platforma për Veprim e Pekinit (OKB, 1995) i trajton në përgjithësi nevojat dhe përparësitë e grave në 12 fushat kritike të interesit. Dy objektivat më kryesorë të politikës për zhvillim, që janë fuqizimi i grave dhe zvogëlimi i pabarazive gjinore, siç përcaktohen edhe në Objektivin e Zhvillimit të Mijëvjeçarit 3 (OZHM 3), janë mbështetur si pjesë e Deklaratës së OKB-së për Mijëvjeçarin në vitin 2000. Kjo vëmendje u ripërtëri edhe në programin Agjenda 2030, me 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), në të cilët gratë në fshat përbëjnë një temë të rëndësishme të objektivave kryesorë, siç janë objektivi për eliminimin e varfërisë në të gjitha format, kudo; objektivi për eliminim e urisë, për arritjen e sigurisë ushqimore dhe përmirësimin e ushqyerjes dhe nxitjen e bujqësisë së qëndrueshme; si edhe objektivi për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Fuqizimi përbën një koncept qendror dhe përkufizohet si zgjerimi ose rritja e mundësive për të përdorur “aftësitë e njerëzve për të marrë vendime strategjike në jetë” (Kabeer, 2001); “mjetet dhe aftësitë e njerëzve” (Narayan, 2005); ose “burimet

GRATË
ZONARU
EKON
DIVER
SIFIKIM

materiale, njerëzore dhe shoqërore” (Mahmud e të tjerë, 2012). Për rrjedhojë, kur vështrojmë zvogëlimin e hendekut gjinor në fshat, është mirë të përqendrohemi te mundësia që kanë gratë për të përdorur dhe mbajtur nën kontroll mjetet dhe burimet; si edhe tek aftësia/mundësia e grave për t’i shndërruar këto në interesin më të mirë të tyre. Hendeku gjinor gjendet më i theksuar mes grave në fshat kur këto krahasohen me gratë në qytet. Prandaj, mbyllja e hendekut gjinor mes grave në fshat do të jepte ndihmesë në rritjen e produktivitetit bujqësor dhe në një ushqyerje më të mirë të fëmijës, do ta rriste vetëbesimin e grave dhe do të nxiste rritjen e përgjithshme rurale (OECD, 2012).

Pabarazia gjinore¹ në fshat është një dukuri e mprehtë në mbarë botën, por ajo është më dukshme në vendet në tranzicion. Këtu roli i grave ka përjetuar ndryshime të konsiderueshme për shkak të një ndryshimi në përbërjen dhe strukturën e familjeve në fshat, kundrejt ndryshimeve në institucionet dhe strukturat e prodhimit në fshat. Për pasojë, hendeqet gjinore për aftësitë dhe mundësitë e përdorimit të mjeteve dhe burimeve janë objekt i ndryshimeve të vullshme, sidomos duke qenë se grave në fshat u janë dhënë më shumë përgjegjësi për të siguruar ushqim për familjen dhe për kujdesin për fëmijët (Snyder, 1990). Në shumicën e vendeve në tranzicion gratë në fshat përbëjnë bazën e bujqësisë së njësive të vogla ekonomike, përbëjnë krahun e punës në ekonominë bujqësore dhe bazën e sigurimit të jetesës së përditshme të familjes. Gratë në fshat përballen me një sërë kufizimesh, duke qenë se në shumicën e vendeve ato kanë më shumë vështirësi se burrat në fitimin e të drejtës për të përdorur tokë, për të marrë kredi dhe për të përfituar shërbime mbështetëse rurale. Krahas këtyre kufizimeve, në shumicën e vendeve në tranzicion, gratë në fshat përballen me pengesa kur duan të fitojnë njohuri dhe të marrin informacion teknologjik nga burime të besueshme (Daman, 1997).

1 Barazi gjinore do të thotë që “Gra e burra, vajza e djem, të kenë të drejta, përgjegjësi dhe mundësi të barabarta. Barazi nuk do të thotë që gratë dhe burrat do të bëhen e njëjta gjë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e grave dhe burrave nuk do të varen nga fakti që kanë lindur me gjininë mashkull apo femër. Barazi gjinore nënkupton që merren në konsideratë interesat, nevojat dhe përparësitë si të grave, ashtu edhe të burrave, duke pranuar dallimet e grupeve të ndryshme të grave dhe burrave. Barazia gjinore nuk është “çështje grash”, por duhet t’u interesojë burrave dhe grave dhe t’i angazhojë plotësisht këta. Barazia mes grave dhe burrave shikohet si një çështje e të drejtave të njeriut, por edhe si parakusht dhe tregues për zhvillimin e qëndrueshëm, që vendos në qendër të tij njerëzit.” Burimi: <http://www.undp.org/content/dam/undp/library/gender/Annex%201%20Terminology.pdf>.

Shqipëria nuk përbën përjashtim në këtë aspekt. Gjatë dy dekadave të fundit gratë në fshat, në Shqipëri, kanë përjetuar një larmi në rritje problemesh ekonomike dhe humbjesh sa u takon të drejtave dhe mundësive të barabarta (Wheeler, 1998; Wheeler e të tjerë, 2003; Zhllima e të tjerë, 2010; Mandro-Balili, 2012; ISB, 2013). Dobësitë në institucionet e tokës dhe në njësitë e qeverisjes vendore kanë krijuar një vakum, ku kanë rilindur të drejtat zakonore dhe organizatat fshatare, sidomos sa u takon të drejtave të pronësisë. Pasojat e reformës së tokës dhe sistemi i fuqishëm zakonor i të drejtave mbi tokën kanë krijuar një bujqësi të drejtuar nga burrat (UN Women, 2015).

Ndryshimet strukturore në fshat kanë lënë pasoja negative te gratë, sa i takon nivelit arsimor, shëndetit, pjesëmarrjes në jetën shoqërore, mundësisë për krahe pune dhe mundësisë për të shfrytëzuar burime të tjera të krijimit të të ardhurave. Fuqizimi i rolit të burrave dhe rigjallërimi i normave zakonore me rënien e strukturave institucionale shtetërore në fshat e dobësuan ndikimin shoqëror dhe ekonomik të grave në proceset e vendimmarrjes brenda familjes dhe komunitetit. Në fakt, më se një e dyta e grave në Shqipëri punojnë në bujqësi, por shifrat zyrtare identifikojnë vetëm një pjesë të vogël të njësive ekonomike bujqësore të administruara nga gra, në nivelin afër 6% (MBZHRAU)².

Megjithëse fuqizimi i grave është pranuar dhe theksuar si përparësi e qeverisë, Raporti kombëtar për statusin e grave dhe barazinë gjinore (RKSGBGJ) në Shqipëri (2011) pranonte faktin se “mbeten boshllëqe në politika lidhur me çështjet e të drejtave ekonomike të grave, sipërmarrjes së grave dhe grave në fshat. Raporti konstaton se, në përgjithësi, në fushën e sipërmarrjes, arsimit dhe shëndetësisë, pengesat janë ndjeshëm më të larta për gratë e papuna; gratë dhe burrat me më shumë se tre fëmijë; gratë dhe burrat në fshat dhe në rajonin qendror dhe atë malor; të varfrit, personat në rrezik përjashtimi social dhe personat në pozita të pambrojtura; dhe pjesëtarët e pakicave kombëtare.”

Një raport për Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të

2 Kjo shifër mbështetet në regjistrin paraprak të fermave të MBZHRAU-së (2010), ku nuk përfshihej e gjithë Shqipëria dhe nuk u pranua zyrtarisht, për shkak të përditësimit jo sistematik dhe mbulimit të kufizuar territorial. Si drejtues të fermës, MBZHRAU quan kryefamiljarin.

Grave (CEDAW, 2010), konkretisht lidhur me nenin 14, vë në dukje se gratë në fshat, në Shqipëri, përballen me kufizime të veçanta në lidhje me mundësitë e barabarta për të pasur tokë dhe përfitime ekonomike pas reformës së tokës, kushte adekuate dhe të shëndetshme jetese, kujdes shëndetësor dhe arsim, teknologji dhe metoda moderne prodhimi dhe mundësi të tjera ekonomike, si mundësia për të marrë kapital, informacion dhe shërbime këshillimore, si edhe lobim dhe punë mbrojtëse.

Pavarësisht nga larmia e gjerë e kufizimeve me të cilat përballen sot gratë në fshat në Shqipëri, nuk është kryer asnjë studim kombëtar i imët, për të kuptuar plotësisht situatën shoqërore dhe ekonomike të këtyre grave. Gjithashtu, nuk ka një cens zyrtar të njësive ekonomike bujqësore dhe/ose të dhëna anketash të tjera lidhur me çështjet gjinore në fshat. Ky studim orvatet ta mbushë këtë boshllëk të rëndësishëm. Dhënia e informacionit për situatën e grave në fshat është e copëzuar, informacionet thuajse nuk gjenden ose keqparaqiten.

Gjithsesi, ka tashmë të dhëna nga disa studime që kanë përdorur anketa me kampion të grave në fshat për dekadën e parë (për shembull, Lemel, 2000). Burimet kryesore të të dhënave që përdoren për vlerësimin e situatës së grave kanë qenë anketat e përqendruara në kushtet e jetesës dhe të ardhurat (AMNJ 2012 dhe VBF 2015), mundësitë për të punuar (AFP 2014), përdorimin e kohës (APK 2011) dhe migrimin (Anketa për Migrimin 2014). Raporte të tilla si IDM (2008) kanë përdorur të dhëna dytësore, ndërsa Zhllima e të tjerë (2010) kanë përdorur metodat e grupeve të diskutimeve tematike për të vlerësuar perceptimin e fermereve. Analiza të tjera përfshijnë ILO (2014), mbështetur në të dhënat e AMNJ-së; SHGPAZ (2014), mbështetur në vëzhgime cilësore; dhe IDM (2014), mbështetur në metodën “Delphi”. Në dallim nga sa më lart, studimet në rajonin e Ballkanit janë më të larmishme si në metodë, ashtu edhe në fokus: UNICEF Serbia (2011) ka përdorur një ndërthurje të të dhënave nga Sondazhi i Matjes së Standardit të Jetesës (LSMP) dhe nga Sondazhi i Buxhetit Familjar (HBP) me grupe diskutimi tematike. Një studim i kohëve të fundit, realizuar nga UN WomenMacedonia (CRPS, 2014), ndërthurte rezultatet e një ankete me gra dhe burra në fshat me të dhënat nga AMNJ dhe Censusi.

Për rrjedhojë, në përgjigje të shqetësimit të ngritur më lart, si edhe në bazë të angazhimit të UN Women për të mbështetur gratë në fshat, në partneritet me

institucionet shqiptare, për të pasur një përgjigje të duhur përmes politikave në të ardhmen, thelbësor është një studim kombëtar për gratë në fshat dhe diversifikimin ekonomik në zonat rurale. Objektivi i këtij studimi është hetimi i imët i statusit shoqëror-ekonomik të grave në fshat në Shqipëri, për të identifikuar çdo kufizim të veçantë që mund të pengojë apo potencial që mund të rrisë angazhimin e grave në sferat ekonomike dhe shoqërore në fshat. Synimi i këtij studimi përqendrohet tek analizimi i diskriminimit të grave bazuar në ligj; i mundësisë për të pasur tokë/të drejtë përdorimi toke dhe të drejtave të trashëgimisë; i mundësisë për të përdorur faktorë prodhimi, teknologji, tregje dhe kredi; dhe i ndërhyrjeve që u japin mundësi grave të angazhohen në punë më produktive dhe më shpërblyese, me qëllim dhënien e rekomandimeve për politikatat.

Qasja e studimit, e cila përshkruhet në rubrikën në vijim, merr në konsideratë pjesën e madhe të punës së kryer në Shqipëri dhe në rajon. Ky është studimi i parë që mbështetet në një anketë me kampion të madh, i cili mbulon si gratë, ashtu edhe burrat, në fshat. Kjo punë kërkimore bën edhe një hap më tutje, përmes ndërthurjes së metodave cilësore dhe sasore, për të hetuar aspektet e ndryshme që prekin pjesëmarrjen e barabartë të grave në jetën shoqërore-ekonomike në fshat, që janë të drejtat mbi pronën, përdorimi i burimeve dhe administrimi.

GRATË
ZONARUR
EKONOMIC
DIVERSIFIKIM

2. METODA

2.1 KUADRI KONCEPTUAL

Siç thuhet edhe më lart, ka një shumëllojshmëri metodash, cilësore dhe sasiore, që përdorin studiuesit për të hetuar situatën e grave në fshat. Ne vendosëm të përdorim një metodë të përzier, në përpjekje për t'u mbështetur në pikat e forta të dy metodikave dhe për të siguruar një perspektivë më të gjerë dhe më të thellë për çështjen në përgjithësi. Mirëpo, pavarësisht metodës së përdorur, shumica e studimeve të mëparshme mbështeten në një bashkësi treguesish që matin nivelin e fuqizimit të grave, barazinë, situatën shoqërore-ekonomike etj.

USAID nxit përdorimin e Indeksit të Fuqizimit të Grave në Bujqësi (WEAI) (shih Alkire e të tjerë, 2013). WEAI përfshin dy nënindekse: 1) fuqizimi në bujqësi dhe pariteti gjinor, ku shumica e treguesve përqendrohen kryesisht te sektori bujqësor. Kuadri më i fundit i treguesve, i përgatitur nga FAO (2014), me titull “Udhëzues për mbledhjen e të dhënave të zbërthyer sipas përkatësisë gjinore në bujqësi dhe në fshat”, ofron disa mjete të tjera shtesë, për të kuptuar në mënyrë më të thellë situatën e grave në fshat. FAO, në përpjekje për të asistuar vendet anëtare, ka propozuar një metodikë të vetme të unifikuar, për të udhëzuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave me ndjeshmëri gjinore në bujqësi: Qasjen e analizës shoqërore-ekonomike dhe gjinore (SEAGA).

Për rrjedhojë, në mënyrë që të bëhet një analizë më e hollësishme, ekipi i studimit do të përdorë kuadrin e treguesve të FAO-s si bazë të kuadrit konceptual të këtij studimi. Sipas kuadrit të FAO-s, gjashtë pyetjet bazë, që ndihmojnë në vlerësimin e statusit shoqëror-ekonomik të grave dhe burrave në bujqësi, janë:

Kush bën çfarë?

Kush zotëron çfarë?

Kujt i jepet mundësia për të përfituar dhe kontrolluar, dhe çfarë mund të përfitojë dhe kontrollojë?

Kush di çfarë?

Kush përfiton?

Kush duhet të përfshihet në programet e zhvillimit?

Këto pyetje, sidomos tri të parat, përbëjnë thelbin e analizës gjinore³ dhe mund të shërbejnë si udhëzues për identifikimin e treguesve me ndjeshmëri gjinore për sektorin bujqësor dhe rural. Duke përdorur si njësi të analizës familjen rurale, mund të përdoren një sërë treguesish SEAGA, për të krahasuar mundësinë që kanë gratë dhe burrat për të

Grupi i propozuar i treguesve përqendrohet te roli i grave dhe situata e tyre shoqërore-ekonomike në kuadër të zhvillimit bujqësor dhe rural. Gjithashtu, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e çështjeve gjinore në fshat dhe rrjedhojat e tyre me gamë të gjerë, ky studim e përqendron vëmendjen te çështjet e lidhura me reformat aktuale të ndërmarra në Shqipëri.

2.2 INSTRUMENTET KËRKIMORE

Pas një shqyrtimi të thellë të literaturës ekzistuese, dokumentacionit dhe burimeve

³ Analiza gjinore përbën një mënyrë sistematike për të vështruar efektet e ndryshme që kanë politikën, programet dhe legjislacionin për zhvillimin te gratë dhe burrat, dhe që kërkon, mbi të gjitha, mbledhjen e të dhënave të zbërthyera sipas përkatësisë gjinore dhe informacioneve me ndjeshmëri gjinore për popullatën në fjalë. Analiza gjinore mund të përfshijë edhe ekzaminimin e mënyrave të shumta në të cilat gratë dhe burrat, si aktorë socialë, angazhohen në strategji për të transformuar rolet, marrëdhëniet dhe proceset ekzistuese në interes të tyre dhe në interes të të tjerëve. (OKB, 2011)

GRATË
ZONARUR
EKONOMIC
DIVERZIFIKIM
SIFIKIM

Tabela 1: Temat kryesore të studimit, treguesit përkatës SEAGA dhe pyetjet e studimit

Tema e studimit	Treguesi i mundshëm gjinor (treguesit SEAGA)	Pyetjet SEAGA					
		Kush bën çfarë?	Kush zotëron çfarë?	Kujt i jepet mundësia për të përfituar dhe kontrolluar, dhe çfarë mund të përfitojë dhe kontrollojë?	Kush di çfarë?	Kush përfiton?	Kush duhet të përfshihet?
Situata demografike	Shpërndarja e pronave në fshat*, e zbrërthyer sipas gjinisë së kryefamiljarit	●	●				●
	Madhësia mesatare e familjes së pronarit, e zbrërthyer sipas gjinisë	●	●				●
Mundësia për të marrë arsim (të përgjithshëm dhe profesional)	Përqindja e pronave sipas nivelit arsimor të pronarit mbi një nivel të caktuar të zbrërthyer sipas përkatësisë gjinore			●	●		●
Mundësia për të marrë shërbime këshillimore bujqësore	Përqindja e pronave/subjekteve që marrin shërbime këshillimore bujqësore, e zbrërthyer sipas burimit dhe përkatësisë gjinore			●	●	●	●
Mundësia për organizim dhe lidhje në rrjet	Përqindja e pronave/subjekteve që marrin pjesë në shoqata të fermerëve, e zbrërthyer sipas përkatësisë gjinore			●	●		●
Mundësia për të përdorur tokë dhe për mundësi të tjera ekonomike në fshat	Sipërfaqja mesatare e pronës, e zbrërthyer sipas tipologjisë së përdorimit të tokës dhe përkatësisë gjinore	●					●
	Pjesëmarrja e pronës/subjektit në skema të mbështetjes financiare dhe jofinanciare për zhvillimin rural	●		●		●	●
Mundësia për të përdorur faktorë të prodhimit dhe burime e shërbime të tjera.	Përqindja e grave dhe burrave që blejnë faktorë të prodhimit, e zbrërthyer sipas përkatësisë gjinore			●			●
	Përqindja e pronave/subjekteve me makineri dhe pajisje të përzgjedhur, sipas përkatësisë gjinore		●	●			●
	Përqindja e pronave/subjekteve që kërkojnë grante dhe marrin grante, e zbrërthyer sipas përkatësisë gjinore			●		●	●
	Përqindja e pronave/subjekteve që marrin pjesë në sistemet e sigurimeve shoqërore dhe shërbimet sociale, sipas përkatësisë gjinore			●		●	●
Mundësia për të marrë kredi dhe sigurime.	Përqindja e pronave/subjekteve që kërkojnë kredi, sipas përkatësisë gjinore			●		●	●
	Përqindja e pronave që e mbulojnë veprimtarinë nëpërmjet sigurimit, e zbrërthyer sipas përkatësisë gjinore			●		●	●
Mundësia për të pasur veprimtari jashtë fermës	Përqindja e pronave me veprimtari të tjera me të ardhura në familje, sipas përkatësisë gjinore	●		●			●
Çështje të tjera shoqërore-demografike	Qëndrimet kundrejt institucioneve të vendimarrjes në nivel vendor dhe qendror. Pjesëmarrja e grave në sistemet e sigurimeve shoqërore dhe shërbimet sociale	●		●	●	●	●

*OSE E FAMILJEVE, KUR NUK KA TË DHËNA PËR PRONAT (NJËSITË EKONOMIKE BUJQËSORE). NË KËTË RAST PRONARI TË ZËVENDËSOHET ME KRYEFAMILJARIN. BURIMI: SHITJELLIM I TREGUESVE NGA AUTORËT, MBËSHTETUR NË TREGUESIT SEAGA.

dytësore të të dhënave (shih bibliografinë dhe Shtojcën 3), ekipi i studimit vendosi të ndjekë një metodë të përzier për punën kërkimore parësore. Për këtë, kemi përdorur instrumente të ndryshme kërkimore si: a) grupe diskutimesh tematike, b) intervista të strukturuar dhe c) anketë të mbështetur në pyetësorë të strukturuar, siç përshkruhet më poshtë.

Diskutimet në grupe tematike janë zhvilluar gjatë muajit gusht 2015, në zonat rurale verilindore, veriperëndimore, qendrore, juglindore dhe jugperëndimore të vendit (shih tabelën 2). Gjetjet janë zbardhur, kodifikuar dhe analizuar gjatë periudhës gusht-shtator 2015.

- a. Secili prej këtyre diskutimeve në grupe tematike ka ndihmuar në marrjen e mendimeve të grave për kufizimet dhe sfidat me të cilat përballen në veprimtaritë e përditshme ekonomike, marrëdhëniet me një sërë institucionesh dhe agjencish dhe nevojat për shërbime që sigurojnë mjete jetese të qëndrueshme në fshat.

Tabela 2: Rrethet dhe grupet e synuara të diskutimeve tematike

	Rrethet	Temat/veprimtaritë kryesore
1	Shkodër (Reç)	Gratë e angazhuara në mbledhjen dhe kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike
2	Dibër (Melan-Begjunec)	Gratë e angazhuara në kultivimin dhe përpunimin e frutave
3	Elbasan (Bradashesh)	Gratë e angazhuara në veprimtaritë jobujqësore
4	Korçë (Mollaj-Dvoran)	Gratë e angazhuara në kultivimin e kulturave bujqësore dhe frutave
5	Durrës (Ishëm - Fushë-Draç)	Gratë e angazhuara në agroturizëm

- b. Janë kryer 20 intervista gjysmë të strukturuar me ekspertë dhe përfaqësues të grupeve të prodhuesve femra gjatë të njëjtës periudhë

kohore. Janë zhvilluar intervista të ndryshme me juristë, vendimmarrës të politikave të ministrive të ndryshme, si Ministria e Bujqësisë (MBZHRAU), Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) dhe institucione të tjera që u ofrojnë shërbime grave në fshat. Janë marrë në intervistë edhe përfaqësuese të grupeve dhe shoqatave të prodhueseve, me përqendrim të çështjet bujqësore dhe jobujqësore. Pjesëmarrëset dhanë mendimet e tyre ose raste ilustruese (përfshirë edhe ngjarje të dëgjua dhe përvoja nga e shkuara) për temat e ndryshme të përmendura nga intervistuesit.

Është përdorur “metoda ortek”⁴ për të identifikuar grupet kryesore të interesit dhe drejtuesit e opinionit.

Një listë e plotë e personave të kontaktuar gjatë vizitave studimore gjendet në shtojcat e këtij studimi (shih Shtojcën 3).

- c. Është realizuar një anketë me afër 1017 gra në fshat dhe 309 burra në fshat, me pyetësorë të strukturuar (shih Shtojcën 1 dhe 2), të testuar në bashkëpunim të ngushtë me studiues të njohur në sferën e sociologjisë rurale (për shembull Susana Lastarria-Cornhiel). Intervistat janë kryer nga anketues të trajnuar, në bashkëpunim me dy studiues me përvojë. Të dhënat janë hedhur në formatin CSPRO, pasuar nga futja dhe pastrimi i të dhënave.

Objektivi kryesor i anketës është vlerësimi i kontributeve të grave në veprimtaritë ekonomike dhe të drejtat e tyre (veprimtari bujqësore dhe jobujqësore), si edhe i mundësive të tyre për të marrë shërbime të ndryshme.

Anëtarët kryesorë të ekipit kërkimor u ndanë në dy grupe, ku secili bashkërendonte dy grupe intervistuesish. Intervistuesit u morën me kohë të plotë, pasi u trajnuan në mënyrë të përshtatshme nga anëtarët e ekipit. Gjatë çdo vizite në terren u bë mbikëqyrje e përhershme e punës, ku anëtarët kryesorë të ekipit mbikëqyrnin cilësinë e intervistave.

4 Një teknikë e përzgjedhjes pa probabilitet të kampionit, ku subjektet ekzistuese të studimit rekrutojnë subjekte të ardhshme nga të njohurit e tyre.

2.3 PROJEKTIMI I STUDIMIT DHE ANALIZA E TË DHËNAVE

Struktura e studimit ndjek një qasje krahasuese, domethënë gratë në fshat krahasohen me burrat në fshat dhe me gratë dhe burrat në qytet, duke përdorur të dhëna dytësore.

2.3.1. ANALIZA E TË DHËNAVE DYTËSORE

Shqyrtimi i literaturës përfshin dokumente dhe raporte të nxjerra gjatë dekadës së fundit, ku analizohet zhvillimi ekonomik dhe shoqëror i grave. Për të eksploruar situatën shoqërore-ekonomike dhe demografike të grave në Shqipëri janë shfrytëzuar të dhënat dytësore të siguruar nga INSTAT, si Anketa e Forcës së Punës, Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, Anketa e Biznesit, Anketa e Përdorimit të Kohës dhe Censusi i Popullsisë dhe Banesave. Krahas kësaj, janë parë edhe raporte të OKB-së dhe të donatorëve të tjerë, të përqendruara te zonat rurale dhe projekte bujqësore, së bashku me strategjitë dhe planet e punës të hartuara nga institucione qendrore, si MBZHRAU, MZHETS dhe MMSR.

2.3.2. MODELI PËR ANALIZAT E TË DHËNAVE (NGA ANKETA)

Të dhënat janë analizuar duke përdorur teknika standarde statistikore me shumë ndryshore, me paketën Stata. Rezultatet kryesore janë analizuar nëpërmjet analizës përshkruese, ku janë përdorur frekuencat dhe tabulimi i kryqëzuar për të shqyrtuar prirjet kryesore. Është përdorur regresioni logjistik binar për të analizuar faktorët që ndikojnë në probabilitetin që një grua në fshat të ketë mundësi të barabartë përdorimi të mjeteve ose kontribut të barabartë në të ardhurat e familjes⁵.

Anketa ka dy komponentë kryesorë, një diagnostikues (D1), që përqendrohet te

5 Regresioni logjistik binar vlen më shumë kur dëshiron të modelosh probabilitetin e ngjarjes për një ndryshore me përgjigje kategorike me dy rezultate.

GRATE
ZONARU
EKONO
DIVER
SIFIKIM

kufizimet dhe pabarazitë; dhe një krahasues (D2), që përqendrohet tek analiza e dallimeve të situatës mes burrave dhe grave në fshat.

2.3.3. ANALIZA E DISKUTIMEVE NË GRUPE TEMATIKE

Udhëzimet dhe pyetjet për diskutimet në grupe tematike u hartuan pas analizës së të dhënave sasiore, për të eksploruar më tej të gjitha çështjet përkatëse apo konstatimet e rëndësishme të studimit sasior. Për t'i finalizuar instrumentet u përdor një metodë e kontrollit kolegjal.

Skenari i udhëzimeve për diskutimet në grupe tematike përfshinte një varg pyetjesh të hapura, të cilat përqendroheshin në temat kryesore të mëposhtme:

- Pjesëmarrja në vendimmarrje që prek fuqizimin ekonomik të grave
- Mundësia për të marrë shërbime financiare dhe sigurime
- Mundësia për të marrë shërbime shëndetësore, kujdes për fëmijët, ujë, transport dhe shërbime të tjera mbështetëse
- Pjesëmarrja në pagesat sociale që ofrohen për popullatën në fshat
- Mundësia për të përfituar informacion, teknologji dhe novacion
- Kërkesa për informacion dhe shërbime këshillimore, që prek zhvillimin e sipërmarrjes
- Qasja e përdorur për maksimizimin e objekteve dhe shërbimeve në fshat (burime të përbashkëta, si pyjet dhe kullotat)
- Qëndrimet kundrejt institucioneve të vendimmarrjes në nivel vendor dhe qendror
- Aftësia/pushteti për të ndryshuar mjedisin politik, institucional dhe ekonomik në fshat
- Veprimtari të lidhura me krijimin e të ardhurave

Diskutimet në grupet tematike u regjistruan me audio, për të siguruar që, nga diskutimet, të mos humbiste asnjë informacion. Secili grup tematik u drejtua nga një drejtues diskutimi dhe një asistent grupi, i cili mbajti shënime informacionet joverbale të nxjerra nga diskutimet.

Regjistrimet u zbardhën dhe u printuan për të ndihmuar kodifikimin dhe analizat (përfshirë edhe shënimet e asistentit). Pas kodifikimit me dorë të të dhënave, u krijuan një sërë kodesh përmes krahasimit të vazhdueshëm. Në një fazë të dytë u përzgjedhën kodet e përsëritura më shumë, të cilat u grupuan në kode të tjera të reja. Më pas, analiza i bashkoi grupet e kodeve në kategori dhe vërejti marrëdhëniet midis këtyre kategorive. Secili hap i analizës është realizuar sipas një metode të kontrollit kolegjal.

3. REZULTATET

Në rubrikën e parë të këtij kreu përshkruhen karakteristikat demografike të grave në fshat në Shqipëri, mbështetur në të dhënat dytësore. Në rubrikën e dytë jepet një përmbledhje e kufizimeve kryesore me të cilat përballen gratë që jetojnë në fshat. Në rubrikën e tretë paraqiten të drejtat dhe detyrat e grave që jetojnë në fshat. Në këtë rubrikë, konstatimet kryesore të anketës përdoren për të përshkruar të drejtat e grave mbi mjetet rurale brenda familjes dhe brenda fshatit, mbështetur në statusin që kanë në familje sa i takon përdorimit, shitblerjes, qirasë dhe trashëgimisë, si edhe uzufuktin të tokës së përbashkët (komunale). Në rubrikën e katërt paraqitet roli i grave si kontribuese në të ardhurat e përgjithshme të familjes. Në rubrikën e pestë shikohet shkurtimisht mundësia që u jepet grave për të pasur makineritë dhe pajisjet e nevojshme në veprimtaritë bujqësore. Në rubrikën e gjashtë përshkruhet me hollësi ndarja e punës midis burrave dhe grave në familjet që merren me bujqësi/njësitë ekonomike fshatare. Janë përdorur të dhëna të tjera dytësore (ANMJ, AFP, Anketa e Migrimit dhe Anketa e Përdorimit të Kohës), për të krahasuar dhe përshkruar pjesëmarrjen e grave në fshat në veprimtaritë me pagesë brenda familjes fshatare. Në rubrikën e shtatë, dhe të fundit, do të shohim kufizimet kryesore me të cilat përballen gratë sa i takon përfitimit nga mundësitë ekonomike. Kjo rubrikë përqendrohet në çështje të tilla si mundësia për të marrë arsim dhe formim profesional, mundësia për të marrë kapital dhe shërbime financiare, mundësia për të marrë transferta shtetërore dhe mundësia për të marrë informacion dhe teknologji, mundësia për të përfituar nga skema mbështetëse financiare dhe jofinanciare për zhvillimin rural, pjesëmarrje në organizatat dhe rrjetet rurale (shoqata, bashkime, grupe interesi etj.), pjesëmarrja në shërbime dhe autoritetet shtetërore vendore, si tatimi dhe votimi, dhe për të identifikuar kufizimet që pengojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e fermereve/fshatareve në jetën publike, siç janë grupet me bazë komunitetin, këshillat bashkiakë, grupet politike etj.

3.1. PRIRJET DEMOGRAFIKE

Lëvizjet e popullsisë dhe prirja e rritjes neto të popullsisë në Shqipëri po e ndryshojnë raportin e popullsisë midis fshatit dhe qytetit. Gjatë dekadës së fundit është vënë re një zvogëlim i popullsisë në fshat. Ndryshimi është më i theksuar në numrin e femrave që banojnë në fshat, i cili ka rënë me 8% (nga 60% në 52%) gjatë periudhës 2001-2013. Aktualisht, rreth 52% e popullsisë në fshat janë meshkuj dhe 48% janë femra (INSTAT, 2014).

Rënia e përqindjes së femrave, në raport me popullsinë gjithsej, ka lidhje me migrimin. Kjo prirje ndikohet nga vendimet familjare (martesa), arsimi dhe karakteristikat e tregut të punës. Shkaku kryesor që e shtyn popullsinë në fshat të largohet nga vendbanimi janë arsyet familjare, si martesa. Shkaku i dytë është punësimi.

Arsyet për migrimin e brendshëm dallojnë mes femrave në qytet dhe atyre në fshat. Edhe pse tri arsyet kryesore janë të njëjta, studimi vlerësohej si arsyeja e dytë dhe e tretë, përkatësisht, te gratë në qytet dhe ato në fshat.

Raporti i varësisë (një tregues tjetër i pozitave të pambrojtura) është rritur në fshatin shqiptar, në krahasim me qytetin. Sipas të dhënave, fëmijët dhe të moshuarit kanë më shumë gjasa të mbeten në fshat e të mos zhvendosen në qytet.

Një prirje tjetër e popullsisë në dekadën e fundit është fluksi hyrës i migruesve të kthyer pas pasojave të krizës financiare të vitit 2008. Ndërsa numri i të kthyerave u rrit me një shkallë të moderuar deri në vitin 2012 dhe pastaj ra paksa në vitin 2013, u regjistrua një rritje e fluksit hyrës të të kthyerve për periudhën 2011/2012, që përkon me kulmin e tronditjes ekonomike në vendet kryesore të migrimit: Itali dhe Greqi (INSTAT, 2014). Sfidat, si për gratë, ashtu edhe për burrat, migrues të kthyer, janë të larta, por dallojnë sa i takon natyrës.

Një studim me grupe diskutimi tematike, i realizuar nga ACSER (2012), ka konstatuar se përvoja e migrimit ka luajtur një rol të rëndësishëm në lirinë e lëvizjes për gratë, sidomos për gratë në qytet. Migrimi e ka ndryshuar qëndrimin e partnerëve kundrejt lirisë së lëvizjes dhe lirisë së shprehjes. Migrimi dhe mungesa e

ndërhyrjeve nga anëtarët e tjerë të familjes ka ndihmuar në përqaftimin e normave të reja shoqërore dhe kulturore që mbizotërojnë në vendin e migrimin.

3.2. SITUATA SHOQËRORE-EKONOMIKE E GRAVE NË FSHAT

3.2.1. KUSHTET E JETESËS

Për të eksploruar kushtet e jetesës të grave në fshat janë përdorur matje dhe tregues të ndryshëm si: të ardhurat, shpenzimet, dinamikat e pushtetit mes anëtarëve të familjes etj.

Studimi krahasues tregon se më pak se 25% e pjesëmarrësve në të i konsiderojnë të ardhurat e familjes si jo të mjaftueshme për ushqim, ndërsa 25% të tjerë i konsiderojnë të ardhurat të mjaftueshme vetëm për ushqim. Nuk ka dallime të forta, kur treguesi zbërthehet sipas përkatësisë gjinore (shih tabelën 3).

Tabela 3: Vetëvlerësimi i të ardhurave të familjes, sipas gjinive

P. 51. E. Si i konsideroni të ardhurat e familjes	meshkuj	femra
1. Nuk janë të mjaftueshme për ushqim	23%	24%
2. Janë të mjaftueshme vetëm për ushqim	37%	34%
3. Janë të mjaftueshme vetëm për ushqim dhe veshje	26%	22%
4. Janë të mjaftueshme vetëm për ushqim, veshje dhe blerje të pajisjeve shtëpiake	12%	15%
5. Janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat për ushqim, veshje, pajisje shtëpiake dhe për të shkuar me pushime	2%	4%
6. Mjaftojnë për të bërë blerje të mëdha, si shtëpi dhe automjet	0%	1%
Gjithsej	100%	100%

BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT KRAHASUES

Vlerësime plotësuese për kushtet e jetesës të grave në fshat dalin edhe nga rezultatet e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ, 2012). Një tregues i rëndësishëm është indeksi i varfërisë. Ky tregues kërkon të identifikojë dallimet midis familjeve me kryefamiljare dhe familjeve me kryefamiljarë. Konsumi gjithsej, konsumi për frymë dhe konsumi ushqimor për frymë i familjes me kryefamiljare është më i ulët në fshat, se ai i familjes me kryefamiljar. Ndërsa arsimit dhe shërbimet, gjithsej, duken që janë më pak të pabarabarta në krahasim me nëntreguesit e tjerë. Nuk ka dallime të mëdha sa i takon konsumit joushqimor dhe konsumit për mallra me përdorim afatgjatë për frymë. Gjithashtu, sipas AMNJ 2012, shpenzimet mujore të familjeve me kryefamiljare janë paksa më inferiore se për pjesën tjetër. Dallimi është i dukshëm sidomos tek ato familje që deklarojnë se janë në nivelin e fundit të shpenzimeve mujore. Kontrasti është më i fortë në fshat se në qytet (tabela 4).

Pabarazitë, sa u takon shpenzimeve dhe konsumit, për ushqime janë në korrelacion me perceptimet, sa i takon lumturisë dhe pushtetit. Pjesëmarrëset nga familjet e drejtuara nga kryefamiljare janë më pak të lumtura për situatën aktuale

Tabela 4: Shpenzimet mujore për familje, sipas zonës (fshat/qytet) dhe përkatësisë gjinore të kryefamiljarit, Shqipëri, 2012

Shpenzimet mujore në lekë	qytet		fshat	
	mashkull	femër	mashkull	femër
0 - 50.000	6,3%	6,2%	10,6%	12,8%
50.001 - 150.000	7,0%	14,4%	16,8%	24,7%
150.001 - 300.000	30,8%	28,0%	41,0%	33,7%
300.001 - 500.001	28,1%	26,0%	20,7%	21,5%
500.001 - 800.000	17,4%	16,0%	8,4%	5,7%
800.001 - 1.000.000	6,2%	5,5%	1,5%	0,8%
>1.000.001	4,3%	4,0%	1,0%	0,7%

BURIMI: AMNJ, 2012

në krahasim me burrat, e sidomos më shumë në fshat (AMNJ, 2012). Ato mendojnë se kanë më pak të drejta në krahasim me gratë e tjera në qytet. Gjithashtu, më pak se 5% e familjeve me kryefamiljare të intervistuar mendojnë se kanë të drejta dhe pushtet në vendimmarrje (AMNJ, 2012). Siç e thotë qartë edhe Sevim Arbana, kryetare e shoqatës “Në dobi të gruas shqiptare”: “Situata e arsimit dhe punësimit të grave është më keq seç ishte përpara vitit 1990. Politikat shtetërore gjatë këtyre 20 vjetëve në këtë sferë nuk kanë qenë adekuate për gratë në fshat. Çdo nismë që është ndërmarrë (madje edhe ato që janë financuar nga donatorë) për përmirësimin e jetës së grave nuk ka pasur qëndrueshmëri në kohë dhe efektivitet. Ligjet e shtetit janë në mbështetje të gruas, por nuk ka struktura për t’i zbatuar me forcë ato.”

Studimi ynë krahasues tregon përfundime të ngjashme (shih figurën 1 dhe 2). Më shumë burra se gra deklarojnë se gëzojnë të drejta të barabarta në çdo vendim. Më shumë gra se burra u japin më pak vlerë të drejtave të tyre, për hir të ruajtjes së qëndrueshmërisë në familje.

Më shumë gra se burra kanë prirjen të zbatojnë parimet zakonore tradicionale dhe jo ligjet, kur vjen puna te të drejtat mbi tokën.

Kushtet ekonomike i prekin marrëdhëniet midis grave dhe burrave në fshat. Përqindja e lartë e papunësisë, shkallët e larta të varfërisë dhe normat e rrepta shoqërore në shoqërinë fshatare i vendosin në pozita të pabarabarta burrat dhe gratë, duke favorizuar konfliktet dhe dhunën në familje (figura 3). Sa më të rënda kushtet ekonomike, aq më e lartë është përhapja e dhunës mes anëtarëve të familjes, sidomos kundrejt grave. Të dhënat e anketave të INSTAT-it tregojnë një shkallë më të lartë të dhunës në familje, të çdo lloji, në fshat në krahasim me qytetin.

Figura 1: Pushteti dhe qëndrimet brenda familjes (meshkuj)

Shumë	72%	1%	48%	13%
Mjaftueshëm	11%	0%	13%	8%
Pak a shumë	7%	2%	9%	3%
Mesatarisht	3%	3%	15%	13%
Pak	1%	3%	4%	5%
Shumë pak	2%	10%	3%	14%
Aspak	3%	81%	8%	44%



P.58. MË PËLQEN QË UNË DHE IME SHOQË I MARRIM VENDIMET BASHKË NË SHTËPI



P.59. MENDIMI IM NUK MERRET ASNJËHERË PARASYSH NË FAMILJE



P.60. MENDOJ SE ËSHTË MË RËNDËSISHME TË KEM QËNDRUESHMËRI NË FAMILJE SE TË KEM TË DREJTA



P.61. PARAPËLQEJ TË ZBATOJ ZAKONET SE TË DREJTAT QË MË JEP LIGJI PËR SA I PËRKET PRONËS

Figura 2: Pushteti dhe qëndrimet brenda familjes (femra)

Shumë	55%	2%	39%	15%
Mjaftueshëm	14%	3%	19%	11%
Pak a shumë	15%	6%	13%	10%
Mesatarisht	9%	10%	12%	15%
Pak	4%	11%	11%	9%
Shumë pak	3%	20%	3%	13%
Aspak	1%	48%	2%	27%



P.58. MË PËLQEN QË UNË DHE IM SHOQ I MARRIM VENDIMET BASHKË NË SHTËPI



P.59. MENDIMI IM NUK MERRRET ASNJËHERË PARASYSH NË FAMILJE




P.60. MENDOJ SE ËSHTË MË RËNDËSISHME TË KEM QËNDRUESHMËRI NË FAMILJE SE TË KEM TË DREJTA



P.61. PARAPËLQEJ TË ZBATOJ ZAKONET SE TË DREJTAT QË MË JEP LIGJI PËR SA I PËRKET PRONËS

Figure 3: Domestic violence ever by women's residence, in (%)



66.9%

65.3%

27.2%

9.1%



DOMESTIC VIOLENCE
(ALL TYPES-EVER)



PSYCHOLOGICAL
VIOLENCE



PHYSICAL
VIOLENCE



SEXUAL
VIOLENCE


3.2.2. KUFIZIMET KRYESORE DHE STRATEGJITË E PERCEPTUARA PËR RRUGËZGJIDHJET

Kufizimet dhe sfidat në zhvillimin e veprimtarive bujqësore prekin shumicën e pjesëmarrësve në studim. Studimi krahasues tregon se shumica e burrave (37%) identifikojnë kostot e larta të agrokimikateve si vështirësinë kryesore që pengon rritjen e të ardhurave të familjes (figura 4). Ndërsa vetëm 19% e grave pohojnë se kostoja e lartë e agrokimikateve është një shpenzim mjaft i rëndësishëm. Si burrat, ashtu edhe gratë, argumentojnë se mundësia e pakët për të pasur ujitje përbën një problem që i prek negativisht të ardhurat e familjes. Gjithashtu, si burrat, ashtu edhe gratë, kanë perceptime të ngjashme kur identifikojnë koston e lartë të mekanizimit, mungesën e mundësive për punësim në veprimtari jobujqësore dhe lidhjen e pakët me tregjet bujqësore, si faktorë që u pengojnë të ardhurat. Ndërsa problemet e lidhura me shërbimet këshillimore dhe mundësinë për të pasur lidhje transporti me komunën më të afërt nuk perceptohen si çështje të rëndësishme së parë në aspektin e rritjes së të ardhurave të familjes.

Shumica e pjesëmarrësve (34% e burrave dhe 31% e grave) mendojnë se, për të përmirësuar mjetet e jetesës në fshat, qeveria do të duhej të mbështeste kryesisht bujqësinë (figura 5). Gratë në fshat (30% në krahasim me 25% të burrave) e klasifikojnë “krijimin e vendeve të punës në veprimtari jobujqësore” si sfidën kryesore që lipset të marrë zgjidhje nga qeveria. Këta pjesëmarrës të studimit e shohin punësimin jashtë veprimtarive tipike bujqësore si një faktor të rëndësishëm për përmirësimin e mjeteve të jetesës. Një kufizim tjetër i rëndësishëm i identifikuar nga 25% e grave dhe 22% e burrave është ujitja. Një konstatim interesant është se hyrja në tregun bujqësor dhe mundësia për të marrë kredi, në dukje, nuk perceptohen si çështje të rëndësishme së parë që prekin mjetet e jetesës në fshat.


Bujqësia konsiderohet si veprimtaria ekonomike kryesore për ndërtimin e një jete më të mirë në fshat. Shumica e pjesëmarrësve të studimit (34% e burrave dhe 22% e grave) do të zgjidhnin kultivimin e kulturave frutore dhe bujqësore si veprimtari ekonomike për t’u zgjeruar më tej, duke qenë se ka një potencial të ndjeshëm për rritjen e të ardhurave të familjeve (figura 6). Vetëm 15% e burrave dhe 13% e grave mendojnë se përqendrimi te bagëtia është veprimtaria më e rëndësishme

Figura 4: Pengesat kryesore ndaj rritjes së të ardhurave të familjes, sipas përkatësisë gjinore, rëndësia e parë




bujqësore. Një numër i lartë fermerësh (17% e burrave dhe 15% e grave) janë të mendimit se emigrimi mund t'u ofronte një të ardhme më të mirë. Punësimi në sektorin privat dhe atë publik gjithashtu zgjidhet nga 8% e burrave dhe 15% e grave, si punë me potencial, që siguron qëndrueshmëri ekonomike.

Figura 5: Kufizimet që duhet të marrin zgjidhje, në mënyrë që të përmirësohen mjetet e jetesës në fshat, rëndësia e parë



BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT KRAHASUES

Figura 6: Veprimtaria kryesore për të zhvilluar një të ardhme më të mirë, rëndësia e parë



BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT KRAHASUES

3.3. TË DREJTAT MBI TOKËN BUJQËSORE

3.3.1. VËSHTRIM LIGJOR MBI BARAZINË GJINORE PËR TOKËN

Në Shqipëri të drejtat individuale mbi tokën, si pronësia mbi tokën, hynë në fuqi vetëm në fillim të viteve '90 të shekullit XX, nëpërmjet një reforme të tokës, e cila

i shpërndau kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe ua kaloi, pa pagesë, titujt e pronësisë mbi tokën ish-anëtarëve të këtyre subjekteve. Toka bujqësore u nda në mënyrë të barabartë mes banorëve të fshatrave, në bazë të numrit të frymëve. Por kjo nuk ndodhi në çdo krahinë të vendit. Të drejtat zakonore kanë epërsi në disa zona; afër 15-20% e tokës bujqësore është ndarë me vullnet të përbashkët të anëtarëve të komunitetit, në bazë të të drejtave të pronësisë, sipas të parëve të familjes (pronarë të tokës përpara vitit 1945⁶). Për rrjedhojë, kur vlerësojmë të drejtat e tokës në Shqipëri, ka dy lloje të drejtash që respektohen: të drejtat ligjore dhe të drejtat zakonore⁷.

Të drejtat ligjore të grave mbi pronën parashikohen me Ligjin nr. 7501⁸, datë 07.19.1991, i cili rregullonte reformën e tokës të vitit 1991, dhe me aktet e tjera ligjore të rrjedhura nga Kushtetuta e Shqipërisë⁹ (neni 18), Kodi i Familjes (nenet 74-77)¹⁰ dhe Kodi Civil (neni 223)¹¹. Ky legjislacion siguron që gratë dhe burrat shqiptarë të kenë të drejta të barabarta mbi tokën.

Por ka disa elemente të paqarta në lidhje me nenin 223 të Kodit Civil¹². Megjithëse

-
- 6 Reforma e tokës nuk është zbatuar (plotësisht) në zona të ndryshme të vendit. Afërsisht 15-20% e tokës bujqësore, kryesisht në zonat malore në verilindje të vendit, iu shpërnda "pronarëve të vjetër" që prej përpara kolektivizimit (ose pasardhësve të tyre), në bazë të marrëveshjes reciproke në komunitetet përkatëse (Morone, 1997; Bardhoshi, 2004). Në disa zona është përdorur një trajtim miks, duke shpërndarë tokën sipas numrit të frymëve, por duke respektuar sinorët përpara kolektivizimit (Kodderitzsch, 1999).
 - 7 Studimet e bëra në shumë zona të Shqipërisë, në fillim të reformës, kanë konstatuar se grave nuk u është dhënë e drejta për të pasur ose kontrolluar tokë dhe pronë, as si anëtare e familjes, as si kryefamiljare (Lemel, 2000; Wheeler, 2000; Guri, 2007; Zhllima e të tjerë, 2010).
 - 8 Shih <http://www.qbz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%207501%20Dat%C3%AB%2019-07-1991.htm> .
 - 9 Shih http://www.parlament.al/web/pub/kushtetuta_perditesuar_15171_1.pdf .
 - 10 Shih http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2012/PDF-2012/Kodi%20i%20familjes-2012.pdf .
 - 11 Shih http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2012/PDF-2012/Kodi%20Civil-2012.pdf .
 - 12 Neni 223 i Kodit Civil parashikon sa vijon (shih nenin 223): "Familja bujqësore përbëhet nga personat që lidhen ndërmjet tyre për shkak gjinie, martesë, birësimi ose pranimit si anëtar i saj. Kur anëtari i familjes kërkon (si pasojë e martesës lidhja me familjen ndërpritet) një pjesë të veçantë të saj, pjesa vlerësohet dhe jepet në të holla. Kur pjesëtimi kërkohet nga disa pjesëtarë të familjes bujqësore, me qëllim që të krijohet një familje tjetër bujqësore, pjesa mund të jepet në natyrë, me kusht që toka bujqësore që u mbetet familjeve të ndara të mos jetë nën minimumin e njësisë minimale të kultivimit. Me njësi minimale të kultivimit kuptohet toka bujqësore që është e

gratë kanë të drejtën e bashkëpronësisë mbi pasuritë e familjes (në të cilën gruaja lind), atyre u duhet ta pretendojnë këtë drejtë, duke qenë se pas martesë ajo bëhet anëtare e familjes së bashkëshortit. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh përmasat shumë të vogla të fermës familjare (1,2 ha) dhe përmasat e vogla të parcelave (mesatarisht 0,3 ha), nuk është e realizueshme ndarja e tokës, sepse kjo krijon kufizime të konsiderueshme për zhvillimin e bujqësisë. Gjithashtu, ligji është i paqartë sa i takon kuadrin që rregullon rastin e divorceve (Mandro-Balili, 2012).

Një shqetësim tjetër, sa i takon kuadrin ligjor, ka të bëjë me mungesën e qartësisë se kush gëzon të drejtën mbi tokën, duke qenë se titujt e parë të tokave i janë dhënë kryefamiljarit. Shumica e familjeve në fshat ende i përdorin këta tituj toke dhe nuk e ndiejnë nevojën për t'i përditësuar dhe për të marrë titullin përfundimtar, që është "Certifikata e pronësisë". Në këtë dokument të fundit me ligj kërkohet që të shkruhen emrat e të gjithë anëtarëve të familjes. Mirëpo, ekziston rreziku që, grave të cilat nuk e kanë emrin në titullin e tokës (kur gruaja ka hyrë në familje pas vitit 1991, apo edhe në raste të tjera), të mos u jepen të drejta pronësie, megjithëse janë anëtare të familjes. Në fshatin shqiptar janë të rëndomta rastet e shitjes së pronës, në rast halli të ngutshëm, nga ana e kryefamiljarit, pa e informuar gruan ose duke e shtrënguar gruan të japë miratimin e saj¹³.

Rezultatet, si të anketës diagnostikuese, ashtu edhe të asaj krahasuese, që paraqiten në nënrubrikat e mëposhtme, tregojnë qartë shqetësimet në lidhje me mungesën e ndërgjegjësimit për të drejtat ligjore në shoqëritë fshatare, një përdorim të madh të të drejtave zakonore dhe një besim të ulët të grave të deklarimi i të drejtave të tyre apo, madje, edhe një "vetëpërrjashtim" të grave.

nevojshme për mbajtjen e një ekonomie bujqësore, sipas kushteve natyrore të krahinës apo zonës përkatëse."

- 13 Një tregues i mbizotërimit mashkullor në vendimet për të drejtat mbi pronën është përqindja shumë e ulët e grave që kryejnë veprime me pronat. Këto veprime zakonisht kryhen nga burrat. Mbështetur në evidenca, një studim i kohëve të fundit, realizuar nga FAO dhe Banka Botërore (2014), konstatonte se vetëm një pjesë shumë modeste e veprimeve me tokën kryhen nga gratë. Gjithashtu, i njëjti studim bën të ditur se 2/3 e regjistrave shqiptarë të pasurive të paluajtshme nuk e identifikojnë përkatësinë gjinore të pronarit. Statistikat e pjeshme që ofron ky studim tregojnë se, nga 27 000 gra që kanë pronësi, 1/3 kanë pjesë në pronë në më pak se 25%, ndërsa 1/3 kanë pjesë në pronë nga 50% deri 99%.

3.3.2. TË DREJTAT FORMALE DHE TË DREJTAT JOFORMALE

Teoritë e institucioneve të tokës tregojnë se ka një dualitet të përdorimit të institucioneve formale dhe joformale në vendet në tranzicion. Megjithëse shteti merr rolin e zbatuesit me forcë, administrimi i të drejtave të tokës shpesh mbështetet te “normat komunitare”. Për rrjedhojë, administrimi i tokës brenda familjes shfaq një mospërputhje të qartë, një konflikt midis institucioneve formale, institucioneve/traditave joformale që janë trashëguar nga periudha përpara komunizmit dhe atyre që lindën pas rënies së komunizmit (Nelson e të tjerë, 1997; Conning e të tjerë, 2006).


Anketa jonë tregon se përparësi kanë marrë institucionet joformale. Vendimet afatgjata për tokën, si shitblerja e tokës dhe trashëgimia e tokës, mbështeten kryesisht te të drejtat zakonore. Studimi krahasues tregon se thujse një e dyta e pjesëmarrësve në të nuk janë të informuar për ligjin e tokës (tabela 5). Nuk ka ndonjë dallim të konsiderueshëm midis njohurive të grave dhe të burrave për ligjin e tokës. Shumica e grave janë të informuara lidhur me ligjin e tokës dhe e dinë se Ligji nr. 7501 (ligji i reformës së tokës) u jep të drejta të barabarta burrave dhe grave (tabela 6).

Shumica e fermerëve e mbajnë mend shpërndarjen e tokës, megjithëse informacioni që disa i pakët dhe i fragmentuar. Një grup burrash nga Berati thanë, gjatë një diskutimi tematik, se “nuk e dinim asokohe se çfarë po bëhej me tokën; nuk ia kishin idenë pronësisë private”. Një grua nga Dibra tha se “Nuk ke çfarë të dish për ligjin e tokës, sepse ligji as u mor fare parasysh në fshatin tonë kur u shpërnda kooperativa. Toka u shpërnda mes familjeve sipas kufijve që kanë qenë përpara vitit 1945”. Shumica e grave e kujtonin ditën e ndarjes së tokës si “mbledhja e burrave”. Kjo traditë vazhdon edhe sot.

Shumica e pjesëmarrësve të studimit thonë se fëmijët që kanë lindur pas reformës së shpërndarjes së tokës nuk kanë të drejta të barabarta në krahasim me ata që kanë lindur përpara. Ligji i tokës nuk bën asnjë dallim në këtë aspekt. Por shumica e pjesëmarrësve nuk janë të informuar për këtë aspekt të ligjit (tabela 7).

Pjesëmarrësve iu kërkua gjithashtu të zgjidhnin/tregonin mekanizmat/institucionet

Tabela 5: Informimi për ligjin e tokës



SOURCE: COMPARATIVE SURVEY RESULTS

kryesorë të cilët besonin vendimmarrjen në lidhje me shitblerjen e tokës, dhënie me qira, trashëgiminë dhe ndërtimin e shtëpive (tabela 8). Për shitblerjen e tokës, pjesëmarrësit i besojnë “ligjit” (që nënkupton kuadrin zyrtar, institucional dhe ligjor). Por thuhet një e treta e pjesëmarrësve e konsiderojnë më të rëndësishme vendimmarrjen në familje. Për trashëgiminë e tokës vendimi në familje është faktori kryesor për 41% të pjesëmarrësve. Edhe këtu vendimi në familje është dukshëm faktori kryesor: 68% e pjesëmarrësve kanë përzgjedhur këtë përgjigje. Është mirë ta marrin me kujdes frazën “vendim në familje”, sepse jo medoemos nënkupton vendim me konsensus. Në disa raste, vendim në familje mund të nënkuptojë që vendimin e merr kryefamiljari (mashkull).

Tabela 6: Përcaktimi i të drejtave me ligj mbi tokën

P. 48. Nëse po, si i përcakton ligji të drejtat mbi tokën?	M		F		Gjithsej	
	Frek.	%	Frek.	%	Frek.	%
1. Bashkëshortit më shumë se bashkëshortes	2	1%	1	1%	3	1%
2. Bijve më shumë se bijave	3	2%	1	1%	4	1%
3. Djalit më të madh më shumë se djalit më të vogël	0	0%	0	0%	0	0%
4. Të gjithëve barabar	132	92%	130	97%	262	95%
5. Tjetër (shpjegoni)	6	4%	2	1%	8	3%
Gjithsej	143	100%	134	100%	277	100%

BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT KRAHASUES

Tabela 7: Të drejtat e fëmijëve mbi tokën, të zërthyera sipas përkatësisë gjinore të pjesëmarrësit që i përgjigjet pyetjes (përpara vitit 1991 dhe pas vitit 1991)

P. 37. A mendoni se fëmijët e lindur pas vitit 1991 kanë të njëjta të drejta me ata që kanë lindur përpara vitit 1991, kur u dha toka?	M		F		Gjithsej	
	Frek.	%	Frek.	%	Frek.	%
1. Po	90	29%	83	27%	173	28%
2. Jo	175	56%	153	50%	328	53%
3. Nuk e di	12	4%	30	10%	42	7%
4. NA	38	12%	43	12%	81	13%
Gjithsej	315	100%	309	100%	624	100%
Total	143	100%	134	100%	277	100%

BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT KRAHASUES

Tabela 8: Institucionet të cilave u besohet vendimarrja për shitblerjen dhe trashëgimin e tokës

Vendimi për tokën	Shitja e tokës						Trashëgimi i tokës					
	D1		D2				D1		D2			
	Femra		Meshkuj		Femra		Femra		Meshkuj		Femra	
	Frek.	%	Frek.	%	Frek.	%	Frek.	%	Frek.	%	Frek.	%
Ligji	275	39%	204	65%	152	49%	120	17%	153	49%	130	42%
Trashëgimia zakonore	49	7%	12	4%	3	1%	107	15%	52	17%	32	10%
Vendim nga burri	62	9%	10	3%	54	17%	101	14%	9	3%	45	15%
Vendim në familje	301	43%	83	26%	88	28%	364	52%	94	30%	97	31%
Tjetër	13	2%	6	2%	10	3%	8	1%	7	2%	3	1%
Pa përgjigje	2	0%	0	0%	2	1%	2	0%	0	0%	2	1%
Gjithsej	702	100%	315	100%	309	100%	702	100%	315	100%	309	100%


SOURCE: COMPARATIVE SURVEY RESULTS

3.3.3. PËRFSHIRJA FORMALE NË TITUJT E TOKËS

Rezultatet e anketës tregojnë se 80% e titujve të tokës janë në emër të kryefamiljarit ose të ish-kryefamiljarit (vjeçrit, babait ose gjyshit). Gjithashtu, studimi krahasues tregon se afërsisht 70% e anëtarëve gjithsej me emrin në titull janë meshkuj (shih tabelën 9). Ky mbizotërim i meshkujve vjen si rezultat i regjistrimit të parë të kryefamiljarëve në titujt e tokës.

Pjesëmarrësit iu përgjigjën pyetjes nëse kishin informacion lidhur me mbajtjen e titujve të tokës. Për ta kuptuar më mirë këtë çështje, pjesëmarrësve iu kërkua të përgjigjeshin nëse kishin parë ndonjëherë një titull toke. Më shumë se një e treta e tyre thanë se nuk kanë parë. Niveli arsimor i pjesëmarrësit ka shumë rëndësi. Arsimi i lartë e rrit nivelin e dijenisë së pjesëmarrësit për ekzistencën e titullit të tokës.

Tabela 9: Anëtarët e regjistruar në titujt e tokës, sipas seksit



Mungesa e interesit nga gratë, për titujt e tokës, lidhet me mungesën e besimit që kanë gratë për t'u marrë me çështjet e lidhura me tokën. Sipas shumë prej tyre kjo është një detyrë e bashkëshortit. Siç tha edhe një grua nga Elbasani: "Nuk di asgjë për titujt unë, meqë nuk kam punë unë me këtë, prandaj nuk i kërkoj."

Shumica e pjesëmarrëseve gra në grupet e diskutimeve tematike thanë se nuk kanë kërkuar asnjëherë që t'u shkruhet emri në certifikatën e pronësisë. Gjithashtu, gratë thanë se nuk donin t'ia dinin se emri i kujt shkruhet në certifikatë. Edhe pse gratë fituan të drejtën e tokës në familjen e re, shumë prej tyre thanë se certifikatat e pronësisë qenë marrë më vonë dhe në to shkruhej vetëm emri i bashkëshortit. Siç tha njëra prej tyre:

3.3.4. PERCEPTIMI PËR TË DREJTAT E BARABARTA MBI TOKËN

Të drejtat e pronësisë ushtrohen kryesisht nga meshkujt e familjes. Një pjesë e mirë e pjesëmarrësve thanë se toka është në pronësi të meshkujve të familjes. Kur u pyetën gratë për të drejtat e pronësisë mbi tokën bujqësore, thanë se afërsisht 40% e parcelave janë në pronësi të familjes. Gjithashtu, studimi diagnostikues tregon se rreth 36% e parcelave janë në pronësi të bashkëshortit të pjesëmarrëses (shih tabelën 10).

Megjithëse gratë deklarojnë se kryefamiljari është pronari i tokës, ato nuk duket se ndihen si të pabarabarta lidhur me të drejtat e tyre mbi tokën. Çuditërisht, më

Nuk ia kisha idenë, burri shkoi të kërkonte certifikatën dhe kur e mori e kishte me emrin e vet.
(DVORAN, 45 VJEÇE)

E kam në emrin e burrit, komandantit. (FUSHË-DRAÇ, 45 VJEÇE)

Tabela 10: Perceptimi për të drejtën e pronësisë mbi tokën

P. 30. Sipas mendimit tuaj, kush i ka të drejtat e pronësisë mbi këtë tokë?	D1	D2
	D1	D2
	% e parcelave	% e pjesëmarrësve
1. Unë	5%	14%
2. Bashkëshorti/Bashkëshortja	36%	9%
3. Vjehri ose gjyshi	6%	2%
4. Vetëm bijtë	1%	6%
5. Të gjithë meshkujt e familjeve	9%	14%
6. Të gjithë anëtarët e familjes që qenë gjallë në vitin 1991	18%	22%
7. Të gjithë burrat dhe gratë, përfshirë edhe ata që kanë lindur në këtë familje pas vitit 1991	16%	28%
8. Tjetër	9%	5%
Gjithsej	100%	100%

BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT DIAGNOSTIKUES DHE KRAHASUES

shumë se 80% e grave deklarojnë se kanë të njëjtën të drejtë pronësie. Megjithëse është disi e paqartë, kjo deklaratë tregon se gratë lënë të kuptosh se kryefamiljari është përfaqësuesi i interesit të familjes. Në respektim të normave gjinore tradicionale, gratë e fitojnë të drejtën për të pasur tokë përmes lidhjes familjare me babanë ose bashkëshortin.

3.3.5. PERCEPTIMI PËR BARAZINË E TË DREJTAVE TË TOKËS DHE FAKTORËT PËRCAKTUES PËR TË

Është kryer analiza e regresionit logjistik binar për të vlerësuar faktorët që shoqërojnë barazinë e të drejtave mbi tokën. Rezultatit e perceptimeve për barazinë e drejtave mbi tokën e konsiderojmë si një ndryshore të varur, ndërsa topografia e zonës, distanca nga qendra kryesore urbane, niveli arsimor, vendndodhja e familjes së origjinës, punësimi dhe toka për anëtarë familjeje janë ndryshore të pavarura.

Të gjithë këta faktorë, me përjashtim të të qenit kontribues kryesor me të ardhura, gratë e përfshira në veprimtari jobujqësore dhe që e kanë nga i njëjti fshat, prekin në mënyrë të konsiderueshme nivelin e barazisë së perceptuar të grave për të drejtat mbi tokën.

Siç pritej, nëse je në një fshat të largët nga qendrat urbane, i cili ndodhet në zona të largëta (kodrinore ose malore), e ul barazinë e perceptuar për të drejtat mbi tokën. Perceptimi i barazisë në lidhje me vendimmarrjen mbi pasuritë në bashkëpronësi nga familja e origjinës e rrit probabilitetin e të drejtave të barabarta të perceptuara mbi tokën, në krahasim me meshkujt. Gjithashtu, sa më pak tokë për frymë dhe sa më shumë vend të zërë bujqësia në të ardhurat gjithsej, aq më i fortë perceptimi i pabarazisë nga gratë në lidhje me të drejtat e tyre mbi tokën. Sa më e madhe moshja e grave, aq më të pakta janë mundësitë për t'u ndier të barabarta lidhur me mundësinë për të pasur tokë. Gratë e informuara për ligjet e tokës dhe gratë me mundësi për të marrë shërbimeve agronomike kanë më shumë gjasa të perceptojnë barazi në pasjen dhe përdorimin e tokës.

3.3.6. TRASHËGIMI I TOKËS

Procesi i vendimmarrjes në familje lidhur me trashëgimin e tokës paraqet disa modele të qarta. Shumica e grave janë në dijeni të faktit se meshkujt janë trashëgimtarët kryesorë të pasurive të familjes. Afërsisht 55% e parcelave (studimi

Tabela 11: Perceptimet për trashëgiminë në të ardhmen (familja ku ndodhen)

P. 31. Kush ka më shumë gjasë ta trashëgojë këtë tokë në të ardhmen?	D1		D2		përgjigje e vlefshme
	Frek. e parcelave	%	Frek. e pjesëmarrësve	%	
Më shumë se një mundësi zgjedhjeje					
1. Vetëm bijtë	1446	36%	191	30	33%
2. Djali që jeton me ne do të marrë më shumë	498	12%	77	12	13%
3. Vetëm djemtë që qëndrojnë në fshat, në pjesë të barabarta	299	7%	25	4	4%
4. Fëmijët në mënyrë të barabartë, si vajzat, ashtu edhe djemtë, që qëndrojnë në shtëpi	306	8%	20	3	3%
5. Vajzat e martuara, më pak	30	1%	1	0	0%
6. Vajzat e martuara, asgjë	14	0%	0	0	0%
7. Të gjithë anëtarët e familjes që qenë gjallë në vitin 1991	553	14%	64	10	11%
8. Të gjithë burrat dhe gratë, përfshirë edhe ata që kanë qenë në këtë familje pas vitit 1991	485	12%	164	26	28%
9. Tjetër	377	10%	92	14	7%
Gjithsej	4008	100%	634	100	100%

BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT DIAGNOSTIKUES DHE KRAHASUES

*Toka është e vëllezërve,
nuk e dua unë.* (DVORAN,
39 VJEÇE)

*Për ne, vajzat e shtëpisë,
kur martohemi na
japin pajë, nëse i kanë
mundësitë. Gjithashtu,
dasmën (mishin,
muzikën) e paguajnë
xhaxhallarët, nëse i
kanë mundësitë. Kaq i
jepet vajzës, se kështu
është zakon, megjithëse
sikur nuk është e drejtë.*
(BEGJUNEC, 53 VJEÇ)

diagnostikues) ka më shumë gjasë të trashëgohen nga bijtë (në disa raste më shumë tokë i jepet atij që qëndron me prindërit). Këto rezultate i vërteton edhe studimi krahasues – 50% e pjesëmarrësve thonë se ua japin tokën bijve (tabela 11).

Studimi shikon perceptimet e grave për të drejtat mbi tokën nga perspektiva e familjes së origjinës. Shumica e grave pjesëmarrëse në studim thanë se familja e tyre e origjinës ka tokë. Por, më shumë se një e dyta e këtyre grave nuk perceptojnë se kanë ndonjë të drejtë trashëgimie. Më shumë se një e treta e pjesëmarrësve mendojnë se toka do të ndahet nga prindërit (familja e origjinës), sipas zakonit ose sipas vendimit/mendimit të babait dhe vëllezërve, por jo sipas ligjit të shtetit; vetëm rreth 22% e grave mendojnë se do të trashëgojnë një pjesë të tokës sipas ligjit. Gjithashtu, 10% e grave të intervistuar, pavarësisht që qenë në dijeni të të drejtave të tyre, nuk kërkojnë asnjë pjesë në tokë. Siç kanë thënë vetë: “Vajzën nuk e ke tënden, vajza rritet në një ‘familje të huaj’, që të shkojë më pas në familjen e vërtetë (familja e bashkëshortit)”, ose “‘Një vajzë e mirë’ nuk do të kërkonte tokë nga prindi dhe vëllai.” Këto janë dëshmi të qarta vetëpërrjashtimi në bazë të zakonit, meqë “as nëna ime dhe as gra të tjera nuk kanë kërkuar tokë. Edhe ne kështu do të vazhdojmë.”

Edhe burrat kanë mendim të ngjashëm. Afërsisht 60% e burrave të intervistuar në studimin krahasues nuk u njohin asnjë të drejtë trashëgimie grave të familjeve të tyre. Mosdhënia e tokës grave konsiderohet si një vendim racional, i motivuar me vullnetin për të ruajtur strukturën e njësisë bujqësore. Një arsye tjetër është se toka shërben si një “sigurim” apo “pension”, që është mirë t’i lihet djalit/vëllait më të vogël, meqë ai do të mbajë pleqtë.

Shumica e grave pjesëmarrëse në diskutimet tematike flasim për ruajtjen e të drejtave zakonore lidhur me trashëgimin e tokës. Duke qenë se dalin nga dera e shtëpisë dhe shpesh largohen edhe nga fshati, pasi martohen, ato thanë se “tokën nuk e merr dot me vete”, ajo i përket familjes/vëllezërve dhe se do të gjenin tokë të shtëpia e burrit.

Gjithashtu, për to, ky veprim është pjesë e një norme të fortë shoqërore, prandaj as u shkonte fare në mend të dilnin kundër saj. Nga ana tjetër, shumë pak gra e vënë në diskutim këtë mënyrë tradicionale apo e mendojnë si të padrejtë ndaj grave, me ca përjashtime.

Situata për të drejtat mbi tokën shfaq disa ndryshime, apo lehtësim në të drejtën zakonore, në lidhje me brezin e ardhshëm të grave, ato bija që janë në moshë të re sot. Nën raportojnë se tani familjet kanë vendosur apo po mendojnë t'u japin vajzave pjesën e tyre të tokës.

Arsyetimi i këtij ndryshimi nuk lidhet automatikisht me respektimin e të drejtave ligjore të tyre, por me përpjekjen për t'i mbështetur ekonomikisht vajzat dhe marrëdhëniet e tyre me burrin.

Në Dibër dhe Reç e drejta zakonore mbetet më e fortë edhe në lidhje me brezin e ri, sepse grave ende nuk u është dhënë e drejta shoqërore t'i gëzojnë të drejtat ligjore mbi tokën, megjithëse ky zakon nuk vlerësohet nga shumë gra.

3.4. KONTRIBUTI NË TË ARDHURAT E FAMILJES

Analizave e diskutimeve në grupe tematike dhe e të dhënave të anketës vërtetojnë se burrat luajnë një rol më të fortë në procesin e vendimmarrjes dhe në kontributin në të ardhurat e shtëpisë. Gjithashtu, burrat priren të mendojnë se kontribuojnë më shumë sesa konsumojnë në familje, në krahasim me gratë.

Analiza e regresionit logjistik tregon se moshja, përkatësia gjinore, numri i viteve të shkollimit dhe statusi si i punësuar në veprimtari jobujqësore e rrit probabilitetin që një anëtar i familjes të kontribuojë në të ardhurat e familjes. Femrat priren më pak të kontribuojnë në krahasim me meshkujt. Një rezultat interesant është se sa më e madhe largësia nga qendrat urbane, aq më të vogla janë mundësitë që gratë të kontribuojnë financiarisht në të ardhurat gjithsej të familjes.

Duket se roli i burrave si ata që nxjerrin bukën e familjes mbetet ende mbizotërues në fshatin shqiptar. Rezultatet e anketës tregojnë se më shumë se një e dyta e burrave thanë se janë kontribuesit kryesorë në të ardhurat e familjes. Gjithashtu, më shumë se 60% e grave thanë se kontribuesi kryesor është burri. Gjithashtu, roli i bijve është shumë më i rëndësishëm në fushën e të ardhurave, në krahasim me rolin e bijave.

Tani do t'u japim tokë edhe vajzave, sepse e duan, ngaqë ua jep ligji. Deri tani e kemi pasur dhe punuar ne, por tani e duan ato, se do të shkojnë te burri, apo jo? (DVORAN, 43 VJEÇE).

Të gjithë do të veprojmë kështu. Është më mirë, se kështu shmangim sherret me dhëndrin. (BRADASHESH, 44 VJEÇE)

Po sikur nesër-pasnesër ta ndajë burri, ku do të shkojë ajo? (BRADASHESH, 48 VJEÇE)

Epo, burrat e mbajnë llogarinë e familjes. Kur i kërkoj para burrit, më duhet t'i lutem 100 herë. Më së shumti, burrat e mbajnë llogarinë e shtëpisë në fshatin tonë.

(BEGJUNEC, 53 VJEÇE)

Ne bashkëpunojmë, por jo për paratë. Ne, gratë, nuk kemi paratë tona. Paret i mban burri, ndërsa neve na duhet t'i kërkojmë. **(FUSHË-DRAÇ, 48 VJEÇE)**

Mos shiko atë ti, vendos vetë ajo, se ka dyqanin, prandaj edhe paret i ka të vetat... Hej, kur nuk ke pare vetë, të duhet të flasësh me burrin e ta bindësh për atë që do të bësh. **(BRADASHESH, 49 VJEÇE)**


Vetëm 7% e grave thonë se kontribuojnë më shumë se një të dytën e parave në familje (tabela 12). Kjo është një përqindje shumë modeste në krahasim me përqindjen e burrave që thonë se kontribuojnë më shumë se një të dytën e parave që shpenzon familja. Pyetjet nuk mund të rrokjin vlerën e perceptuar të veprimtarive të papaguara brenda familjes, por rezultatet e diskutimeve tematike na thonë më shumë. Por puna e papaguar mbetet e padukshme dhe merret si e mirëqenë.

Gjatë diskutimeve në grupe tematike shumë gra thanë se u duhet të pyesin burrat sa herë u duhet të përdorin para, përveç pazarit normal për ushqime. Por edhe këtu u duhet të mos dalin nga lista e artikujve bazë ushqimorë. Prandaj për çdo shpenzim tjetër, përfshirë edhe shpenzimet e vogla personale, u duhet të flasim me burrat.

Vetëm disa gra që kishin vetë ndonjë biznes apo kishin një burim të veçantë të ardhurash (si zotërimi dhe shitja e një dyqani të vogël etj.) konsiderohen se “kanë paret e veta”, dhe kështu janë në gjendje të vendosin si t'i shpenzojnë

Rezultatet e diskutimeve tematike tregojnë se gratë që shesin vetë në treg mund të kenë ndonjë para që mund ta heqin mënjandë dhe ta administrojnë vetë (tabela 13). Duket se, nëse gratë përfshihen në tregtimin e produkteve bujqësore, kjo i rrit mundësitë që ato të administrojnë paratë e familjes. Sipas studimit krahasues, ka një përqindje konsiderueshëm më të ulët nga ana statistikore të grave, në krahasim me burrat, të cilat hyjnë drejtpërdrejt në treg dhe shesin produktet bujqësore. Vetëm 40% e pjesëmarrësve kishin mundësi të shisnin në tregun bujqësor në tre vjetët e fundit. Gratë priren dy herë më pak të shkojnë në treg vetëm (49% e burrave kundrejt 29% e grave). Intervistat sporadike të kryera në tregun bujqësor të Elbasanit, Korçës dhe Lushnjës tregojnë se gratë kryesisht vetëm sa shoqërojnë burrat në treg. E vetmja prani e grave individualisht është kur i shesin qumështin mbledhësit të qumështit.

Tabela 12: Përqindja e kontributit në të ardhurat e familjes



P. 51.B. Sa për qind të parave mendoni se keni kontribuar në familje në vitin 2014



Tabela 13: Pjesëmarrësit që shesin të vetëm në treg, në 3 vjetët e fundit

Përkatësia gjinore	Shesin të vetëm në treg, në vitet e fundit		Gjithsej
	Po	Jo	
Meshkuj	154	161	315
	49	51	100
Femra	75	184	259
	29	71	100
Gjithsej	229	345	574
	40	60	100


BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT KRAHASUES

3.5. MUNDËSIA PËR TË PËRDORUR MAKINERI DHE PAJISJE

Një tjetër ndikim i rëndësishëm i jetës shoqërore-ekonomike në zonat rurale ka lidhje me të drejtat mbi mjete të tilla si pajisjet bujqësore, mjetet e transportit dhe makineritë përpunuese. Shumica e pjesëmarrësve ose i marrin me qira, ose nuk i përdorin fare mjetet e mekanizuara. Analiza e anketës dhe e të dhënave tregon se nuk ka dallime të dukshme gjinore sa u takon perceptimeve për pronësinë mbi pajisjet bujqësore. Shumica e burrave e perceptojnë veten si pronarë të mjeteve (75%); ndërkohë që vetëm një përqindje shumë e vogël e femrave (27%) kanë të njëjtin perceptim. Mungesa e pronësisë individuale, megjithëse është matur si perceptim, është e rëndësishme për të kuptuar dinamikat e pushtetit brenda familjes.

3.6. NDARJE E DETYRIMEVE DHE DETYRAVE DHE DINAMIKAT E PUSHTETIT MES ANËTARËVE TË FAMILJES

Konstatimet nga studimet diagnostikuese dhe krahasuese lidhur me vendimet në familje për çështjet ekonomike tregojnë disa role të veçanta gjinore (figura



E imagjinon dot, edhe për të shkuar te prindërit një natë, na duhet të sakrifikojmë, sepse ka kaq shumë gjëra që bëjmë ne, të cilat burrat nuk i bëjnë. Ia lë të gjitha gati, edhe kur shkoj të qëndroj një natë te prindërit. As lopën nuk duan ta mjelin, sepse nuk duan të vijnë erë më pas. Kanë hall se mos mësohemi keq. Kur kthehem në shtëpi, e gjej rrëmujë. Pra, nëse nuk kujdesen për gjënë e gjallë dhe tokën dhe nuk ndihmojnë në punët e shtëpisë, çfarë mbetet tjetër? (REÇ, 47 VJEÇE)

Meqë im bir dhe e shoqja të dy punojnë, ai e ndihmon. I ndërron pelenat fëmijës. Unë i them: “Edhe këtë e bën?” dhe ai më thotë: “Epo janë ndryshe gjërat këtu.” (BEGJUNEC, 66 VJEÇE)

7). Administrimi i parave duket se është e drejtë e burrave. Vetëm një e treta e pjesëmarrësve thanë se gratë e kanë këtë të drejtë. Duket se burrat shpesh konsiderohen si “administrues të parave”, megjithëse një shikim i mëtejshëm i vendime të veçanta sesi shpenzohen paratë tregon një situatë më të ekuilibruar.

Gjatë diskutimeve tematike gratë thanë se të shumtën e kohës ato kanë përgjegjësinë për punët e shtëpisë, pastrimin, gatimin etj., dhe kujdesin për fëmijët (pastrimin, ushqyerjen, detyrat e shkollës etj.). Gratë rrallë çlirohen nga kjo barrë. Bashkëshortët mund të përfshihen në raste të rralla, si për shembull kur sëmuret bashkëshortja apo në raste të tjera të rralla.

Gjithashtu, edhe detyra të tjera, siç është kujdesi për anëtarët e sëmurë të familjes, kryhen vetëm nga gratë. Sa u takon detyrimeve të tjera të palidhura me kujdesin, si qepja e teshave, ujitja, prashitja, marrja e ujit, pazari, gratë tregojnë se ka njëfarë ndarjeje, ku burrat bëjnë ato punë që janë fizikisht të vështira (si prashitja apo ujitja, që shpesh kryhen gjatë natës), ose që janë kryesisht jashtë shtëpisë, si vajtja në pazar për të shitur produktet bujqësore. Por, në përgjithësi, gratë thonë se punojnë më shumë orë.

Nga ana tjetër, gratë tregojnë disa prirje të reja lidhur me ndarjen e detyrave dhe punëve. Ato çifte që kanë migruar jashtë dhe janë kthyer nga migrimi, ose që janë vendosur nga fshati në qytet, shfaqin një qasje tjetër për ndarjen e punëve brenda familjes. Këto ndryshime shfaqin disa dallime përgjithëse.

Rezultatet e diskutimeve tematike janë të ngjashme me ato që kanë dalë nga Anketa e Përdorimit të Kohës (APK) 2010-2011, të cilat tregojnë se gratë bëjnë 86% të punës së papaguar në Shqipëri dhe janë thuajse plotësisht përgjegjëse për punët e shtëpisë (96%). Gratë në fshat shpenzojnë pesë orë më shumë se burrat, në fshat, për punë të papaguar. Gjithashtu, sipas kësaj ankete, gratë në fshat shpenzojnë më shumë kohë se gratë në qytet për veprimtari shtëpiake të papaguara.

3.6.1. PËRFSHIRJA NË EKONOMINË BUJQËSORE

Bujqësia dhe blegtoria janë veprimtari familjare në Shqipëri. Një anketë që ka bërë GIZ (2015) hetonte punësimin e anëtarëve të familjes në ekonominë bujqësore. Siç pritej, punësimi i anëtarëve të familjes përbën burimin kryesor të punësimit – nga 1,64 njësi pune bujqësore (AWU) (të barabarta me 369 ditë pune) të përdorura në ekonominë bujqësore, 1,58 AWU (355 ditë pune) vijnë nga anëtarët e familjes dhe 0,5 AWU (103 ditë pune) vijnë nga persona që nuk janë anëtarë të familjes, të paguar.

Anketa e Forcës së Punës (AFP) 2012 konstatoi se gratë shqiptare prirën gati dyfish më shumë se burrat të përdoren si punëtorë kontribues në familje - punësim joformal ose vende pune në pozita të pambrojtura. Angazhimi i grave në ekonominë bujqësore është tashmë një prirje mbarëbotërore dhe është quajtur nga OKB (2013) si “feminizimi i bujqësisë”. Studimi krahasues e vërtetoi këtë prirje - gratë angazhohen më shumë në veprimtaritë bujqësore (32% në krahasim me 22% burrat). Përqindja e meshkujve që thonë se punojnë jashtë ekonomisë bujqësore është më e lartë në krahasim me femrat (tabela 14).

Gratë dhe burrat janë njësoj të angazhuar në administrimin e tokës dhe në veprimtaritë e lidhura me bujqësinë. Studimi krahasues tregon se afërsisht 60% e pjesëmarrësve, pavarësisht nga përkatësia gjinore, shfaqin kontribut të barabartë në kryerjen e veprimtarive dhe punëve të lidhura me bujqësinë dhe administrimin e tokës. Por del një mospërputhje kur shihen më hollësisht rolet e grave dhe të burrave. Duket se gratë angazhohen më shumë se burrat në veprimtaritë bujqësore.

3.6.1.1. NDARJA E PUNËVE NË BLEGTORI

Studimi diagnostikues dhe krahasues ka parë ndarjen gjinore të punës në bazë të grupeve të mëdha të veprimtarive të ekonomive bujqësore: bujqësi, blegtori dhe veprimtari të tjera (shih figurën 8). Secila prej veprimtarive është ndarë edhe sipas punëve kryesore, siç janë ato që lidhen me prodhimin, faktorët e prodhimit, përpunimin, shitjen në treg etj. Shifrat tregojnë një angazhim më të madh të grave

Në brezin e ri, burrat kujdesen më shumë për gratë dhe fëmijët ... Tani, dhëndri im e ushqen dhe e vesh të bijën dhe e çon në kopsht. I them vajzës: “Mos u anko, se bën shumë ai, pa mendo pak për nënën tënde të gjerë që punonte deri natën vonë, shkante në punë në mëngjes dhe kur vinte në shtëpi prapë punonte?” Në kohën time, im shoq as donte t’ia dinte fare që punoja edhe në punë të shtetit. Edhe sot e kësaj dite nuk më ndihmon brenda shtëpisë.
(BRADASHESH, 55 VJEÇE)

Tabela 14: Veprimtaria kryesore e angazhimit të anëtarëve të familjes mbi 14 vjeç, sipas përkatësisë gjinore


P. 16. Cila është veprimtaria kryesore në të cilën angazhohen kryesisht anëtarët e familjes mbi 14 vjeç:	Meshkuj		Femra		Gjithsej	
	Frek.	%	Frek.	%	Frek.	%
1. Të punësuar jashtë fermës (privat)	372	25	98	6	470	15
2. Të punësuar në sektorin publik	46	3	34	2	80	3
3. Të vetëpunësuar në fermë	332	22	521	32	853	27
4. Të vetëpunësuar në biznes jashtë fermës	45	3	26	2	71	2
5. Pasiv (nuk janë në kërkim të një pune)	44	3	100	6	144	5
6. Në pension	149	10	198	12	347	11
7. Ushtarak	4	0	1	0	5	0
8. Student/nxënës	186	12	262	16	448	14
8.1. Të papunë (në kërkim të një pune)	125	8	167	10	292	9
Nën 14 vjeç	203	13	197	12	400	13
Gjithsej	1506	100	1604	100	3110	100

BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT KRAHASUES

në shumicën e veprimtarive. Por duket se ato kanë shumë pak mundësi të merren me ato veprimtari që lidhen drejtpërdrejt me pasjen e parave në dorë.

Gratë janë përgjegjëse për shumicën e punëve të lidhura me blegtorinë, si mjelja, përpunimi i qumështit në shtëpi dhe shitja e qumështit të mbledhësit e qumështit; ndërsa burrat janë përgjegjës për kullotjen, ushqimin e kafshëve (kur kërkohet forcë fizike) dhe shitblerjen e gjësë së gjallë ose shitjen e mishit (shpesh mishi u shitet kasapëve ose mbledhësve).

Figura 8: Kontributi në blegtori (diagnostikues)




BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT DIAGNOSTIKUES DHE KRAHASUES

3.6.1.2. NDARJA E PUNËVE NË BUJQËSI

Shumë veprimtari bujqësore, si punimi i tokës, mbjellja, ushqyerja e bimëve, korrja dhe vjelja; dhe punët pas korrjes dhe vjeljes, si shirja, tharja dhe pastrimi bëhen nga gratë. Burrat shpesh blejnë faktorët e prodhimit, kryejnë punët e lidhura me ujitjen,

spërkatin pesticidet, bëjnë transportin në tregje dhe veprimtaritë e shitjes. Burrat janë përgjegjës për marrëveshjet e qirasë së tokës dhe përfshihen disi në vendimmarrjen se cilat kultura bujqësore të kultivohen (shih figurën 9).

Figura 9: Kontributi në bujqësi (diagnostikues)



BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT DIAGNOSTIKUES DHE KRAHASUES

3.6.1.3. BASHKËRENDIMI DHE MARRËDHËNIET ME TREGUN

Shumica e fermave (94,5%) drejtohen nga meshkuj. Duket se përkatësia gjinore e drejtuesit të fermës nuk ka ndikim te ndarja e punëve të lidhura me veprimtaritë e drejtimit të fermës¹⁴. Në anketën tonë më shumë se 50% e pjesëmarrësve e pranojnë faktin se punët e drejtimit të fermës, si vendimi se çfarë kulture bujqësore të mbjellin, merren në mënyrë të barabartë nga burrat dhe gratë.

Vendimmarrja duket se nuk pasqyron një ndarje të barabartë të ngarkesës së punës. Rezultatet e diskutimeve tematike tregojnë se, edhe kur gratë kanë njëfarë peshe në vendimmarrje, kjo jo medoemos e rrit ekuilibrin në ndarjen e detyrave dhe punëve në shtëpi, ku shumicën e ngarkesës së punës e mbajnë gratë. Siç e thotë kjo grua:

Im shoq mund të bjerë në marrëveshje për të marrë me qira tokë shtesë apo për të blerë një lopë tjetër, po kur më duhet mua ta mjel lopën ai nuk më ndihmon fare dhe unë i them vetes “ç’i bëra vetes”.
(REÇ, 52 VJEÇE)


3.6.2. PËRFSHIRJA NË VEPRIMTARI JOBUJQËSORE

Gjatë 20 vjetëve tranzicion nga ekonomia komuniste në ekonominë e tregut mjedisi tregtar ka qenë shumë i vështirë për bujqit dhe sidomos për ato femra. Qëndrimet ndaj grave thuhet se janë më pak egalitare se në qytet dhe nocionet tradicionale për rolet gjinore mund të veprojnë si barriera që i pengojnë gratë të jenë afariste (Tigess dhe Green, 1994). Por një vëmendje e shtuar kohët e fundit nga ana e qeverisë është përpjekur ta ndryshojë angazhimin jashtë fermës në fshat¹⁵.

14 Lastarria-Cornheil dhe Wheeler (2003) konstatuan se vetëm në 45% të familjeve me kryefamiljar mashkull dhe me fermë, kjo fermë administrohej nga kryefamiljari. Pushteti i vendimmarrjes brenda ekonomisë bujqësore nuk ushtrohet në bazë të hierarkisë së roleve, por në bazë të legjitimitetit që mbështetet te njohuria për prodhimin dhe te përvoja. Nëse përvoja është e dobët, atëherë, sipas Barrel Nichols (2008), kjo e delegjtiton rolin vendimmarrës të dikujt. Gjatë periudhës së ekonomisë së centralizuar ka pasur më shumë meshkuj si brigadierë në krahasim me femrat. Prandaj njohuritë e lidhura me bujqësinë dhe administrimin e fermave mund të jenë më të forta te burrat sesa te gratë.

15 Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Dhunën me bazë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2010-2015 ishte një hap serioz i Qeverisë Shqiptare në angazhimin e saj ndaj barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave. Strategjia hedh bazat për masa të mëtejshme për ta përhapur mbështetjen e qeverisë për fuqizimin ekonomik të grave, sidomos në fushat e punësimit të grave, shprehive dhe sipërmarrjes së grave. Në fushën e parimeve të politikave tregtare dhe industriale në vend është hartuar Strategjia për politikat industriale dhe ndërmarrjet, për zhvillimin e biznesit dhe investimet për periudhën 2014-2020, si edhe një plan veprimi për sipërmarrjen e grave të cilat janë në proces miratimi. Plani i veprimit ka një shtyllë më vete për gratë sipërmarrëse në zonat rurale. Në bazë të këtij dokumenti

Tabela 15: Përqindja e bizneseve të drejtuara nga gra, në raport me numrin e bizneseve gjithsej, sipas qarqeve



Megjithatë, të dhënat nga Regjistri Tregtar ofrojnë më shumë dëshmi se Shqipëria ka një situatë të vështirë shoqërore-ekonomike për gratë afariste (tabela 15). Vetëm 22,4% e bizneseve të regjistruara ndodhen në zonat rurale. Bizneset e drejtuara nga gra përbëjnë vetëm 28% të numrit të bizneseve gjithsej dhe ndodhen më së shumti (87%) në zonat urbane dhe janë të përqendruara në Tiranë (47,5%). Këto të dhëna tregojnë një diversifikim të paktë ekonomik në fshat.

NVM-të në pronësi të grave afariste ushtrojnë veprimtari në sektorë tejet joformalë, si tregtia me pakicë, hoteleria dhe restorantet, si edhe në sektorët e shërbimeve të tjera që ndodhen kryesisht në qytet. Afërsisht 95% e ndërmarrjeve të administruara nga gra kanë më pak se 5 punonjës. Gjithashtu, mjedisi tregtar rural ofron më pak mundësi për gratë.

Studimi diagnostikues dhe ai krahasues tregon se një përqindje e vogël e pjesëmarrësve (më pak se 20%) deklarojnë vetëpunësim jobujqësor si burim të ardhurash të familjes. Por ka një përqindje më të vogël grash të vetëpunësuar në veprimtari jobujqësore në krahasim me burrat. Rezultatet e studimit krahasues tregojnë se ka pengesa të ndryshme për gratë dhe burrat në fshat, që këta të ngrenë një veprimtari jobujqësore. Mbështetja e dobët financiare, mungesa e njohurive për biznese të reja me leverdi dhe mungesa e krahut të punës janë faktorët më të rëndësishëm të përmendur nga pjesëmarrësit (tabela 16). Gjithashtu, një përqindje e vogël e grave pjesëmarrëse në studim kanë përmendur edhe mungesën e kohës, si pengesë për t'u marrë me veprimtari të tilla.

Të dhënat tregojnë se shërbimet përbëjnë sektorin më të suksesshëm për gratë sipërmarrëse. Të dhënat nga agjencitë shtetërore dhe donatore të angazhuara në mbështetjen e sipërmarrjes së grave tregojnë se veprimtaritë e vogla në turizëm, tregti dhe artefakte paraqesin pengesa më të vogla të hyrjes në treg për gratë (UNDP, 2013).

strategji, MZHETS ka hapur edhe një Fond për Gratë Sipërmarrëse, që jep grante për investime. Këto fonde, si edhe fonde të tjera (IPARD, Skema Kombëtare, SARED etj.), janë të arritshme dhe madje ofrojnë lehtësi për gratë.

Tabela 16: Arsye për moskryerjen e veprimtarive tregtare jobujqësore

P. 16. B. Arsyet për moskryerjen e veprimtarive tregtare jobujqësore?	M		F	
	Frek.	%	Frek.	%
1. Nuk ka mbështetje financiare për këtë	236	75	188	61
2. Nuk ka kush të japë këshilla	1	0	2	1
3. Nuk ka ide se cili biznes është me fitim	21	7	17	6
4. Ka nevojë për kredi	5	2	0	0
5. Ka nevojë për ndihmë nga anëtarët e familjes	4	1	2	1
6. Shumë të zënë me kujdesin për familjen	1	0	9	3
7. Tjetër	4	1	1	0
8. Nuk ka njohuri biznesi	5	2	3	1
9. Nuk ka krahë pune	16	5	11	4
Pa përgjigje	22	7	76	25
Gjithsej krahasues	315	100	309	100


BURIMI: STUDIMI KRAHASUES

3.6.3. TREGU I PUNËS

Tregu shqiptar i punës ende paraqet probleme strukturore në sektorët parësorë dhe dytësorë të prodhimit¹⁶. Gjatë viteve të fundit shkallët e punësimit të burrave kanë mbetur të pandryshuara (në 61%); ndërsa shkalla e punësimit të grave është luhatur në një nivel më të ulët (rreth 45%). Papunësia e grave më 2015 qe më e

16 Pavarësisht nga progresi i arritur për fuqizimin e politikave të tregut të punës. Në nëntor 2014 është miratuar Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020. Në qershor qeveria miratoi planin kombëtar të veprimit për rininë 2015-2020. Kapaciteti administrim për vendosje nëpër vende pune është rritur me krijimin e pesë zyrave të reja model të punësimit. Lipset të bëhet më shumë për përmirësimin e funksionimit të shërbimit kombëtar të punësimit, fuqizimin e programeve të promovimit, modernizimin e shërbimeve të formimit dhe për zhvillimin e një sistemi koherent informacioni për tregun e punës (KE, 2014).

Figura 10: Shkalla e pjesëmarrjes në krahun e punës, zona urbane-zona rurale



BURIMI: INSTAT, 2007-2012 AFP (UNDP, 2013)

lartë se ajo e burrave, në 17,7% (INSTAT, 2015)¹⁷. Më shumë se 50% e të papunëve gjithsej janë të papunë afatgjatë.

Të dhënat nga INSTAT nxjerrin në pah disa fakte të rëndësishme për tregun rural

17 Shkalla e përgjithshme e punësimit, sipas çmuarjeve të Anketës së Forcës së Punës (2015), ka rënë nga 18% në tremujorin e katër të vitit 2014 në 17,5% në tremujorin e tretë të vitit 2015.

Pavarësisht nga puna, asnjëherë nuk ka rrogë të mirë. Kam tre muaj që punoj në një firmë përpunimi produktesh bujqësore. Më paguajnë 750 lekë për tetë orë punë, që i bie më pak se 100 lekë ora, dhe as kokën nuk e lëviz dot tetë orë rresht. Sigurisht që është pa sigurime. Po s'deshe, shko në shtëpi, më thonë. (REÇ, 47 VJEÇE)

të punës. Pjesëmarrja e krahut të punës në zonat rurale ka rënë më 2007 dhe 2008 dhe ka marrë forcë pas vitit 2010, kur pjesëmarrja e krahut të punës u rrit në 68%. Por gratë kanë nivele shumë më të ulëta të pjesëmarrjes në krahun e punës (figura 10). Në vitin 2012 pjesëmarrja e krahut të punës për gratë është 62,2% në krahasim me 73,4% për burrat¹⁸.

Pasiviteti te gratë duket se është në korrelacion me martesën. Disa të dhëna (AMNJ 2012) tregojnë se, më shumë se një e dyta e grave që thonë se nuk janë në kërkim të një pune, rolin e tyre si shtëpiake e konsiderojnë si pengesën më të rëndësishme ndaj të pasurit të një pune. Shkallët e ulëta të pjesëmarrjes në krahun e punës, si edhe shkallët e larta të pasivitetit, përbëjnë një tjetër shqetësim, duke qenë se, sa më gjatë të qëndrojnë gratë jashtë tregut të punës, aq më shumë rrezikohen nga humbja e kapitalit të tyre njerëzor.

Ka dallime të konsiderueshme ndërmjet burrave dhe grave që kanë punë jashtë fermës. Burrat më shpesh punësohen si juristë, merren me tregti, punojnë makineri dhe pajisje, të cilat janë vende pune me paga më të larta. Ndërsa gratë, krahas punëve në bujqësi, punësohen në vende pune me pagë të ulët, si nëpunëse dhe punonjëse administrative.

Diskutimet në grupe e mbështesin informacionin e paraqitur më lart në këtë rubrikë. Pjesëmarrësit tregojnë një nivel shumë të lartë pakënaqësie lidhur me situatën ekzistuese të punësimit të grave në fshatrat e tyre. Shumë pak prej tyre punojnë jashtë shtëpisë, në punë të tilla si infermiere, mësuese dhe poste administrative me kualifikime të ulëta. Mundësitë për të gjetur një punë me rrogë janë shumë të kufizuara, afatshkurtra, shpesh joformale dhe zakonisht me pagë të ulët. Siç tha njëra prej tyre:

Megjithatë, çudi ose jo, të pasurit e një vendi pune të rregullt është në majë të listës së “dëshirave” të tyre. Thuajse të gjitha gratë që morën pjesë në grupet e

18 Edhe anketa AMNJ 2012 mbështet disa prirje të gjetura në AFP 2012. AMNJ 2012 tregon se gratë kanë më pak mundësi për të gjetur punë me pagë nga të tjerë, në krahasim me meshkujt që jetojnë fshat. Gjithashtu, ka një përqindje më të vogël grash që kërkojnë punë në zonat rurale, në krahasim me burrat.

diskutimeve tematike do të ishin shumë të gatshme të gjenin një punë me rrogë mujore rreth 15 000 - 30 000 lekë, por që u paguan edhe sigurimet shoqërore. Sipas tyre, të ardhurat e rregullta do të ofronin njëfarë qëndrueshmërie financiare dhe autonomie për to, si edhe siguri për vitet e pensionit. Njëra prej pjesëmarrëseve tha **(1)**.

Ato shfaqin shqetësime të forta lidhur me punësimin e fëmijëve të tyre. Të kërkosh punë në qytetet e mëdha ose të migrosh duken se janë të vetmet mënyra për të gjetur punë. Një nënë thotë **(2)**.

3.7. PENGESAT E GRAVE NË FSHAT PËR NDJEKJEN E MUNDËSIVE EKONOMIKE

Në këtë rubrikë përshkruhen kufizimet kryesore me të cilat përballen gratë, në krahasim me burrat, në fshat, sa i takon mundësisë për të marrë arsim dhe formim, shërbim shëndetësor, skema të mbështetjes financiare, shërbime sociale, pjesëmarrje në komunitet, TIK, informim, lidhje në rrjet dhe vendimmarrje, që do t'u jepnin mundësi të ndiqnin mundësitë ekonomike.

3.7.1. ARSIMI

3.7.1.1. MUNDËSIA PËR ARSIM PARASHKOLLOR

Një prej shërbimeve më të rëndësishme për vajzat, dhe për fëmijët në përgjithësi, është arsimi parashkollor. Arsimimi në fëmijërinë e hershme jo vetëm që ndikon në arsimin e fëmijëve, por rrit edhe pjesëmarrjen e grave në krahun e punës. Shifrat e AMNJ 2012 tregojnë se frekuentimi i arsimit parashkollor nga fëmijët është më i ulët në fshat (figura 11).


Numri i fëmijëve, që jetojnë në fshat, të regjistruar në kopshte private është sa një e dyta e atyre në qytet. Mungesa e ofruesve të shërbimit, mungesa e transportit, prania e të moshuarve në familje dhe varfëria bëjnë që ky shërbim në përgjithësi të mos pranohet nga njerëzit në fshat.

(1) *Për 30 000 lekë, e lë punën në fermë, i lë të gjitha. Mund të punoj çdo ditë, me përjashtim të së dielës, por dua të më paguhen edhe sigurimet.* (DVORAN, 35 VJEÇE)

(2) *Njëra prej vajzave të mia sapo ka mbaruar një program pasuniversitar në Tiranë dhe është pa punë. Tjetra ka mbaruar për fizikë, ndërsa e treta për infermieri ... dhe janë edhe ato pa punë.* (BEGJUNEC, 54 VJEÇE)

Të rinjtë shkojnë në shkollë, por pastaj nuk ka punë për ta. Kështu, detyrohen të migrojnë, ose vajzat martohen jashtë vendit. (FUSHË-DRAÇ, 42 VJEÇE)

Figura 11: Frekuentimi i arsimit parashkollor, sipas përkatësisë gjinore (kryefamiljar)




BURIMI: AMNJ, 2012

As kopsht nuk e quan dot. Është ngrehinë për kafshë, jo për fëmijë.
(FUSHË-DRAÇ, 45 VJEÇE)

Arsyeja kryesore e mosfrekuentimit të arsimit parashkollor ka të bëjë me largësinë dhe mungesën e këtyre shërbimeve në fshat. Gjithashtu, siç thanë shpesh gratë pjesëmarrëse në grupet e diskutimeve tematike, infrastruktura e kopshteve nëpër fshatra është e dobët. Prandaj, më shumë se 20% e pjesëmarrësve në fshat thonë se preferojnë t'i mbajnë në shtëpi fëmijët. Siç e tha një nënë:

Figura 12. Popullsia 10 vjeç e lart, e zbërthyer sipas vendbanimit (qytet dhe fshat), përkatësisë gjinore dhe numrit të viteve të arsimit të kryer




BURIMI: CENSUSI I POPULLSISË DHE BANESAVE, 2011

3.7.1.2. MUNDËSIA PËR TË MARRË ARSIM FILLOR DHE NËNTËVJEÇAR

Sipas Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011, shkalla e regjistrimit të vajzave në arsimin e lartë është më e ulët në fshat se në qytet. Këto të dhëna tregojnë se përqindja e femrave që marrin arsim është e barabartë ose më e lartë se meshkujt deri në arsimin fillor, por pastaj bie në arsimin e mesëm. Në fshat ka konsiderueshëm më shumë meshkuj se femra, të cilët e përfundojnë arsimin e mesëm ose atë të lartë (shih figurën 12).

Tabela 17: Niveli i arsimit të pjesëmarrësve në anketë, sipas përkatësisë gjinore



Këto të dhëna vërtetohen nga raportet e Ministrisë së Arsimit. Shkalla e kalimit nga arsimi i detyrueshëm në atë të mesëm është më e ulët për femrat se për meshkujt (MASH, 2013). Përqindja e popullsisë me arsim të mesëm për vajzat në fshat është më e ulët se për djemtë; më pak se një e katërta e grave në fshat (23%) kanë kryer arsimin e mesëm, kundrejt më shumë se një e dyta syresh në qytet (56%). Martesat në moshë të hershme, braktisja e shkollës për shkak të vendndodhjes së papërshtatshme të shkollave (shumë larg nga banesa) dhe shkalla e lartë e migrimit në qytet mund ta kenë rritur këtë diferencë (UN Women, 2014). Infrastruktura shkollore dhe rrjeti rrugor i dobët, mungesa e transportit, si edhe rritja e kostove oportune, janë disa prej kufizimeve madhore që pengojnë përfundimin e shkollës së mesme.

Të dy studimet (krahasues dhe diagnostikues) tregojnë që më shumë se një e dyta e pjesëmarrësve kishin të paktën 8 vjet shkollë dhe afërsisht një e treta e numrit gjithsej të pjesëmarrësve kanë kryer arsimin e mesëm (tabela 17). Studimi krahasues tregon, gjithashtu, një përqindje më të lartë të femrave që kanë përfunduar arsimin fillor. Në nivel universiteti, ka një prani disi më të lartë të femrave, në krahasim me meshkujt.

3.7.1.3. ARSIMI PROFESIONAL - ENDE NJË ZGJEDHJE E DYTË

Në Shqipëri arsimi dhe formimi profesional (AFP) ofrohet në 53 shkolla (44 publike, përfshirë edhe degët në shkollat e mesme të përgjithshme, dhe 9 private), të cilat thuajse të gjitha ndodhen në zona urbane.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 e vë në dukje qartë faktin se arsimi profesional ende shpërfillet nga shumë nxënës. Shkollat profesionale zakonisht regjistrojnë nxënës me notë mesatare shumë të ulët (nga arsimi fillor) ose ata që ngelin në vitin e parë të gjimnazit. Kjo situatë ndikon, për pasojë, në arritjet e ulëta akademike të nxënësve, motivim të ulët të tyre, paaftësi për të përvetësuar materialet mësimore dhe ngelje në shkollë ose braktisje të saj.

Ta bësh arsimin profesional tërheqës për nxënësit me rezultate të larta

konsiderohet nga shumë aktorë si një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballet sistemi (Gerdoci, 2015). Problemet kryesore të identifikuara sipas një studimi të kohëve të fundit (po aty) janë: 1) bashkëpunim i pamjaftueshëm me institucionet AFP dhe mungesë ndërgjegjësimi e bizneseve, 2) njohuri dhe formim i pamjaftueshëm i mësuesve, 3) nxënës me rezultate të dobëta dhe shprehi e njohuri të pamjaftueshme, 4) cilësi e pamjaftueshme e infrastrukturës.

Numri i vajzave që frekuentojnë arsimin profesional ka rënë në vitet e fundit (afërsisht një e treta e regjistrimeve gjithsej). Të dhënat e siguruara gjatë intervistave me Luljeta Dautin (MMSR) tregojnë se gjatë vitit akademik 2015-2016 afërsisht 15% e nxënësve (17 300 nxënës) që frekuentonin shkollat profesionale qenë femra. Në vend që të jetë një “urë” drejt tregut të punës, ky arsim shërben si rrugë drejt arsimit të lartë. Më shumë se 79% e vajzave që përfundojnë arsimin profesional hyjnë në universitet, në krahasim me 39,2% të djemve, të cilët në përgjithësi, pas diplomimit, synojnë të gjejnë një vend pune. Gjithashtu, sistemi AFP orvatet të ketë veçim sipas përkatësisë gjinore, ku vajzat kryesisht regjistrohen në turizëm, administrim, parukeri dhe rrobaqepësi.

Edhe në shkollat profesionale bujqësore shihet e njëjta dukuri. Përjashtim përbëjnë shkollat e Tiranës dhe Shkodrës.

3.7.1.4. MUNDËSIA PËR TË MARRË FORMIM PROFESIONAL

Edhe formimi bën pjesë në mundësitë që kanë gratë në fshat për të fituar shprehi të rëndësishme. Intervistat me Luljeta Dautin (MMSR) tregojnë se gjatë vitit 2015 më pak se një e dyta (47% e 17 000) e pjesëmarrësve në trajnime, në qendrat rajonale publike të formimit profesional, qenë gra.

Mungesa e lëvizshmërisë së grave e bën të nevojshëm përdorimin intensiv të qendrave të lëvizshme të formimit. Intervista me Arben Sinojmerin, drejtor i Drejtorisë Rajonale të Lëvizshme të Tiranës (MMSR), tregon një numër në rritje të regjistrimeve pranë qendrës së lëvizshme të formimit. Gjatë vitit 2015 më shumë se një e dyta e pjesëmarrësve qenë gra.

Të dhënat tregojnë se ka një dallim midis grave nga zonat e largëta veriore dhe grave nga zonat fushore jugore: Grupi i parë kërkon veprimtari të cilat mund të kryhen brenda shtëpisë, si rrobaqepësi dhe qëndistari; ndërsa grupi i dytë është më i orientuar nga veprimtaritë e bazuara në shërbime, si hoteleri dhe restorante.

Gjetjet e studimit krahasues janë të ngjashme. Meshkujt kanë më shumë përvojë në trajnime ose takime në grupe, në krahasim me femrat. Kjo është e ngjashme me anketa dhe studime të tjera (BarretNichols, 2009; FAO, 2015). ku tregohet një pjesëmarrje shumë e ulët e grave nëpër trajnime.

Arsyet më të rëndësishme përse gratë nuk marrin pjesë në veprimtari të tilla kanë të bëjnë me mungesën e informacionit. Kanalet e informimit, për t'i ftuar njerëzit në trajnim, mbizotërohen nga meshkujt (FAO, 2015). Siç vëzhgon FAO (2015), ata që i organizojnë takimet janë meshkuj. Gratë, në dallim nga burrat, tregojnë mungesë dëshire për të marrë pjesë edhe për shkak të kufizimeve kohore me të cilat përballen.

Gjetjet nga diskutimet tematike në grupe tregojnë se shumica e grave kanë arsim fillor dhe/ose të mesëm, të cilin e kanë ndjekur përpara vitit 1990 në të ashtuquajturin “sistem të shkollës së natës”. Pas kësaj, shumica e tyre kanë punuar në ferma shtetërore dhe tani punojnë në fermat e tyre. Sipas tyre, më pas nuk u është dhënë mundësia të frekuentojnë ndonjë kurs profesional nëpër fshatrat ku jetojnë, megjithëse ndonjëherë janë përpjekur të mësojnë në mënyrë joformale ndonjë shprehje të re, sa dhe si u është dhënë mundësia. Siç tha njëra prej tyre **(1)**.

Në lidhje me brezin e ri të grave, situata duket ndryshe, sepse prindërit bëjnë çmos t'i investojnë të gjitha kursimet për arsimin e fëmijëve. Sipas tyre, arsim i mirë është arsimi i lartë. Shumë pak prej tyre e përmendën përparësinë e shkollave profesionale.

Një tjetër çështje e rëndësishme lidhur me arsimin dhe formimin profesional është cilësia e arsimit. Llojet e programeve që ofrohen janë të pakta në larmi dhe u drejtohen kategorive me paga të ulëta (MMSR, 2014). Sipas Bukurie Imerit, drejtoreshë ekzekutive, Gruaja drejt Integrit, Pukë, ka shumë pak diversifikim të kurseve të formimit: “Kurset kryesore të formimit ku marrin pjesë gratë janë

(1) *Një grua mësoi si të bëjë komposto, sepse punonte në një dyqan, dhe pastaj na e mësoi edhe neve.* (BEGJUNEC, 43 VJEÇE)

Po u dhe arsim fëmijëve, nuk ke më nevojë për asgjë tjetër në jetë. (BEGJUNEC, 55 VJEÇE)

rrobaqepësia dhe zejtaria. Ato kanë nevojë për formim edhe në bujqësi dhe përpunim të bimëve mjekësore dhe aromatike, i cili shumë pak ofrohet.”

Puna nga afër dhe formimi i përshtatur sipas nevojave në disa raste janë shumë të suksesshme. Një shembull i mirë, sipas Bukurie Imerit, është fillimi i biznesit të prodhimit të jufkave. Në të janë punësuar, trajnuar dhe specializuar për çdo proces të prodhimit 15 gra. Një tjetër shembull i mirë i grupeve në mbështetje të grave u shpjegua edhe nga Sabah Djaloshi (pronar dhe administrator i firmës AgroPuka), i cili me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm krijoi tetë grupe me prodhuese gra, duke i mbështetur me formim, patronazh profesional dhe mundësi hyrjeje në treg për prodhimet e tyre. Siç e theksoi edhe Majlinda Hoxha (AgritraVision): “Arsimi ose formimi i grave duhet të jetë shumë specifik dhe të ketë lidhje me veprimtaritë me të cilat merren ato.”

Vajza e madhe e ndihmoi më të voglën me para. Gjithashtu i kemi ulur shpenzimet për konsum dhe kemi sakrifikuar, për të kursyer për fëmijën. Unë jam më keq nga gjithë të tjerët këtu, sepse jam përpjekur t’u jap shkollë fëmijëve të mi.
(BEGJUNEC, 52 VJEÇE)

Ikëm ne, jemi në moshë të thyer dhe koha jona mbaroi, por për të rinjtë na këputet shpirti, nuk kemi me çfarë t’i çojmë në universitet. (REÇ, 50 VJEÇE)

3.7.1.5. ARSIMI UNIVERSITAR

Ndjekja e arsimit universitar po bëhet më e vështirë. Të dhënat nga Instituti i Statistikave, konkretisht Anketa e Buxhetit të Familjes (ABF) e vitit 2014, tregojnë se shpenzimet e familjeve shqiptare për arsim janë rreth 4,2% e shpenzimeve të konsumit gjithsej, një shifër shumë më e lartë se 1,7% që është regjistruar në vitin 2007. Një e dyta e këtij shpenzimi shkon për programe Master. Njëra prej arsyeve për rritjen e shpenzimeve ka të bëjë me forcimin e institucioneve private dhe të kushtueshme të arsimit të lartë, si dhe një rritje e lehtë e tarifave të regjistrimit në universitetet publike. Siç kanë thënë vetë:


3.7.2. GJATË VITEVE TË FUNDIT KA PASUR NJË RËNIE TË RAPORTIT TË REGJISTRIMIT BRUTO NË ARSIMIN TERCIAR, SIPAS INDEKSIT TË PARITETIT GJINOR, NGA 1,35 MË 1996-2000 NË 1,30 MË 2005-2010 (NJË VLERË MË E LARTË SE 1 TREGON MOSPARITET NË FAVOR TË FEMRAVE), ÇKA TREGON NJË RRIJJE TË HENDEKUT GJINOR. SITUATA NË SHËNDETËSI.

Edhe shëndetësia është një përbërës shumë i rëndësishëm i kapitalit njerëzor.

Të dhënat e AMNJ-së (2012) tregojnë se, si në fshat, ashtu edhe në qytet, ka më pak femra në krahasim me meshkujt të cilët shprehin një perceptim pozitiv për gjendjen e tyre shëndetësore (figura 13). Gjithashtu, ka informacion që dëshmon për më shumë sëmundje kronike në fshat.

Shërbimet e dobëta shëndetësore për gratë në fshat mund të kenë kontribuar në një rritje të shkallës së aborteve në zonat rurale. Por të dhënat tregojnë se numri i aborteve në fshat është shumë më i ulët se në qytet (60% e aborteve bëhen në

Figura 13: Vuajtja nga sëmundjet kronike, sipas përkatësisë gjinore dhe zonës (individë)



BURIMI: AMNJ, 2012

zonat urbane). Mund të thuhet se mund të jetë i vështirë evidentimi i aborteve në fshatra, për shkak të faktorëve kulturorë dhe faktorëve të tjerë.

3.7.3. SKEMAT FINANCIARE DHE JOFINANCIARE TË MBËSHTETJES

3.7.3.1. MUNDËSIA PËR TË MARRË KREDI

Një prej faktorëve kryesorë që ndikon në sipërmarrje është mundësia për të gjetur financim. Megjithëse ka 16 banka që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri, ato thuajse nuk janë të pranishme në zonat e thella rurale. Institucionet e tjera jo bankare (127 institucione) janë të përhapura në zonat rurale, të specializuara zakonisht në mikrokredi. Kredia në këto institucione është e shtrenjtë. Në këto kushte, fshatarët nuk priren t'i përdorin këto shërbime.

Gratë, në përgjithësi, dhe ato që jetojnë në fshat, në veçanti, kanë më pak mundësi për të marrë shërbime financiare. Gjatë vitit 2011 livrimi i kredisë për gratë afariste arriti 25% e të gjitha kredive (MZHETS). Numri i grave që marrin kredi si individë është sa një e dyta e numrit të burrave (Banka e Shqipërisë, 2012). Një studim i ekspertëve të Bankës Botërore, Behr dhe Madestam (2016), i mbështetur në një analizë të 7 300 individëve që kanë marrë kredi nga institucione të mikrofinancimit, tregon se ka një trajtim me parapëlqim gjinor në sektorin bankar, për shkak të mungesës së përvojës dhe konkurrencës së dobët në treg.

Perceptimi gjithsej është që gratë përballen me pengesa të ngjashme në krahasim me burrat, sa i takon arritjes së produkteve financiare, e megjithatë është mundësia e marrjes së informacionit dhe mundësive për financim ajo që është më e vështirë për gratë. Në anketën tonë (si në studimin diagnostikues, ashtu edhe në atë krahasues) afërisht 13% e pjesëmarrësve kanë kërkuar kredi. Shkalla e pjesëmarrësve që kanë kërkuar kredi në tre vitet e fundit është shumë më e lartë te meshkujt në krahasim me femrat dhe e konsiderueshme nga ana statistikore (tabela 18).

Tabela 18: Kërkesat për kredi në 5 vjetët e fundit

P. 36. A keni bërë personalisht kërkesë për kredi në 5 vjetët e fundit?	M		F	
	Frek	%	Frek	%
1. Po	49	16%	33	11%
2. Jo	266	84%	276	89%
Gjithsej	315	100%	309	100%

BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT KRAHASUES

Pyetjes lidhur me arsyet e moskërkimit të një kredie pjesëmarrësit iu përgjigjën me probabilitetin e ulët të shlyerjes së kredisë, ndërsa një pjesë tjetër e pjesëmarrësve (afërsisht një e pesta) thanë se nuk kishin nevojë për kredi. Gratë duken se janë më pak të informuara se burrat në lidhje me mundësitë dhe procedurat për të marrë kredi.

Sipas diskutimeve tematike në grupe, gratë nuk kanë mundësi për të marrë drejtpërdrejt kapital financiar, sepse janë burrat ata që administrojnë paratë e familjes, siç është thënë më lart. Zakonisht, familja ka një llogari bankare, vetëm në emrin e bashkëshortit. Duke qenë se në shumë raste toka është e regjistruar vetëm në emrin e bashkëshortit dhe ndonjëherë në emrin e babait ose të vjehrrit, nuk është e mundshme që gratë të kërkojnë kredi.

3.7.3.2. MUNDËSIA PËR TË MARRË SIGURIM BIZNESI

Shumë pak prej pjesëmarrësve pranuan se kanë blerë produkte sigurimi. Skemat e sigurimit nuk para përdoren në fshat. Megjithëse kostot e tronditjeve të jashtme janë të larta për bujqësinë, ka shumë pak ndërgjegjësim të subjekteve bujqësore për përdorimin e këtyre produkteve. Gjithashtu, duke qenë se një pjesë e madhe e

kampionit të studimit vjen nga veprimtaria e bujqësisë për nevoja vetjake, blerja e këtyre produkteve nuk perceptohet si domosdoshmëri.

3.7.3.3. MUNDËSIA PËR TË MARRË GRANTE


Ka një përfshirje të pakët dhe të pamjaftueshme të grave në mbështetjen financiare shtetërore ose donatore nëpërmjet skemave të granteve. Niveli i ulët i përfshirjes së përfitueseve femra në Fondin Shqiptar të Konkurrueshmërisë, Skemën Kombëtare të Mbështetjes për Bujqësinë, skemën “Like” të IPARD-it dhe skema të tjera të ngjashme është dëshmi e mëtejshme e faktit se programet ekzistuese nuk janë angazhuar sa duhet për t’i fuqizuar dhe mbështetur gratë (shih tabelën 19).

Mungesa e rrjeteve, e lobimit dhe punës mbrojtëse duket se e zvogëlon mundësinë e grave për të marrë mbështetje financiare. Në studimin diagnostikues dhe krahasues rreth 7% e pjesëmarrësve thanë se kanë bërë kërkesë për të marrë grant shtetëror për bujqësinë në 5 vjetët e fundit. Ndryshimi mes grave dhe burrave është i dukshëm. Vetëm 3% e grave në studimin krahasues duket se kanë kërkuar grante. Përqindja e burrave është shumë më e lartë, në rreth 10%.

Gjithashtu, numri i atyre që u është dhënë granti është modest. Vetëm 3 gra dhe 8 burra thanë se u është dhënë njëfarë mbështetjeje nëpërmjet skemave të granteve. Vetëm pak gra kanë informacion të mjaftueshëm për procedurat e subvencioneve. Burrat përfshihen më shumë në procedura dhe udhëheqin përgatitjen e kërkesës. Një studim i FAO-s (2015) dokumenton përdorimin e kanaleve të informimit ku mbizotërojnë meshkujt, çka de fakto e ul mundësinë e grave për të marrë informacion. Gratë shihen si “grua fermeri” dhe jo si fermer në vetvete (FAO, 2015).


Këto fakte janë të rëndësishme për vendimmarrësit e politikave dhe organizatat rurale në Shqipëri. Siç tha edhe Lindita Manga (drejtoreshë, ALCDF): “duhet të ketë më shumë përpjekje nga politikat për ta orientuar financimin drejt grave, nëpërmjet monitorimit të mbështetur në tregues gjinorë të skemave të financimit.”

Tabela 19: Mundësia që u jepet grave për të përfituar nga skemat e financimit







Skema kombëtare e mbështetjes

IPARD Like



Fondi i Konkurrueshmërisë



 Total Gra

Asnjë agronom nuk na ka këshilluar sesi të kujdesemi për duhanin. Jemi bërë vetë agronomë. (REÇ, 51 VJEÇE)

Ndonjëherë marr vesh më shumë se agronomi se çfarë të përdor. Kam një libër në shtëpi, i shoh aty. Një herë shkova ta pyesja agronomin për ca pesticide dhe ai më tha: Nuk e di. Unë i thashë: Si nuk e ditke? Je ti agronomi. Nuk janë më të përgjegjshëm sot. (DVORAN, 45 VJEÇE)

Zyrtarisht, e kemi një agronom. Merr rrogë nga drejtoria bujqësore, por nuk e shohim asnjëherë. (BEGJUNEC, 49 VJEÇE)

3.7.3.4. MUNDËSIA PËR TË MARRË SHËRBIME KËSHILLIMORE

Një tjetër faktor pabarazie është mundësia jo e barabartë e grave, krahasuar me burrat fermerë, për të marrë shërbime këshillimore në bujqësi. Gjatë vitit 2015 MBZHRAU ka arritur progres duke futur në përdorim tregues të posaçëm për gratë, një buxhet të posaçëm trajnimi dhe një qasje të përfshirjes së grave brenda Programit të Zhvillimit Rural (intervistë me Adela Baboçin).

Studime të mëparshme të realizuara nga UN Women (2013) tregojnë se grave në fshat, sidomos atyre që kanë lindur në tri dekadat e fundit, nuk u jepet mundësia për të marrë shërbime këshillimore në bujqësi. Sipas kësaj ankete, vetëm një e treta e pjesëmarrësve kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me një agronom gjatë tre vjetëve të fundit.

Diskutimet në grupe tematike tregojnë një nivel të lartë pakënaqësie të grave me cilësinë e shërbimeve publike të këshillimit bujqësor. Në disa fshatra nuk kanë asnjë informacion për shërbimin këshillimor përgjegjës në zonë, ndërsa në të tjera thonë se personi ose nuk gjendet, ose nuk i kontakton aktivisht.

Siç e kanë treguar tashmë studime të tjera (DSA, 2009; DSA, 2011), dhe siç vërtetohet edhe nga anketa jonë, ka dëshmi kontaktesh të shpeshta me veterinerin, krahasuar me agronomët në zonat rurale.


Por analizat e diskutimeve në grupe tematike tregojnë se shërbimet veterinarë nuk janë shumë të efektshme. Zakonisht, personeli veterinar i kontakton fermerët për të verifikuar vaksinimin e gjësë së gjallë. Përndryshe, thonë se kanë paguar nga xhepi për shërbime të tjera nga vaksinimi.

3.7.3.5. MUNDËSIA PËR TË MARRË SHËRBIME PUNËSIMI

Ka një përqindje më të lartë grash që kërkojnë punë në zyrat rajonale të punës, në krahasim me burrat. Intervistat me Mimoza Ponarin (MMSR) tregojnë se në vitin 2014 60% e të papunëve që kërkonin punë qenë gra, ndërsa në vitin 2015 kjo shifër u rrit në 70%. Gjithashtu, afërsisht 53% e atyre që ia kanë dalë mbanë të gjejnë

punë me ndërmjetësimin e zyrave të punësimit qenë gra (10 000 gra në vitin 2015 në krahasim me 8 200 gra një vit më parë). Nuk ka të dhëna të zberthyera sipas zonës (fshat dhe qytet).


Zyrat e punës duket se luajnë një rol më të dobët në fshat, në krahasim me ato në qytet. Numri i grave që jetojnë në zona rurale, që regjistrohen në zyrat e punës, është disi më i lartë se i burrave (figura 14).



3.7.3.6. MUNDËSIA PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAME TË MBËSHTETJES SOCIALE

Sistemi shqiptar i mbrojtjes sociale përbëhet nga shumë nënprograme, të cilët ofrojnë mbështetje financiare për pjesë të ndryshme të popullsisë, me qëllim uljen e rreziqeve të varfërisë, moshës së shkuar, rritjen e kapacitetit për të menaxhuar risqet shoqërore-ekonomike, si aftësitë e kufizuara, papunësia, sëmundja afatshkurtër dhe të qenit nënë e re. Përqindja e grave në popullsinë gjithsej, që përfiton nga sigurimet shoqërore, është 51,8%, nga 554 102 përfitues gjithsej.

Figura 15: Pensionet në fshat, sipas përkatësisë gjinore, 2012-2013



BURIMI: INSTAT, FEMRA DHE MESHKIJ NË SHQIPËRI, 2014

Sistemi i sigurimeve shoqërore në fshat përqendrohet kryesisht në mbështetjen e marrësve të pensionit të pleqërisë (figura 15). Pjesëmarrja në tregun formal të punës përbën parakusht kryesor për marrjen e pagesave të pensionit të pleqërisë, papunësisë, sëmundjes afatshkurtër dhe lejes së lindjes. Aktualisht, informaliteti e ul pjesëmarrjen e grave në këto skema sociale.

Asistenca e papunësisë lidhet fuqimisht me pjesëmarrjen në tregun formal të punës. Prandaj kontributet në skemën e asistencës së papunësisë në fshat janë modeste krahasuar me qytetin.

Në diskutimet në grupet tematike në zona të ndryshme të Shqipërisë mungesa e sigurimeve shoqërore konsiderohet si një problem shumë i madh, çka përbën shqetësim për shumicën e grave. Siç kanë thënë vetë:

Burrat duket se janë më të informuar për procesin dhe procedurat e lidhura me skemat e asistencës sociale. Gjithashtu, ata marrin dhe administrojnë pagesën mujore.

Një përfitim tjetër që nuk përdoret në fshat është leja e lindjes. Informaliteti dhe shkalla modeste e punësimit me rrogë në fshat janë shkaqet kryesore të përqindjes më të ulët të grave që përfitojnë leje lindjeje (20%) në fshat, në krahasim me gratë që jetojnë në qytet (mbi 50%). Intervistat dhe diskutimet në grupe tematike tregojnë se ka raste të shpeshta kur gratë në fshat paguajnë shumën e kontributeve sociale për të gjithë vitin, në mënyrë që të përfitojnë pagesën e lejes së lindjes.

Po vihen në zbatim ndërhyrje të tjera shtesë, për të rritur përfitimin e pagesës së lejes së lindjes për gratë, si “ofrimi i lejeve të lindjes gjatë vitit 2016 për gratë në fshat edhe kur nuk janë paguar kontribute” (intervistë me Kukën).

3.7.3.7. MUNDËSIA PËR TË MARRË TIK


Hendeku ndërmjet familjeve me kryefamiljarë meshkuj, që zotërojnë një kompjuter, është më i madh në krahasim me familjet me kryefamiljare femra (figura 16). Hendeku gjinor është më i gjerë në zonat urbane. Në qytet 23% e femrave kanë

Jemi shumë të shqetësuara për pensionin, por problemi është se nuk i paguajmë dot sigurimet tani; kemi fëmijë për të rritur. Nuk na teprojnë paratë. (DVRAN, 45 VJEÇE)

Zakonisht, burrat shkojnë nëpër zyra. Për mua i ka bërë të gjitha burri. Të rralla janë gratë që janë në gjendje të merren me zyrat. (BEGJUNEC, 58 VJEÇE)

Im shoq ka paguar vetëm për mua, në mënyrë që të përfitoj lejen e lindjes nga shteti. Shkon ai t'i marrë paratë çdo muaj. Unë vetë nuk shkoj. (REÇ, 33 VJEÇE)

Figura 16: Kanë kompjuter, sipas përkatësisë gjinore dhe zonës (familje)




kompjuter, ndërsa në fshat 12% e familjeve me kryefamiljare femra kanë kompjuter. Nga ana tjetër, përqindja e familjeve me kryefamiljarë meshkuj që kanë kompjuter është 29% në qytet dhe 9% në fshat.

Afërsisht 13% e femrave që jetojnë në fshat thonë se kanë përdorur kompjuter, shifër modeste kjo në krahasim me femrat në qytet (shih figurën 17). Meshkujt thonë se e përdorin më shumë kompjuterin, por numri i atyre që kanë kompjuter është modest.

Lidhja me internetin është më e lartë te meshkujt, në krahasim me femrat; si në

Figura 17: Kanë përdorur kompjuter në 3 muajt e fundit, sipas përkatësisë gjinore (individë)




BURIMI: AMNJ, 2012

qytet, ashtu edhe në fshat (figura 18). Kjo mund të ketë lidhje me mundësinë që kanë meshkujt për të përdorur qendrat e internetit dhe për të pasur telefona celularë.

Përqindja e familjeve me kryefamiljare femra që kanë telefon celular është 78%, ndjeshëm më e ulët nga përqindja e familjeve me kryefamiljarë meshkuj, 95% e të cilëve kanë telefon celular (figura 19).

Mundësia disi e ulët për të marrë shërbime të teknologjisë informatike dhe të


Figura 18: Kanë përdorur internet në 3 muajt e fundit, sipas përkatësisë gjinore (individë)



BURIMI: AMNJ, 2012

komunikimit përbën disa sfida për futjen e mënyrave të reja të rritjes së lidhjes me tregun dhe për ndjekjen e qasjeve inovatore për arsimin, siç është mësimi në distancë etj.

Figura 19: Familje me linjë telefoni, sipas përkatësisë gjinore (familje)




BURIMI: AMNJ, 2012

3.7.3.8. MUNDËSIA PËR TË MARRË PJESE NË ORGANIZATA DHE RRJETE RURALE

Gjatë dy dekadave të fundit agjencitë e ndihmës për zhvillim dhe projektet e donatorëve kanë mbështetur krijimin e shoqatave dhe organizatave të fermerëve në Shqipëri. Në vitin 2015 kishte 37 kooperativa të regjistruara (SHBB - Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor) në Shqipëri, me 425 anëtarë gjithsej. Anëtalet femra në këto kooperativa përbëjnë vetëm 8,7%. Gjithashtu, janë regjistruar 14 shoqata

Figura 20: Besimi te shoqatat, shoqëria civile dhe OJQ-të si zgjidhëse të problemeve, sipas përkatësisë gjinore



agrobiznesi, ndërsa ushtrojnë veprimtari në zonat rurale një numër shumë i madh organizatash jofitimprurëse.

Rezultatet e studimit krahasues tregojnë se një përqindje shumë e ulët e burrave (3%) dhe e grave (0,7%) janë anëtarë të shoqatave. Vetëm 21 individë (17 burra dhe 4 gra) thonë se janë anëtarë të ndonjë shoqate.

Ka shumë vend që shoqatat të rrisin numrin e anëtarëve, sepse shumica e personave të intervistuar besojnë në rolin pozitiv të shoqatave. Në fakt, thuajse 43% e pjesëmarrësve besojnë se shoqatat dhe shoqëria civile në përgjithësi mund të jenë të rëndësishme për zgjidhjen e problemeve të fshatit (figura 20). Nga ana tjetër, 53% e kampionit të studimit janë skeptikë për shoqërinë civile në përgjithësi.

Në përgjithësi, nga diskutimet në grupe tematike është parë se burrat përfshihen më shumë se gratë në organizata të tilla. Pjesëmarrëset gra thonë se organizatat e grave janë më të përqendruara në produkte të veçanta bujqësore. Për shembull, shoqata në Dvoran që e përqendruar te kultivimi i bimëve frutore, ajo në Begjunec jepte informacion mbi prodhimin e kompostos së qershisë etj. Disa prej pjesëmarrësve thanë se kjo ka përfitime, siç është marrja e informacioneve me vlerë për tema me interes, udhëtimi jashtë vendit për të marrë përvojë etj., ndërsa disa të tjera ndihen të përjashtuara nga këto grupe. Siç thonë disa gra:

3.7.3.9. MUNDËSIA PËR TË QENË NË KONTAKT ME SHËRBIMET DHE ORGANET E PUSHTETIT VENDOR

Pushteti vendor e ka mundësinë për të qenë një institucion i rëndësishëm për fuqizimin ekonomik të grave në fshat. Siç e theksojnë VanderLeest, Xhelo dhe Wittberger (2012), roli i pushtetit vendor në politikat, buxhetin dhe shërbimet vendore është shumë i rëndësishëm, sepse mund të sjellë përfitime, si për gratë, ashtu edhe për burrat.

Pyetjes për nivelin e besimit që kanë gratë për pushtetet e niveleve të ndryshme në zgjidhjen e problemeve të tyre të përditshme, 69% e burrave dhe 73% e grave, thanë se nuk kanë besim, as te pushteti qendror, as te pushteti vendor (tabela 20).

Jemi përfshirë me një shoqatë agronomësh këtu. Na informojnë rregullisht me mesazhe në celular se çfarë duhet të bëjmë. (DVORAN, 39 VJEÇE)

Kemi 15 vjet që merremi me shoqata, por nuk bëjnë asgjë. Nuk janë për mua e për ty ato, janë vetëm për veten. (BEGJUNEC, 45 VJEÇE)

Tabela 20: Institucionet te të cilat kihet besim si zgjidhëse të problemeve, sipas përkatësisë gjinore

P. 62. A. Te cilat subjekte keni më shumë besim se jua zgjidhin problemet:	M	F
	%	%
1. Pushteti qendror	16%	13%
2. Pushteti vendor	12%	13%
3. Asnjëri	69%	73%
Mungon vlera	3%	2%
Gjithsej krahasues	100%	100%

BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT KRAHASUES

(1) E kanë mendjen te kolltuku, te interesat e veta, askush nuk kujtohet për ne. (BEGJUNEC, 45 VJEÇE)

Duken një herë në katër vjet dhe pastaj nuk i sheh më. Kjo rrugë ka më shumë se 20 vjet në këtë gjendje. E rregullojmë vetë herë pas here, por ka nevojë për investim që të rregullohet. (FUSHË-DRAÇ, 42 VJEÇE)

Niveli i ulët i besimit mund të vijë nga mungesa e pjesëmarrjes së popullsisë rurale në vendimmarrje. Gjithashtu, meqenëse pjesa më e madhe e studimit është realizuar në zona rurale të drejtuara nga njësi vendore të vogla (komuna), mund të arrijmë në përfundimin se u mungojnë burimet për të ofruar shërbime të tilla si infrastrukturë rrugore dhe ujitëse, punësim dhe mundësi të tjera ekonomike. Ky nivel më i ulët besimi i grave ka lidhje edhe me përjashtimin e tyre nga vendimmarrja, si në nivel komune, ashtu edhe në nivel qarku.

Pikëpamja e përgjithshme që raportohet nga shumica e grave pjesëmarrëse në diskutimet tematike është ndikimi i ulët që kanë ato te vendimmarrja e organeve të pushtetit vendor. Siç thanë disa prej tyre **(1)**.

Shumë pak gra e njohin punën e bërë nga komuna për shërbime të tjera, si marrja e informacioneve në zyrat e komunës, pagimi i tatimeve etj. Por gratë nuk përfshihen fare. Këto përgjegjësi kryhen nga burra. Zakonisht gratë u drejtohen këtyre zyra për të marrë ndihmën financiare dhe vërtetimet që u nevojiten.

3.7.3.10. MUNDËSIA PËR TË MARRË PJESE NË ANGAZHIMIN E KOMUNITETIT NË JETËN PUBLIKE

Ka një dallim të lehtë ndërmjet familjeve me kryefamiljare femra dhe atyre me kryefamiljarë meshkuj, ku gratë janë më pak të prirura të angazhohen në veprimtari brenda komunitetit dhe për llogari të komunitetit. Diskutimet në grupe tematike tregojnë se pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave në jetën publike pengohet nga disa kufizime. Në përgjithësi, pjesëmarrëset gra thonë se grupet e komunitetit me bazë fshatin, të cilat janë joformale, ose grupet politike, përbëhen kryesisht nga burra. Është pjesë e jetës së përditshme të burrave që të takohen me burra të tjerë nëpër kafene ose vende ku kalojnë kohën. Krahas kalimit të kohës në shoqëri, këto takime shërbejnë edhe për të folur për problemet e fshatit, probleme individuale etj.

Jo vetëm që në këto veprimtari nuk përfshihen gratë, por gratë nuk kanë mënyra të ngjashme grupimi, siç thonë të gjithë pjesëmarrësit. Pjesëmarrja në jetën e komunitetit në këtë mënyrë jo vetëm që nuk shpresohen nga gratë, por madje as nuk mirëpritet. Një grua thotë:

Zakonisht, burrat takohen me njëri-tjetrin, edhe në këshillin vendor. Shkojnë përditë në kafene, mësojnë të rejtat dhe bëjnë muhabet.

(BRADASHESH, 40 VJEÇE)

Duhet të ketë një kafene vetëm për gratë, se burrat nuk ua lejojnë grave të shkojnë nëpër kafene. Kushdo e gjen një orë të dalë e të takohet, por grave u vjen turp.


(DVORAN, 45 VJEÇE)

3.7.3.11. MUNDËSIA PËR TË MARRË INFORMACION

Rezultatet e anketës tregojnë se burrat janë disi më të informuar se gratë lidhur me thujt të gjitha çështjet (figura 21 dhe 22). Në fakt, 64% e burrave kanë njëfarë informacioni lidhur me të drejtat mbi tokën, në krahasim me 46% të grave të intervistuar; 22% e burrave ndihen të informuar lidhur me shërbimet vendore, në krahasim me 11% të grave; 5-10% e burrave të kampionit thonë se janë më të informuar se gratë lidhur me çmimet, praktikat dhe skemat e subvencioneve.

Siç pritej, bujqësia është sektori ku fermerët mendojnë se janë më të informuar; 75% e burrave dhe 70% e grave janë disi të informuar. Edhe aspektet e lidhura me skemat e pensioneve dhe të drejta mbi tokën njihen nga pjesëmarrësit në studim, por përqindjet bien në mënyrë të konsiderueshme (thujtse 50% e të gjithë pjesëmarrësve kanë njëfarë informacioni).


Figura 21: Mundësia për të marrë informacion, sipas sektorëve, meshkuj



BURIMI: REZULTATET E STUDIMIT KRAHASUES

Shumica e pjesëmarrësve (si burra, ashtu edhe gra) nuk kanë informacion të mjaftueshëm për çështjet e lidhura me praktikat e hapjes së një biznesi (74% e burrave dhe 83% e grave nuk kanë asnjë informacion), shërbimet vendore (77% e burrave dhe 87% e grave thonë se nuk kanë asnjë informacion), mundësitë për punësim (78% e burrave dhe 76% e grave) dhe, çuditërisht, skemën e subvencioneve (77% e burrave dhe 87% e grave nuk kanë asnjë informacion për këtë çështje).

Figura 22: Mundësia për të marrë informacion, sipas sektorëve, femra



Rezultatet tregojnë se nuk ka dallime të konsiderueshme ndërmjet burrave dhe grave sa u takon veprimtarive rutinë, si vajtja tek ofruesit e shërbimeve publike (zyrat vendore, qendrat shëndetësore, zyrat e pensionit etj.). Por ka më shumë burra ruralë që i vizitojnë këto agjenci, me përjashtim të qendrave shëndetësore, të cilat vizitohen më shpesh nga gratë (70% e burrave, në krahasim me 80% të grave). Shumica e pjesëmarrësve u janë drejtuar të paktën një herë zyrave të agjencisë së ujësjellësit dhe elektrikut (94% e burrave dhe 64% e grave) dhe një farmacie/dyqan bujqësor (83% e burrave dhe 66% e grave).

Agjencitë më pak të vizituara nga fermerët janë agjencia e punësimit (vetëm 14% e burrave dhe 12% e grave) dhe Drejtoria Rajonale e Bujqësisë (vetëm 13% e burrave dhe 8% e grave e kanë vizituar të paktën një herë këtë agjenci). Interesant është fakti se bankat përdoren nga një numër i vogël fermerësh. Në fakt, 73% e burrave dhe 65% e grave thonë se nuk kanë vizituar asnjë bankë vitin e fundit.

4. BIBLIOGRAFIA

Alkire, S., Meinzen-Dick, R., Peterman, A., Quisumbing, A., Seymour, G., & Vaz, A. (2013). *Indeksi i Fuqizimit të Grave në Bujqësi*. *World Development*, 52, 71-91.

Bardhoshi, N. (2007). *E drejta kanunore dhe shteti i së drejtës*. *Revista MAPO*.

Behr, P., dhe Madestam, A., 2016, *Gender and loans : Are there genderbias in lending ? (Përkatësia gjinore dhe kreditë: a ka shtrembërim gjinor në huadhënie?) gjendet në adresën: <http://www.worldbank.org/sq/news/opinion/2013/04/15/sex-and-credit-is-there-gender-bias-in-lending>*.

CBS, 2014, *Studim për nevojat financiare të industrisë së agro-përpunimit, raport për RISI Albania*.

CEDAW, 2010. *Konkluzionet Përmbyllëse nga Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave*. Gjendet në adresën: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cedaw/docs/co/CEDAW-C-ALB-CO-3.pdf>.

Conning, J., Deb, P., 2006, *“Impactevaluationforlandpropertyrightsreforms” (Vlerësim i efektit të reformave në fushën e të drejtave të pronësisë mbi tokën)*, CityUniversityofNewYork. SHBA. gjendet në adresën: <http://urban.hunter.cuny.edu/~conning/papers/Impact4Land.pdf>, qershor 2007.

Daman, P. (1997). *Cooperatives and poverty reduction: Enhancing social and economicimperatives (Kooperativat dhe ulja e varfërisë: përmirësimi i imperativëve shoqërorë dhe ekonomikë)*. ICA ROAP, Nju Delhi, PS.

DSA, 2009, *Anketë dhe analizë e ofruesve të shërbimeve bujqësore, 2009, porositur nga SNV*.

DSA, 2011, *Anketë për financimin e shërbimeve këshillimore veterinare nga NIRAS / AGROTEC/ IZSV (EU)*.

- FAO. (2011). *The State of Food and Agriculture: Women in Agriculture: Closing the Gender Gap for Development* (Gjendja e ushqimit dhe bujqësisë: gratë në bujqësi: mbyllja e hendekut gjinor për zhvillim).
- FAO, 2015, *Gender Equality in Rural Albania Country Gender Assessment for Agriculture and Rural Development* (Barazia gjinore në Shqipërinë rurale – vlerësim gjinor në bujqësi dhe zhvillimin rural), përgatitur nga Aroa Santiago Bautista.
- Raporti “Doing Business 2014”, indeksi i politikave për NVM-të 2013, anketa e BB-së me bizneset etj.
- Komisioni European 2013, Komunikatë e Komisionit për Parlamentin European dhe Këshillit, Strategjia e Komisionit për Zgjerimin dhe Sfidat Kryesore për Zgjerimin 2013-2014 {SEC (2010) 1335}, Bruksel.
- FAO. (2011). *Assessment of the human capacity development needs for, and gaps in, the agricultural Advisory Services in Western Balkans* (Vlerësim i nevojave për zhvillim të kapaciteteve njerëzore dhe i boshllëqeve të shërbimeve këshillimore bujqësore në Ballkanin Perëndimor), raport përfundimtar, gjendet në adresën: <http://www.fao.org/docrep/015/i2119e/i2119e00.pdf>.
- FAO dhe BB, 2014, *GENDER DISAGGREGATED DATA - WESTERN BALKANS STATISTICAL REPORTS 2005 – 2013* (raporte statistikore për Ballkanin Perëndimor, me të dhëna të zbërthyera sipas përkatësisë gjinore), gjendet në adresën: http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/nr/land_tenure/Genders_Report_WB.pdf.
- GlZ, 2015, *Studim i situatës fillestare për Projektin SARED*, raport i brendshëm.
- Guri, F. (2007). *Studim i tregut të tokës në zonën bregdetare shqiptare (rasti i zonës Durrës-Kavajë) – Rëndësia e turizmit dhe politikave të administrimit të tokës*. Tezë doktore, Universiteti Bujqësor i Tiranës.
- IDM dhe GADC, 2010, *Fuqizimi i perspektivave ekonomike dhe shoqërore të grave në fshatin shqiptar*, gjendet në adresën: http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/01/empowering_albanian_rural_woman_economic_and_social_perspectives_2010.pdf.

IDM, 2015, *Axhenda gjinore për zhvillimin rural – fuqizimi i grave në zonat rurale*, Tiranë, Shqipëri.

ILO, 2014, *Analiza e nevojave për shprehi, 2014*, gjendet në adresën: http://www.kerkojpune.gov.al/wp-content/uploads/2015/02/SKILL-NEEDS-ANALYSES-2014-survey_Final-Report.pdf.

INSTAT (2011). *Anketa e Përdorimit të Kohës në Shqipëri, 2010-2011*, gjendet në adresën: http://www.instat.gov.al/media/171100/albanian_time_use_survey_2010-2011.pdf.

INSTAT (2012). *Anketa e Përdorimit të Kohës në Shqipëri, 2010-2012*, Tiranë Shqipëri.

INSTAT. (2014). *Një klasifikim i ri urban-rural i popullsisë në Shqipëri – tipologjia gjeografike e BE-së e bazuar në të dhënat e rjetit të qelizave*, Tiranë, Shqipëri.

ISB. (2013). *Studim për sipërmarrjen e grave në Shqipëri*. Tiranë, Shqipëri.

RISI, 2013, *Tregu i punës për të rinjtë: analiza e nënsektorit të parë – agropërpunimi*.

RISI, E., 2014, *Agropërpunimi – studim për nevojat për punë bindëse*, Raport i përgatitur nga Zhllima, E. dhe Merkaj, E.

Kabeer, N., 2001. “Reflectionson the MeasurementofWomen’sEmpowerment—Theory and Practice.” (Reflektime mbi matjen e fuqizimit të grave – teoria dhe praktika) Në *DiscussingWomen’sEmpowerment—Theory and Practice (Diskutim mbi fuqizimin e grave – teoria dhe praktika)*, përmbledhje nga A. Sisask, 17–54. Stockholm, Suedi: NovumGrafiska AB.

Kodderitzsch, S. (1999). *Reforms in Albanian agriculture: Assessing a Sector in Transition*. (Reformat në bujqësinë shqiptare: vlerësimi i një sektori në tranzicion. Material teknik i Bankës Botërore Nr. 431. Banka Botërore.

Lemel, H., (EDS), 2000, “*Rural Property and Economy in Post-CommunistAlbania*” (Varfëria dhe ekonomia në fshat në Shqipërinë pas periudhë së komunizmit), Nju-Jork, Oksford: Berghahn Books.

OECD, 2010 *Indeksi i Politikave*; Albinvest, 2007, *Observatori i NVM-ve*.

OECD, 2010, 2011. 2012 dhe 2013, *Indeksi i Politikave për NVM-të 2009, 2010, 2011 dhe 2013*, Reporton the EuropeanCharterforSmallEnterprisesprocess in the

WesternBalkans (Raport për procesin e Kartës Europiane për Ndërmarrjet e Vogla në Ballkanin Perëndimor).

OECD, 2011, Report on the Gender Initiative: GenderEquality in Education, Employment and Entrepreneurship (Raport për Nismën Gjinore: barazia gjinore në arsim, punësim dhe sipërmarrje), Mbledhja e Këshillit në Nivel Ministror të OECD, Paris, 25-26 maj 2011. Gjendet në adresën: <http://www.oecd.org/education/48111145.pdf>.

Mahmud, S., Shah, N. M., & Becker, S. (2012). Measurementofwomen'sempowerment in rural Bangladesh (Matja e fuqizimit të grave në Bangladeshin rural). World Development, 40(3), 610-619.

Mandro-Balili, A. (2012). Të drejtat pronësore të grave në Shqipëri – analizë e standardeve ligjore dhe e zbatimit në praktikë. Raport përfundimtar për UN Women Shqipëri.

MBZHRAU. (2011). Vjetari statistikor bujqësor për vitin 2010, Tiranë, Shqipëri.

MASH. (2012). Arsimi profesional në Shqipëri. Tiranë, Shqipëri.

MASH. (2013). Shifra mbi arsimin. Tiranë, Shqipëri.

Narayan-Parker, D. (Ed.). (2005). Measuring empowerment: cross-disciplinaryperspectives. (Matja e fuqizimit: perspektiva ndërdisiplinore) Botime të Bankës Botërore.

Nelson, J., Tilly,C., Walker,L., 1997, “Transforming post-communistpoliticeconomies” (Transformimi i ekonomive politike në periudhën pas komunizmit), NationalAcademyPress, Uashington, D.K., ShBA.

Snyder, M. (1990). Women: the key to endinghunger. (Gratë: çelësi për t'i dhënë fund urisë). Hunger Project Papers (ShBA), (8).

Tigges, L. Dhe G. Green (1994), “SmallBusinessSuccessamong Men- and Women-ownedFirms in Rural Areas” (Suksesi i bizneseve të vogla te firmat në pronësi të burrave dhe të grave në fshat), Rural Sociology, Vol. 59, Nr. 2, Rural SociologicalSociety, f. 289-310.

UN Women. (2015). “Përparimi i grave në botë, 2015/2016: Transformimi i ekonomive,

realizimi i të drejtave, Kreu 3. Për më shumë, shihni: <http://www.unwomen.org/en/news/in-focus/women-and-the-sdgs/sdg-5-gender-equality#sthash.aAq2NLgB.dpuf>

UN Women. (2011). *Raporti kombëtar për statusin e grave dhe barazinë gjinore në Shqipëri*. UN Women. Tiranë, Shqipëri.

UN Women, 2014, *Perspektiva gjinore në Shqipëri – analizë gjinore e rezultateve të Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011*, Tiranë, Shqipëri.

OKB. (1995). *Raport i Konferencës së Katërt Botërore për Gratë, Pekin, 4-15 shtator 1995 (botim i OKB-së, Nr. E.96.IV.13), kreu I, rezoluta 1, shtojcat I dhe II*.

OKB. (2011). *Program Veprimi për vendet më pak të zhvilluara, për dekadën 2011-2020, miratuar në Konferencën e Katërt të OKB-së për Vendet më Pak të Zhvilluara, Stamboll, Turqi, 9-13 maj 2011 (A/CONF.219/3)*.

UNODC, 2013, *Biznesi, korrupsioni dhe krimi në Shqipëri: Ndikimi i ryshfetit dhe krimeve të tjera në ndërmarrjet private*. Zbatuar nga INSTAT.

UNICEF Serbi. 2011. *Access for women and children to services in the rural areas of Serbia and proposed measures to improve their situation (Mundësia e grave dhe fëmijëve për të marrë shërbime në zonat rurale të Serbisë dhe masat e propozuara për ta përmirësuar situatën e tyre)*. Gjendet në adresën:

<http://rs.one.un.org/organizations/12/publication.pdf>.

UN Women (2013). *Analizë gjinore e shërbimeve këshillimore për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në Shqipëri. Projekt-raport i konsulentit*. Tiranë: UN Women.

UN Women, 2015, *Plan Veprimi për Sipërmarrjen e Grave 2014-2020*, gjendet në adresën: http://www.ekonomia.gov.al/files/userfiles/Plani_Veprimit_Ang.pdf.

UNDP, (2012). *Analizë e modeleve të projekteve të zhvillimit të vëna në zbatim për fuqizimin ekonomik të grave në Shqipëri*. Tiranë: UNDP.

VanderLeest, K. J., Xhelo, R., Wittberger, D., 2012, *Gender Equality and Local Governance (Barazia gjinore dhe qeverisja vendore)*, gjendet në adresën: <http://www>.

entwicklung.at/fileadmin/media/Themen/Gender/GELG_publication_2012_EN.pdf.

Wheeler, R. (1998). *Past and present land tenure systems in Albania: Patrilineal, patriarchal, family-centered (Sistemet e të drejtave mbi tokën në Shqipëri, në të shkuarën dhe të tashmen: patrilinearë, patriarkalë, të mbetur brenda familjes). Qendra për të drejtat mbi tokën, seria shqiptare, Material Pune Nr. 13, Universitetit "UniversityofWisconsin-Madison".*

Wheeler, R., dhe Laha, M. (1995). *PropertyRights, Women and the Family in ContemporaryAlbania (Të drejtat mbi pronën, gratë dhe familja në Shqipërinë bashkëkohore).*

Wheeler, R., & Waite, M. (2003). *Material informues për Shqipërinë – të drejtat mbi pronën dhe tregu i tokës. Qendra për të drejtat mbi tokën. Universiteti "UniversityofWisconsin", ShBA.*

Banka Botërore. (2010). *Dimensionet gjinore të reformës së klimës së investimeve.*

Banka Botërore. 2011. *WorldDevelopmentReport 2012: GenderEquality and Development. (Raporti për zhvillimin botëror 2012: barazia gjinore dhe zhvillimi). Uashington, D.K.*

BB, 2014, *EducationqualityAlbania and opportunitiesforskillsdevelopment in Albania- An analysisof PISA 2000-2012 results (Cilësia e arsimit në Shqipëri dhe mundësitë për zhvillim të shprehive në Shqipëri – analizë e rezultateve PISA 2000-2012), Praktika Globale e Arsimit, Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore.*

BB, 2015, *The Global FindexDatabase 2014-Measuring FinancialInclusionaround the World (Baza e të dhënave globale Findex 2014 – matja e gjithëpërfshirjes financiare nëpër botë), gjendet në adresën: http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDSP/IB/2015/10/19/090224b08315413c/2_0/Rendered/PDF/The0Global0Fin0ion0around0the0world.pdf#page=3.*

Zhllima, E., Viaggi, D., dhe Müller, D. (2010). *Propertyrightsof land and itsperception in rural partof central Albania (Të drejtat pronësore mbi tokën dhe perceptimi për të në pjesën rurale të Shqipërisë së Mesme), artikull i përgatitur për buletinin NEW MEDIT, Nr. 3.*

5. SHTOJCA

SHTOJCA 1: PROJEKTIMI I KAMPIONIT DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ

1.1 ZONAT GJEOKLIMATIKE

Ka katër zona kryesore gjeoklimatike në vend, të cilat kanë të bëjnë me pozitën gjeografike dhe lartësinë mbi nivelin e detit. Nga kombinimi i zonave gjeografike me dallime topografike kanë dalë 12 nënzona, të cilat dallojnë nga njëra-tjetra sa i takon strukturës prodhuese ose rendimentit bujqësor në varësi të klimës, pjellorisë së tokës dhe praktikave të prodhimit. Kështu, duke marrë në konsideratë dallimet e mëdha agro-klimaterike dhe efektin që kanë ato te struktura dhe prodhimi bujqësor, është menduar përdorimi i kampionimit të shtresëzuar, si procedura më e përshtatshme e përzgjedhjes së kampionit.

Ekipi studimor ka përdorur teknikën e përzgjedhjes së kampionit në disa faza, për të mbajtur në konsideratë larinë e profileve shoqërore-ekonomike dhe kulturore të grave në fshat. Kjo qasje është zgjidhja më e mirë në rastet kur nuk mund të ketë një listë të përcaktuar qartë të grupit të synuar, siç është rasti i listave të fermave në studimet bujqësore.

Është propozuar një njësi kampioni primare (NJKP), duke përdorur zonën administrative të ish-komunave¹⁹, të cilat përkufizohen si “zona me dendësi të ulët popullesie”. Lista bazë është përcaktuar nga INSTAT (2014), ku zonat rurale janë përzgjedhur në bazë të një përcaktimi në rrejtë të përbërë nga 306 njësi të quajtura si “zona me dendësi të ulët popullesie”.

19 Komunitat ish-ini niveli më i ulët administrativ në zonat rurale në Shqipëri, deri përpara muajit qershor 2015. Propozimi do të trajtojë këto njësi, duke qenë se ato i përgjigjen më mirë ndarjes rurale. Tani për tani, niveli më i ulët i njësive administrative në Shqipëri, që janë bashkitë, ka një pjesë shumë të madhe zonë urbane, duke e bërë kështu më të vështirë përzgjedhjen e kampionit.

SHTOJCA 2: PYETËSORI

Pyetëtori është hartuar për të mbledhur informacion nga familjet me synimin të dallimit midis grave dhe burrave brenda familjes. Por ka pyetje që përqendrohen në perceptimet dhe opinionet e pjesëmarrësve që u përgjigjen atyre. Pyetëtori synon të hetojë dallimet dhe kufizimet kryesore që ekzistojnë brenda familjes, në aspektin e përkatësisë gjinore. Ai është organizuar në rubrika të veçanta:

- Në rubrikën e parë merret informacion lidhur me karakteristikat e vendndodhjes së familjes, si largësia nga zona urbane kryesore dhe topografia e vendndodhjes. Përdoret një pyetje filtër për të identifikuar një femër në moshë të rritur, si përfaqësuese të familjes, e cila të mund t'u përgjigjet pyetjeve që kanë të bëjnë me atë vetë dhe me familjen në tërësi.
- Në rubrikën e dytë merret informacion për profilin shoqëror-demografik të anëtarëve të familjes. Pyetjet e kësaj rubrike kanë të bëjnë me moshën, përkatësinë fetare dhe gjendjen civile, marrëdhënien me kryefamiljarin, arsimin dhe punësimin. Merret informacion edhe për vendndodhjen dhe madhësinë e familjes përpara vitit 1991. Gjithashtu, është marrë informacion edhe për tokën bujqësore dhe llojin e saj (tokën e punueshme, frutore, pyje, kullotë etj.). Në rubrikën e tretë hetohen modelet gjinore të pronësisë mbi tokën dhe përdorimi i saj në bazë të rregullimeve zyrtare dhe jozyrtare. Në këtë rubrikë merret informacion në nivel parcele, duke bërë pyetje nëse toka është në pronësi individuale apo të përbashkët, kush nga familja e punon tokën, si është marrë toka, si është e dokumentuar toka, të drejtat që kanë individët mbi secilën parcelë, të drejtat e pronësisë dhe trashëgimisë. Në këtë rubrikë merren të dhëna edhe për tregues të tërthortë për vlerën e parcelave (si lidhja me rrjetin e ujitjes, largësia, të drejtat përpara vitit 1945 etj.).
- Në rubrikën e katërt të pyetësorit shihet sesi janë ndarë mes grave dhe burrave detyrat e veprimtarive ekonomike në familjet fshatare, si mbarështimi i bagëtisë, vendimet bujqësore dhe vendimet e tjera përkatëse ekonomike.
- Në rubrikën e pestë shihet mundësia e marrjes së shërbimeve këshillimore, mundësia e hyrjes në tregjet bujqësore, mundësia e marrjes së mbështetjes

financiare nga agjencitë shtetërore dhe nga institucionet bankare, mundësia e pjesëmarrjes në rrjetet sociale etj. Pyetje të tjera kanë për qëllim identifikimin e njohurive të pjesëmarrësit për ligjet zyrtare dhe praktikat tradicionale jozyrtare që kanë të bëjnë me të drejtat mbi tokën, vendimet për shitblerjen ose qiranë e tokës, si edhe trashëgiminë e tokës. Qëllimi i kësaj rubrike është të kuptohet më mirë se cilat janë parimet kryesore që orientojnë familjet e grave dhe familjet prej nga vinë ato (nëse janë të martuara) në lidhje me të drejtat mbi tokën. Pjesëmarrësve u bëhen pyetje për institucionet më të rëndësishme (zyrtare dhe jozyrtare). Atyre u kërkohet të japin perceptimin që kanë për të drejtat midis anëtarëve të familjes me gjini të ndryshme dhe midis atyre që kanë lindur përpara vitit 1991 dhe pas vitit 1991.

- Një rubrikë tjetër e pyetësorit përqendrohet te burimet kryesore të të ardhurave të familjeve, sipas kategorive. Pjesëmarrësve u kërkohet të japin informacion se kush është kontribuesi kryesor i të ardhurave brenda familjes.
- Rubrika e fundit bën një çmuarje të ndjesive dhe sjelljeve të pjesëmarrësit lidhur me barazinë e perceptuar në përgjithësi brenda familjes. Pyetjet janë hartuar në formën e fjalive, me vlerësim sipas shkallës Likert.
- Për një pjesë të kampionit (kryesisht zona malore me dendësi të ulët të popullsisë në Gramsh, Elbasan, Vlorë, Berat dhe Dibër, me 315 gra dhe 309 burra) është përfshirë në pyetësor një rubrikë tjetër shtesë, ku bëhen pyetje lidhur me mundësinë e grave për të marrë asistencë ekonomike, pensione fshati, pagesë invaliditeti dhe pagesa të tjera për PAK. Gjithashtu, bëhen pyetje lidhur me kufizimet mbi mundësitë ekonomike. Në këtë pjesë të kampionit bëhen edhe disa pyetje relacionale për burrat dhe për gratë, në të njëjtën kohë, duke shtuar disa pyetje për perceptimet për mundësinë dhe preferencat, për të marrë shërbime të lidhura me sipërmarrjen, punësimin, programe të zhvillimit rural dhe programe të zhvillimit rajonal.

ILUSTRIM I QASJES PËR PËRZGJEDHJEN E KAMPIONIT

Rrethi	Zona agro-kli-materike			Niveli rural				Fragmentimi			Largësia nga qendra kryesore urbane			NJQV e përzgjedhur	Fshati i renditur sipas nr. të familjeve	Fshati i përzgjedhur
	Bregdetare	Qendrore	Malore	Lista e Njësitve të qeverisjes vendore	Zona me dendësi të lartë populsië 7	Zona me dendësi të mesme 57	Zona me dendësi të ulët populsië 306	Numeri i lartë fshatrash	Numeri i ulët fshatrash	Numeri shumë i ulët fshatrash	Shumë afër	Afër	Larg			
Rrethi 1	0	1	0	NJQV 1	0	0	1	1	0	0	0	1	0	1	1	X
				NJQV 2	1	0	0	0							2	
				NJQV 3	0	1	0	0							3	
Rrethi 2				NJQV 1	0	1	0	0							1	X
	0	0	1	NJQV 2	0	0	1	1	0	0	0	1	0	1	2	
				NJQV 3	1	0	0	0							3	
Rrethi 3				NJQV 1	1	0	0	0								
				NJQV 2	0	1	0	0								
	1	0	0	NJQV 3	0	0	1	1	0	0	0	1	0	1	1	X

*Kur vlera është 1, tregon nëse NJQV është pjesë e stratës prej nga do të merret kampioni dhe nëse është 0, atëherë NJQV nuk duhet të jetë pjesë e stratës.

SHTOJCA 3: BURIMET E INFORMACIONIT

Informacioni i Kërkuar (TR)	Instrumentet dhe burimet e përdorura
1. Karakteristikat e përgjithshme të grave në fshat	
Prirja shoqërore-demografike e grave në Shqipërinë rurale	Censusi i INSTAT-it dhe të dhëna administrative, si edhe anketa e migrimit
Statusi ligjor dhe institucional i grave në fshat	Të dhëna dytësore: Raporte të Ministrisë së Drejtësisë, raporte të OKB-së dhe USAID-it, studime të mëparshme të DSA-së, databaza ligjore dhe analizë e përmbajtjes së Fletores Zyrtare Të dhëna parësore: Rezultate të anketës, grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
Sa mundësi ekonomike kanë, në përgjithësi, gratë në fshat, në bazë të pjesëmarrjes së tyre në veprimtari bujqësore dhe jobujqësore	Të dhëna parësore: Rezultatet e anketës Të dhëna dytësore: Anketa dhe raporte të MBZHRAU-së. AMNJ, AFP, ABF, Anketa e Përdorimit të Kohës
Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje dhe mundësia që u jepet grave të marrin pjesë në proceset e zhvillimit të cilat ndikojnë në fuqizimin ekonomik të tyre	Të dhëna dytësore: Raporte të donatorëve UN Women dhe UNDP Të dhëna parësore: Grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
Angazhimi i grave në projekte studimore dhe programe zhvillimore të hartuara për zonat rurale	Ministria e Arsimit, universitetet dhe raporte të projekteve të donatorëve, intervista me ekspertë

2. Kuadri i të drejtave dhe detyrave të grave brenda familjes në fshat

Të drejtat e grave në mjetet rurale brenda familjes dhe brenda fshatit, sipas statusit që kanë brenda familjes	Të dhëna parësore: Rezultatet e anketës
Modelet e pronësisë së tokës nga gratë, sa i takon përdorimit, shitjes, qirasë dhe trashëgimisë si edhe uzufruktit të tokës së përbashkët	Të dhëna parësore: Rezultatet e anketës
Ndarja e punës midis burrave dhe grave në familjet që merren me bujqësi/njësiti ekonomike fshatare	Të dhëna parësore: Rezultatet e anketës
Pjesëmarrja e grave në fshat në veprimtari me pagesë dhe niveli i barazisë së pagave dhe rrogave	Të dhëna dytësore: raporte dhe studime të projekteve të donatorëve, AMNJ dhe AFP e INSTAT, anketa dhe studime të DSA-së, studim i hendekut të pagës Të dhëna parësore: Grupe të diskutimeve tematike dhe intervista
Përfshirja e grave në fshat në veprimtari me sipërmarrje bujqësore dhe jobujqësore, sipas llojit dhe rezultateve të lidhura	Të dhëna dytësore: Regjistri Tregtar Të dhëna parësore: Rezultate të anketës dhe grupe të diskutimeve tematike

3. Studim i pengesave të grave në fshat për ndjekjen e mundësive ekonomike

Mundësia që u jepet grave për të marrë arsim publik dhe privat, formim dhe shërbime këshillimore	Të dhëna dytësore: Studim nga ILO, studim nga UN Women, anketa AMNJ, raporte të donatorëve, MMSR, Shërbimi Kombëtar i Punësimit Të dhëna parësore: Rezultate të anketës, grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
--	--

Mundësia që u jepet grave për të marrë shërbime financiare dhe sigurime	Të dhëna dytësore: Programi USAID-AAC, anketa Risi Albania-CBS, Banka Botërore, baza të dhënash dhe anketa të Bankës së Shqipërisë Të dhëna parësore: Rezultate të anketës, grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
Mundësia që u jepet grave për të marrë shërbimet shëndetësore që i ofrohen popullsisë në fshat	Të dhëna dytësore: AMNJ 2012 Të dhëna parësore: Grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
Pjesëmarrja e grave në pagesat sociale që i ofrohen popullsisë në fshat	Të dhëna dytësore: Raporte të MMSR-së, MBZHRAU-së dhe AZHZM-së Të dhëna parësore: Grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
Mundësia e grave për të përfituar informacion, teknologji dhe novacion	Të dhëna dytësore: AMNJ 2012, raporte të MBZHRAU-së, Censusi i Bujqësisë, anketa të femrave nga Projekti SARED. Të dhëna parësore: Grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
Pjesëmarrja e grave në sistemet e sigurimeve shoqërore dhe shërbimet sociale	Të dhëna dytësore: MMSR, Instituti i Sigurimeve Shoqërore Të dhëna parësore: Grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
Mundësia që u jepet grave për të marrë shërbimet ekzistuese publike dhe private për veprimtaritë bujqësore dhe rurale	Të dhëna dytësore: Anketa AMNJ, raporte të donatorëve (FAO, UN Women etj.) Të dhëna parësore: Rezultate të anketës, grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë

Pjesëmarrja e grave në skema të mbështetjes financiare dhe jofinanciare për zhvillimin rural	Të dhëna dytësore: Anketa Risi Albania-CBS, AMNJ, AFP, UN Women, evidencat e Agjencisë së Pagesave pranë MBZHRAU-së. Të dhëna parësore: Rezultate të anketës, grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
Pjesëmarrja e grave në organizatat dhe rrjetet me bazë rurale (shoqata, bashkime, grupe interesi etj.)	Të dhëna dytësore: AMNJ, AFP Të dhëna parësore: Rezultate të anketës, grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
Mundësia që kanë gratë për t'iu drejtuar shërbimeve dhe autoriteteve të pushtetit vendor, si tatimet dhe votimi. Identifikimi i kufizimeve konkrete në komunitet, në logjistikë, në sjellje dhe në politikë, të cilat i pengojnë gratë fermere/fshatare të marrin pjesë dhe të përfaqësohen në jetën publike, si në grupet me bazë komunitetin në fshat, këshillat vendorë, grupimet politike etj.	Të dhëna dytësore: Studime të UN Women, Anketa AMNJ, raporte të donatorëve Të dhëna parësore: Rezultate të anketës, grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë
4. Marrja e perceptimeve që kanë gratë për mjedisin ekonomik dhe se si veprojnë ato për ta shfrytëzuar në maksimum atë:	
Perceptimi për sigurinë e të drejtave mbi tokën	Të dhëna parësore: Studim nga FAO, studim nga BB, studim nga UN Women Të dhëna parësore: Rezultate të anketës, grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë

<p>Kërkesa për informacion dhe shërbime këshillimore</p>	<p>Të dhëna dytësore: Studime të UN Women, Anketa AMNJ, raporte të donatorëve Të dhëna parësore: Rezultate të anketës, grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë</p>
<p>Qëndrimet kundrejt institucioneve të vendimmarrjes në nivel vendor dhe qendror</p>	<p>Të dhëna dytësore: Studime të UN Women, projekte të DANIDA, GIZ dhe të donatorëve të tjerë, AMNJ 2012 Të dhëna parësore: Grupe të diskutimeve tematike dhe intervista me ekspertë</p>

5. Përgatitja e një raporti përshkrues dhe analitik për gjetjet kryesore, duke sugjeruar alternativat e duhura dhe rekomandime:

<p>Trajtimi i problemeve parësore dhe nevojave me përparësi që duhen trajtuar për nxitjen e fuqizimit ekonomik të grave në fshat Rekomandimi i masave specifike që duhen ndërmarrë nga afër me MBZHRAU-në, për t'u dhënë zgjidhje kufizimeve të grave në fshat Rekomandimi i ndërhyrjeve të mundshme ndërtematike ligjore dhe institucionale, të cilat mundësojnë një mjedis ekonomik më të mirë për gratë në fshat Përshkrimi i temave të mundshme, që mund të trajtohen në punën analitike të ardhshme</p>	<p>Metodat e trekëndëshzimit, duke përdorur të dhënat dytësore dhe parësore, si edhe konfirmimi i gjetjeve, duke ua paraqitur të dhënat MBZHRAU-së, grupeve të grave dhe palëve të tjera të identifikuar të interesit</p>
--	---

SHTOJCA 4: LISTA E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË INTERVISTAT GJYSMË TË STRUKTURUARA

Nr	Personat	Posti	Organizata
1.	Bukurie Imeri	Drejtoreshë	Gruaja drejt integritit
2.	Enio Jaco	Drejtor	Creative Business Solution
3.	Lindita Manga	Drejtoreshë	ALCDF
4	Koli Sinjari	Drejtor, Drejtoria e Burimeve Financiare dhe Projekteve	BiznesAlbania
5	Sevim Arbana	Presidente	Në dobi të gruas shqiptare
6	Sabah Djaloshi	Drejtor	AgroPuka
7	Astrit Kuke	Drejtor i Pensioneve	MMSR
8	Ornela Gjini	Spektori i Zhvillimit Rajonal dhe i Pronave	AIDA
9	Majlinda Hoxha	Ish-drejtoreshë	AgritraVizion
10	Blendi Zeneli	Drejtor i Kredisë për Ndërmarrjet e Mëdha	Procredit
11	Grigor Gjeci	Drejtori i Politikave të Zhvillimit Rural	MBZHRAU

12	Roland Bardhi	Nëpunës Programi	AZHSM
13	Pranvera Kastrati	Drejtorja e Mbështetjes dhe Sipërmarrjes	MZHETS-
14	Arta Mandro-Balili	Juriste	Fakulteti Juridik, UT
15	Mimoza Ponari	Specialiste	Sektori i Punësimit, Drejtorja e Politikave të Punësimit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
16	Mimoza Hasani	Specialiste	Sektori i Punësimit, Drejtorja e Politikave të Punësimit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
17	Luljeta Dauti	Specialiste	Sektori i Arsimit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
18	Arben Sinojmeri	Drejtor	Drejtorja Rajonale e Lëvizshme Tiranë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
19	Ornela Balla	Zyrë e marrëdhënieve me publikun	Fondi i Detyrueshëm i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
20	Adela Baboci	Nëpunëse kontakti për çështjet gjinore	MBZHRAU